

## **DIREKTIVA 2009/73/EC E PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN**

**E 13 korrikut 2009**

**Për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, duke shfuqizuar Direktivën 2003/55/EC**

**(tekst me rëndësi për EEA)**

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian, sidomos nenin 47(2) dhe nenet 55 dhe 95 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni,

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian <sup>(1)</sup>

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit të Rajoneve <sup>(2)</sup>

Duke vepruar në pajtim me procedurën e përcaktuar me nenin 251 të Traktatit <sup>(3)</sup>

Derisa:

- (1) Tregu i brendshëm i gazit natyror, i cili është implementuar në mënyrë progresive në gjithë Komunitetin qysh prej vitit 1999, synon të ofrojë zgjedhje reale për gjithë konsumatorët e Bashkimit Evropian, si qytetarë apo biznese, mundësi të reja biznesi dhe më shumë tregti ndërkufitare, ashtu që të arrihen rritje të efijencës, çmime konkurrenente, si dhe standarde më të larta të shërbimit, si dhe të kontribuohet në sigurinë e furnizimit dhe qëndrueshmëri.
- (2) Direktiva 2003/55/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e 26 qershorit 2003 për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror <sup>(4)</sup> ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në krijimin e një tregu të tillë të gazit natyror.
- (3) Liritë që Traktati i garanton qytetarëve të Bashkimit – mes tjerash, lëvizja e lirë e mallrave, liria e themelimit dhe liria për ofrimin e shërbimeve – janë të mundshme vetëm në një treg plotësisht të hapur, i cili i mundëson gjithë konsumatorëve të zgjedhin lirshëm furnizuesit e tyre, si dhe gjithë furnizuesve të ofrojnë lirisht për konsumatorët e tyre.
- (4) Megjithatë, aktualisht, ka pengesa ndaj shitjes së gazit në kushte të barabarta dhe pa diskriminim apo pa mangësi në Komunitet. Në veçanti, qasja jo-diskriminuese në rrjet dhe niveli me efektshmëri të barabartë i mbikëqyrjes së rregullatorëve në secilin Shtet Anëtar ende nuk ekziston.
- (5) Komunikata e Komisionit më 10 janar 2007, e quajtur «Politika Energjetike për Evropë» ka theksuar rëndësinë e kompletimit të tregut të brendshëm të gazit natyror, si dhe të krijimit të një mjedisi të barabartë për gjitha sipërmarrjet e gazit natyror të themeluara në Komunitet. Komunikatat e Komisionit më 10 janar 2007, të

---

<sup>1</sup> OJ C 211, 19.8.2008, p. 23.

<sup>2</sup> OJ C 172, 5.7.2008, p. 55.

<sup>3</sup> Mendimi i Parlamentit Evropian, më 9 korrik 2008 (ende nuk është shpallur në Gazetën Zyrtare), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit më 9 janar 2009 (OJ C 70 E, 24.3.2009, p. 37) si dhe Qëndrimi i Parlamentit Evropian më 22 prill 2009 (ende nuk është shpallur në Gazetën Zyrtare). Vendimi i Këshillit më 25 qershor 2009.

<sup>4</sup> OJ L 176, 15.7.2003, p. 57

quajtura «Perspektiva e tregut të brendshëm të gazit dhe energjisë elektrike» si dhe «Hulumtimi në bazë të nenit 17 të Rregullores (EC) Nr. 1/2003 në sektorët evropianë të gazit dhe energjisë elektrike (Raport Final)» kanë treguar që rregullat dhe masat aktuale nuk sigurojnë kuadrin e domosdoshëm për arritjen e synimit të një tregu të brendshëm plotësisht funksional.

- (6) Pa ndarjen efektive të rrjeteve nga aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit (shturje efektive), ekziston rreziku i diskriminimit jo vetëm në funksionimin e rrjetit, por edhe në stimujt që jepen për sipërmarrjet e integruara vertikalisht për të investuar në nivel adekuat në rrjetet e tyre.
- (7) Megjithatë, rregullat për shturjen juridike dhe funksionale, të përcaktuara me Direktivën 2003/55/EC ende nuk kanë çuar në shturjen efektive të operatorëve të sistemit të bartjes. Në takimin e tij më 8 dhe 9 mars 2007, Këshilli Evropian për këtë bëri thirrje që Komisioni të hartojë propozimet legjislative për «ndarjen efektive të aktiviteteve të furnizimit dhe prodhimit nga operacionet e rrjetit».
- (8) Vetëm heqja e stimujve për sipërmarrjet e integruara vertikalisht për të diskriminuar ndaj konkurrentëve në kuptimin e qasjes në rrjet dhe investime mund të sigurojë shturje efektive. Shturja e pronësisë, e cila nënkupton emërimin e pronarit të rrjetit si operator sistemi dhe pavarësia e tij nga interesat e furnizimit dhe prodhimit, është qartësisht një mënyrë efektive dhe stabile për zgjidhjen e konfliktit të afërt të interesave dhe për të siguruar sigurinë e furnizimit. Për atë arsye, Parlamenti Evropian në rezolutën e tij më 10 korrik 2007 për perspektivën e tregut të brendshëm të gazit dhe energjisë elektrike <sup>(5)</sup> i referohej shturjes së pronësisë në nivel të bartjes si mjeti më i mirë për të promovuar investimet në infrastrukturë në mënyrë jo-diskriminuese, qasjen e drejtë në rrjet për hyrjet e reja në treg, si dhe transparencën në treg. Bashkë me shturjen e pronësisë, Shtetet Anëtare duhen obliguar pra që të sigurojnë që i njëjti apo të njëjtit persona të mos kenë të drejtë të ushtrojnë kontroll mbi sipërmarrjen e prodhimit apo furnizimit, dhe njëkohësisht të ushtrojnë kontrollin apo ndonjë të drejtë mbi operatorin e sistemit të bartjes apo sistemin e bartjes. Në anën e kundërt, kontrolli mbi sistemin e bartjes apo operatorin e sistemit të bartjes duhet të parandalojë mundësinë e ushtrimit të kontrollit apo të drejtave mbi sipërmarrjen e prodhimit apo furnizimit. Brenda këtyre kufijve, sipërmarrja e prodhimit apo furnizimit duhet të ketë mundësi të ketë aksione pakicë në një operator të sistemit të bartjes apo sistem të bartjes.
- (9) Secili sistem për shturje duhet të jetë efektiv në heqjen e konfliktit të interesave mes prodhuesve, furnizuesve dhe operatorëve të sistemit të bartjes, për të krijuar stimuj për investimet e domosdoshme dhe për të garantuar qasjen e hyrjeve të reja në treg brenda një regjimi transparent dhe efikas rregullator, si dhe duhet të mos krijojë ndonjë regjim rregullator tepër të rëndë për autoritetet rregullatore shtetërore.
- (10) Definicioni i termit «kontroll» është marrë nga Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 139/2004 e 20 janarit 2004 për kontrollimin e koncentrimeve mes sipërmarrjeve (Rregullorja e Përbashkimit e KE-së)<sup>(6)</sup>
- (11) Derisa shturja e pronësisë, në disa raste, kërkon ristrukturimin e sipërmarrjeve,

---

<sup>5</sup> OJ C 175 E, 10.7.2008, p. 206.

<sup>6</sup> OJ L 24, 29.1.2004, p. 1.

Shtetet Anëtare që vendosin të implementojnë shturjen e pronësisë duhet të marrin kohën shtesë për të aplikuar dispozitat përkatëse. Në kuptimin e lidhjeve vertikale mes sektorëve të energjisë elektrike dhe të gazit, dispozitat e shturjes duhet të zbatohen në të dy sektorët.

- (12) Brenda shturjes së pronësisë, për të siguruar pavarësinë e plotë të operacionit të rrjetit nga interesat e furnizimit dhe prodhimit, si dhe për të parandaluar këmbimet e informatave konfidenciale, i njëjti person nuk mund të jetë anëtar i bordit menaxhues të operatorit të sistemit të bartjes apo sistemit të bartjes dhe njëkohësisht një sipërmarrjeje që kryen ndonjërin nga funksionet e prodhimit apo furnizimit. Për të njëjtën arsye, i njëjti person nuk duhet të ketë të drejtë të emërojë anëtarët e bordeve menaxhuese të operatorit të sistemit të bartjes apo sistemit të bartjes dhe të ushtrojë kontroll apo të drejta mbi sipërmarrjen e prodhimit apo furnizimit.
- (13) Themelimi i një operatori të sistemit apo operatori të bartjes që është i pavarur nga interesat e furnizimit dhe prodhimit duhet t'i mundësojë sipërmarrjes së integruar vertikalisht të ruajë pronësinë e saj mbi asetet e rrjetit derisa siguron ndarje efektive të interesave, me kusht që një operator i tillë i pavarur i sistemit apo një operator i tillë i pavarur i bartjes të kryejë gjitha funksionet e operatorit të sistemit, derisa rregulloret e hollësishme dhe mekanizmat e kontrollit gjithëpërfshirës rregullator të jenë funksionale.
- (14) Në rastet kur më 3 shtator 2009, një sipërmarrje që ka në pronë një sistem bartjeje është pjesë e një sipërmarrjeje të integruar vertikalisht, Shtetet Anëtare duhet të kenë mundësinë e zgjedhjes mes shturjes së pronësisë dhe themelimit të një operatori të sistemit apo operatori të bartjes që është i pavarur nga interesat e furnizimit dhe prodhimit.
- (15) Për të ruajtur plotësisht interesat e aksionarëve të sipërmarrjeve të integruara vertikalisht, Shtetet Anëtare duhet të kenë mundësinë e zgjedhjes së implementimit të shturjes së pronësisë, ose me ndarje të drejtpërdrejtë, ose duke ndarë aksionet e sipërmarrjes së integruar në aksione në sipërmarrje të rrjetit dhe aksione të sipërmarrjes së mbetur të furnizimit dhe prodhimit, me kusht që obligimet që dalin nga kjo shturje e pronësisë të zbatohen plotësisht.
- (16) Efektshmëria e plotë e operatorit të pavarur të sistemit apo operatorit të pavarur të bartjes duhet siguruar me anë të rregullave specifike shtesë. Rregullat për operatorin e pavarur të bartjes ofrojnë një kornizë të përshtatshme rregullatore për garantimin e konkurrencës së drejtë, investimeve të mjaftueshme, qasjes për hyrjet e reja në treg dhe integrimin e tregjeve të gazit. Shturja efektive përmes dispozitave të operatorit të pavarur të bartjes duhen ndërtuar mbi një shtyllë të masave organizative dhe masave që kanë të bëjnë me qeverisjen e operatorëve të sistemit të bartjes dhe mbi shtyllën tjetër të masave që kanë të bëjnë me investimet, kycjen e kapaciteteve të reja prodhuese në rrjet dhe integrimin e tregut përmes bashkëpunimit rajonal. Pavarësia e operatorit të bartjes gjithashtu, mes tjerash, duhet siguruar përmes periudhave të caktuara «të ftohjes», gjatë të cilave asnjë aktivitet menaxhmenti apo tjetër që ofron qasje ndaj të njëjtave informata që do të mund të merreshin në pozitë menaxheriale të mos ushtrohet në sipërmarrjen e integruar vertikalisht. Modeli i Operatorit të pavarur të bartjes në shturje efektive është në pajtim me obligimet e përcaktuara nga Këshilli Evropian në takimin e tij më

8 dhe 9 mars 2007.

- (17) Për të zhvilluar konkurrencën në tregun e brendshëm të gazit, konsumatorët e mëdhenj jo-amvisnorë duhet të jenë në gjendje të zgjedhin furnizuesit e tyre dhe të hyjnë në kontrata me disa furnizues për të mbuluar kërkesat e tyre të gazit. Konsumatorët e tillë duhen mbrojtur nga klauzolat e ekskluzivitetit, efekti i të cilave është përjashtimi i ofertave konkurrencte apo plotësuese.
- (18) Shteti Anëtar ka të drejtë të zgjedhë shturjen e plotë të pronësisë në territorin e tij. Aty ku Shteti Anëtar ushtron atë të drejtë, sipërmarrja nuk ka të drejtë të themelojë një operator të pavarur të sistemit apo operator të pavarur të bartjes. Për më tepër, sipërmarrja që kryen ndonjërin nga funksionet e prodhimit apo furnizimit nuk mundet, drejtpërdrejt apo tërthorazi, të kontrollojë apo të ushtrojë të drejta mbi operatorin e sistemit të bartjes nga një Shtet Anëtar që ka zgjedhur shturjen e plotë të pronësisë.
- (19) Sipas kësaj Direktive, në tregun e brendshëm të gazit natyror do të ekzistojnë lloje të ndryshme të organizimit të tregut. Masat që Shteti Anëtar do të mund të merrte në kuptimin e sigurimit të mjedisit të barabartë duhen bazuar në obligimet mbizotëruese të interesit të përgjithshëm. Komisioni duhet konsultuar mbi përputhshmërinë e masave me Traktatin dhe legjislacionin e Komunitetit.
- (20) Implementimi i shturjes efektive duhet të respektojë parimin e mos-diskriminimit mes sektorit publik dhe atij privat. Në këtë drejtim, i njëjti person nuk mund të jetë në gjendje të ushtrojë kontroll apo ndonjë të drejtë, në shkelje të rregullave të shturjes së pronësisë apo opsionit të operatorit të sistemit të pavarur, bashkërisht apo ndaras, mbi përbërjen, votimin apo vendimin e organeve të operatorëve të sistemit të bartjes apo sistemeve të bartjes, si dhe sipërmarrjeve të prodhimit apo furnizimit. Sa i përket shturjes së pronësisë dhe zgjidhjes së operatorit të pavarur të sistemit, me kusht që Shteti Anëtar në fjalë është në gjendje të demonstrojë që ai obligim respektohet, dy organe të ndara publike duhet të jenë në gjendje të kontrollojnë aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit në njërin anë, si dhe aktivitetet e bartjes në anën tjetër.
- (21) Ndarja e plotë efektive e aktiviteteve të rrjetit nga aktivitetet e furnizimit dhe prodhimit duhet të zbatohet në gjithë Komunitetin, për sipërmarrjet e Komunitetit dhe ato që nuk janë të Komunitetit. Për të siguruar që aktivitetet e rrjetit dhe aktivitetet e furnizimit dhe prodhimit në gjithë Komunitetin të mbeten të pavarura nga njëri-tjetri, autoritetet rregullatore duhen fuqizuar për të refuzuar certifikimin e operatorëve të sistemit të bartjes që nuk zbatojnë rregullat e shturjes. Për të siguruar zbatimin konsistent të këtyre rregullave në gjithë Komunitetin, autoritetet rregullatore duhet të marrin parasysh seriozisht mendimin e Komisionit kur marrin vendime për certifikim. Përveç kësaj, për të siguruar respektimin e obligimeve ndërkombëtare të Komunitetit dhe solidaritetit dhe sigurisë së energjisë brenda Komunitetit, Komisioni duhet të ketë të drejtë të japë mendim mbi certifikimin në lidhje me pronarin e sistemit të bartjes apo operatorin e sistemit të bartjes i cili kontrollohet nga një person apo persona nga një vend apo disa vende të treta.
- (22) Siguria e furnizimit të energjisë është element thelbësor i sigurisë publike dhe si e tillë është pandashëm e lidhur me funksionimin efikas të tregut të brendshëm të gazit dhe integrimin e tregjeve të izoluara të gazit në Shtetet Anëtare. Gazi mund të arrijë tek qytetarët e Bashkimit vetëm përmes rrjetit. Tregjet e hapura e

funktionale të gazit, si dhe në veçanti, rrjetet dhe asetet tjera të ndërlidhura me furnizimin e gazit janë thelbësore për sigurinë publike, për konkurrencën e ekonomisë dhe për mirëqenien e qytetarëve të Bashkimit. Personat nga vendet e treta pra duhet të lejohen të kontrollojnë një sistem bartjeje apo një operator të sistemit të bartjes nëse respektojnë kërkesat e ndarjes efektive të cilat vlejné brenda Komunitetit. Pa paragjykuar obligimet ndërkombëtare të Komunitetit, Komuniteti konsideron që sektori i sistemeve të bartjes së gazit ka rëndësi të madhe për Komunitetin, dhe për të, ka nevojë për masa mbrojtëse shtesë në lidhje me ruajtjen e sigurisë së furnizimit të energjisë në Komunitet, për të shmangur ndonjë kërcënim ndaj rendit dhe sigurisë publike në Komunitet dhe mirëqenien e qytetarëve të Bashkimit. Siguria e furnizimit të energjisë për Komunitetin kërkon në veçanti një vlerësim të pavarësisë së operacioneve të rrjetit, nivelin e varësisë së Komunitetit dhe Shteteve Anëtarë individuale ndaj furnizimi i energjisë nga vendet e treta, si dhe trajtimin e tregtisë vendore dhe të huaj dhe investimeve të energjisë në një vend të tretë të caktuar. Siguria e furnizimit pra duhet vlerësuar në dritën e rrethanave faktike të secilit rast, si dhe të drejtave dhe obligimeve që dalin nga e drejta ndërkombëtare, sidomos marrëveshjet ndërkombëtare mes Komunitetit dhe vendit të tretë në fjalë. Aty ku është e nevojshme, Komisioni inkurajohet të parashtojë rekomandime për negocimin e marrëveshjeve relevante me vendet e treta duke adresuar sigurinë e furnizimit të energjisë për Komunitetin, apo që të përfshijë çështje të domosdoshme në negociatat tjera me ato vende të treta.

- (23) Masa të mëtutjeshme duhen ndërmarrë për të siguruar tarifa transparente dhe jo-diskriminuese për qasje në transport. Ato tarifa duhet të jenë të vlefshme për gjithë shfrytëzuesit në baza jo-diskriminuese. Aty ku stabilimenti i depozitimit, depozitimi në sistem apo shërbimeve ndihmëse funksionon në treg mjaftueshëm konkurrent, qasja duhet lejuar në baza të mekanizmave transparentë dhe jo-diskriminues të bazuar në treg.
- (24) Është e domosdoshme që të sigurohet pavarësia e operatorëve të sistemit të depozitimit për të përmirësuar qasjen e palës së tretë në stabilimente të depozitimit që janë teknikisht dhe/ose ekonomikisht të domosdoshme për sigurimin e qasjes efikase në sistem për furnizim të konsumatorëve. Kështu, është e përshtatshme që stabilimentet e depozitimit të operohen përmes subjekteve juridikisht të ndara që kanë të drejta efektive të vendim-marrjes në kuptimin e aseteve të domosdoshme për të mirëmbajtur, operuar dhe zhvilluar stabilimentet e depozitimit. Është gjithashtu e domosdoshme të rritet transparenca në kuptimin e kapaciteteve të depozitimit që i ofrohen palëve të treta, duke obliguar Shtetet Anëtare të definojnë dhe publikojnë një kornizë jo-diskriminuese dhe të qartë që përcakton regjimin e duhur rregullator që vlen për stabilimentet e depozitimit. Ai obligim nuk duhet të kërkojë vendim tjetër për regjimet e qasjes, por duhet të përmirësojë transparençën në lidhje me regjimin e qasjes në depozitime. Kërkesat e fshehtësisë për informatat me ndjeshmëri komerciale janë veçanërisht të rëndësishme kur ka të bëjë me të dhëna të natyrës strategjike apo kur ka një shfrytëzues të vetëm të një stabilimenti të depozitimit.
- (25) Qasja jo-diskriminuese në rrjet të shpërndarjes përcakton qasjen në rrjedhë të poshtme për konsumatorët në nivel të pakicës. Fushëveprimi i diskriminimit në lidhje me qasjen e palës së tretë dhe investimet është megjithatë shumë më pak i konsiderueshëm në nivel të shpërndarjes sesa në nivelin e bartjes, ku dyndja dhe

ndikimi i interesave të prodhimit janë përgjithësisht më të mëdha sesa në nivelin e shpërndarjes. Për më tepër, shturja juridike dhe funksionale e operatorëve të sistemit të shpërndarjes ka qenë obligative, në bazë të Direktivës 2003/55/EC, vetëm prej 1 korrikut 2007, si dhe efektet e saj në tregun e brendshëm të gazit natyror ende duhen vlerësuar. Rregullat për shturjen juridike dhe funksionale aktualisht në fuqi mund të çojnë në shturje efektive me kusht që të jenë më qartë të definuara, të zbatuara në mënyrë të mirëfilltë dhe të monitoruara së afërmi. Për të krijuar një mjedis të barabartë në nivel të pakicës, aktivitetet e operatorëve të sistemit të shpërndarjes pra duhen monitoruar ashtu që të pengohen nga shfrytëzimi i integritetit vertikal në kuptimin e pozitës së tyre konkurrense në treg, sidomos në lidhje me konsumatorët amvisnorë dhe konsumatorët e vegjël jo-amvisnorë.

- (26) Shtetet Anëtare duhet të marrin masa konkrete për të ndihmuar shfrytëzimin më të gjerë të bio-gazit dhe gazit nga biomasa, prodhuesit e të cilëve duhet të gëzojnë qasje jo-diskriminuese ndaj sistemit të gazit, me kusht që qasja e tillë të jetë në përputhje me rregullat përkatëse teknike dhe standardet e sigurisë në baza të vazhdueshme.
- (27) Për të shmangur vendosjen e barrave joproporcionale financiare dhe administrative mbi operatorët e sistemit të shpërndarjes, Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje, kudo që është e nevojshme, të lirojnë sipërmarrjet në fjalë nga kërkesat e shturjes juridike të shpërndarjes.
- (28) Aty ku përdoret sistemi i mbyllur i shpërndarjes për të siguruar efikasitetin optimal të një furnizimi të integruar të energjisë, që kërkon standarde specifike operacionale, apo ku sistemi i mbyllur i shpërndarjes ruhet kryesisht për shfrytëzim nga pronari i sistemit, duhet të jetë e mundur të lirohet operatori i sistemit të shpërndarjes nga obligimet të cilat do të mund të përbënin barrë të panevojshme administrative për shkak të raportit të veçantë mes operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe shfrytëzuesve të sistemit. Zonat e shërbimeve industriale, komerciale apo të ndara, si ndërtesat e stacioneve hekurudhore, aeroportet, spitalet, zonat e mëdha të kampingut me stabilimente të integruara, apo zonat e industrisë kimike mund të kenë sisteme të mbyllura të shpërndarjes për shkak të natyrës së specializuar të operacioneve të tyre.
- (29) Direktiva 2003/55/EC ka vendosur një obligim për Shtetet Anëtare që të themelojnë rregullatorë me kompetenca specifike. Megjithatë, përvoja tregon që efektshmëria e rregullimit shpesh pengohet nga mungesa e pavarësisë së rregullatorëve nga qeveria, si dhe kompetenca e liri të pamjaftueshme. Për atë arsye, në takimin e tij më 8 dhe 9 mars 2007, Këshilli Evropian ka ftuar Komisionin të hartojë propozime legislative që obligojnë harmonizim të mëtutjeshëm të kompetencave dhe përforcim të pavarësisë së rregullatorëve shtetërorë të energjisë. Duhet të jetë e mundur që ato autoritete shtetërore rregullatore të mbulojnë edhe sektorin e energjisë elektrike edhe atë të gazit.
- (30) Rregullatorët e energjisë duhet të jenë në gjendje të marrin vendime në lidhje me gjitha çështjet përkatëse rregullatore nëse duan që tregu i brendshëm i gazit natyror të funksionojë siç duhet, si dhe që të jenë plotësisht të pavarur nga interesat tjerë publikë apo privatë. Këto nuk parandalojnë as shqyrtimin gjyqësor e as mbikëqyrjen parlamentare në pajtim me të drejtën kushtetuese të Shteteve

Anëtare. Përveç kësaj, miratimi i buxhetit të rregullatorit nga ligjvënësi shtetëror nuk përbën pengesë ndaj autonomisë buxhetore. Dispozitat në lidhje me autonominë në implementimin e buxhetit të ndarë duhen zbatuar brenda kornizës së përkufizuar me ligjin shtetëror të buxhetit dhe rregullat e tij. Derisa kontribuojnë në pavarësinë e autoritetit shtetëror rregullator nga çdo interes politik apo ekonomik përmes një skeme të përshtatshme të rotacionit, duhet të jetë e mundur për Shtetet Anëtare që të marrin parasysh edhe disponueshmërinë e resurseve njerëzore dhe të madhësisë së bordit.

- (31) Për të siguruar qasje efektive në treg për gjithë aktorët e tregut, duke përfshirë ata që hyjnë rishtas, ka nevojë për mekanizma balancues jo-diskriminues dhe që reflektojnë koston. Kjo duhet arritur përmes vendosjes së mekanizmave transparentë të bazuar në treg për furnizimin dhe blerjen e gazit, të nevojshëm në kuadër të kërkesave për balancim. Autoritetet Shtetërore rregullatore duhet të luajnë rol aktiv në sigurimin që tarifat e balancimit të jenë jo-diskriminues dhe reflektues të koston. Njëkohësisht, duhen ofruar stimuj të përshtatshëm për të balancuar hyrjen dhe daljet e gazit dhe për të mos rrezikuar sistemin.
- (32) Autoritetet shtetërore rregullatore duhet të jenë në gjendje të caktojnë apo miratojnë tarifat, ose metodologjitë e kalkulimit të tarifave, në bazë të një propozimi nga operatori i sistemit të bartjes apo operatori(ët) e sistemit të shpërndarjes apo operatori i sistemit të gazit të lëngshëm natyror (GLN), ose në bazë të një propozimi të përbashkët nga ata operatorë si dhe shfrytëzuesit e rrjetit. Në kryerjen e detyrave të tilla, autoritetet rregullatore shtetërore duhet të sigurojnë që tarifat e shpërndarjes dhe bartjes të jenë jo-diskriminuese dhe reflektuese të koston, si dhe duhet të marrin parasysh koston afatgjate, margjinale, të shmangur të rrjetit nga masat e menaxhimit të anës së kërkesës.
- (33) Rregullatorët e energjisë duhet të kenë kompetencën për nxjerrjen e vendimeve obligative në lidhje me sipërmarrjet e gazit natyror dhe të vendosin sanksione efektive, proporcionale dhe zbindëse mbi sipërmarrjet e gazit natyror të cilat dështojnë të respektojnë obligimet e tyre apo të propozojnë tek një gjykatë kompetente që të vendosë sanksione të tilla mbi to. Rregullatorët e energjisë gjithashtu duhet të kenë kompetencën të vendosin, pa marrë parasysh aplikimin e rregullave të konkurrencës, mbi masat e përshtatshme për sigurimin e përfitimeve të konsumatorit përmes promovimit të konkurrencës efektive të domosdoshme për funksionimin e mirëfilltë të tregut të brendshëm të gazit natyror. Themelimi i programeve të lirimit të gazit është një prej masave të mundshme që mund të përdoren për të promovuar konkurrencë efektive dhe për të siguruar funksionimin e mirëfilltë të tregut. Rregullatorët e energjisë duhet gjithashtu të kenë kompetencën për të kontribuar në sigurimin e standardeve të larta të shërbimit publik në përputhje me hapjen e tregut, në mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm, si dhe në efektshmërinë e plotë të masave të mbrojtjes së konsumatorëve. Ato dispozita duhet të jenë pa paragjykim ndaj kompetencave të Komisionit në lidhje me zbatimin e rregullave e konkurrencës, duke përfshirë hulumtimin e përbashkimeve me dimension Komuniteti, si dhe rregullave për tregun e brendshëm si lëvizja e lirë e kapitalit. Organi i pavarur tek i cili pala e prekur nga vendimi i rregullatorit shtetëror ka të drejtë ankese mund të jetë gjykatë apo ndonjë tribunal tjetër i fuqizuar për të kryer një shqyrtim gjyqësor.

- (34) Çdo harmonizim i kompetencave të autoriteteve shtetërore rregullatore duhet të përfshirë kompetencat për të ofruar stimuj për sipërmarrjet e gazit natyror dhe për të vendosur sanksione efektive, proporcionale dhe zbindëse mbi sipërmarrjet e gazit natyror apo që të propozojnë që një gjykatë kompetente të vendosë sanksione të tilla. Për më tepër, autoritetet rregullatore duhet të kenë kompetencën të kërkojnë informata përkatëse nga sipërmarrjet e gazit natyror, të bëjnë hetime të duhura dhe të mjaftueshme si dhe të zgjidhin mosmarrëveshje.
- (35) Investimet në infrastruktura të reja madhore duhet promovuar fuqimisht, derisa sigurohet funksionimi i mirëfilltë i tregut të brendshëm të gazit natyror. Për të avancuar efektin pozitiv të projekteve të liruara të infrastrukturës për konkurrencë dhe siguri të furnizimit, interesat e tregut gjatë fazës së planifikimit të projektit duhen testuar, derisa rregullat e menaxhimit të dyndjeve duhet të zbatohen. Aty ku infrastruktura shtrihet në territorin e më shumë se një Shteti Anëtar, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, themeluar me Rregulloren (EC) Nr. 713/2009 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 13 korrik 2009 për themelimin e Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë <sup>(7)</sup> (Agjencia), duhet të trajtojë si zgjidhje e fundit kërkesën për lirim, për të trajtuar më mirë implikimet e veta ndërkufitare dhe për të mundësuar trajtimin e saj administrativ. Për më tepër, duke marrë parasysh profilin e jashtëzakonshëm të rrezikut të ndërtimit të atyre projekteve madhore të liruara të infrastrukturës, duhet të jetë e mundur përkohësisht që të jepen shmangie të pjesshme për sipërmarrjet me interesa furnizimi dhe prodhimi në kuptimin e rregullave të shthurjes për projektet në fjalë. Mundësia e shmangieve të përkohshme duhet të vlejë, për arsye të sigurisë së furnizimit, për rrjetet e reja gazsjellëse brenda Komunitetit që transportojnë gazin nga vendet e treta në Komunitet. Shmangiet e dhëna sipas Direktivës 2003/55/EC vazhdojnë të vlejën deri në datën e planifikuar të skadimit ashtu siç është vendosur në vendimin e dhënies së shmangies.
- (36) Tregu i brendshëm i gazit natyror vuan nga mungesa e likuiditetit dhe transparencës, që pengon ndarjen efikase të resurseve, shmangien e rreziqeve dhe hyrjet e reja në treg. Besimi në treg, likuiditetin e tij dhe numri i pjesëmarrësve në treg duhen rritur, dhe për këtë, duhet që mbikëqyrja rregullatore e sipërmarrjeve aktive në furnizimin e gazit duhet rritur. Kërkesat e tilla duhen zbatuar pa paragjykuar, si dhe duke qenë në përputhje me, ligjin ekzistues të Komunitetit në lidhje me tregjet financiare. Rregullatorët e energjisë dhe rregullatorët e tregut financiar duhet të bashkëpunojnë me njëri tjetrin për të pasur një pasqyrë të tregjeve në fjalë.
- (37) Gazi natyror kryesisht, dhe përditë e më shumë, importohet në Komunitet nga vendet e treta. Ligji i Komunitetit duhet të marrë parasysh karakteristikat e gazit natyror, siç janë veçoritë e rigjeditetit struktural që rrjedhin nga koncentrimi i furnizuesve, kontratat afatgjate apo mungesa e likuiditetit në rrjedhë të poshtme. Kështu, ka nevojë për më shumë transparencë, duke përfshirë atë në kuptimin e formimit të çmimeve.
- (38) Para miratimit të Udhëzimeve që definojnë më tutje kërkesat e mbajtjes së shënimeve nga Komisioni, Agjencia dhe Komiteti i Rregullatorëve Evropian të

---

<sup>7</sup> Shih faqen 1 të kësaj Gazete Zyrtare.



Letrave me Vlerë (CESR), themeluar me Vendimin e Komisionit 2009/77/EC<sup>8</sup>) në kuptimin e përmbajtjes së tyre. Agjencia dhe CESR duhet gjithashtu të bashkëpunojnë në hetimin e mëtutjeshëm dhe këshillimin mbi atë nëse transaksionet me kontrata të furnizimit të gazit dhe derivateve të gazit i duhen nënshtruar kërkesave të transparencës para dhe pas tregtisë, si dhe nëse bëhet kështu, cila duhet të jetë përmbajtja e atyre kërkesave.

- (39) Shtetet Anëtare, ose kur është përcaktuar ashtu nga Shteti Anëtar, autoriteti rregullator, duhet të inkurajojë zhvillimin e kontratave me furnizim të ndërprershëm.
- (40) Në interesin e sigurisë së furnizimit, baraspeshimi mes ofertës dhe kërkesës në Shtete Anëtare individuale duhet monitoruar, derisa monitorimi i tillë duhet pasuar nga një raport mbi gjendjen në nivel komuniteti, duke marrë parasysh kapacitetin e interkoneksioneve mes zonave. Monitorimi i tillë duhet bërë mjaft herët për të mundësuar marrjen e masave të duhura nëse komprometohet siguria e furnizimit. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së domosdoshme të rrjetit, duke përfshirë kapacitetin e interkoneksionit, duhet të kontribuojë në të siguruarit të një furnizimi stabil me gaz.
- (41) Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që, duke marrë parasysh kërkesat e nevojshme për cilësi, biogazi dhe gazi nga biomasa apo llojet tjera të gazit të gëzojnë qasje jo-diskriminuese ndaj sistemit të gazit, me kusht që qasja e tillë të jetë gjithmonë në përputhje me rregullat përkatëse teknike dhe standardet e sigurisë. Ato rregulla e standarde duhet të sigurojnë që ato gazra të mundën teknikisht dhe me siguri të injektohen dhe të transportohen përmes sistemit të gazit natyror, si dhe duhet të adresojnë karakteristikat e tyre kimike.
- (42) Kontratat afatgjate do të vazhdojnë të jenë pjesë e rëndësishme e furnizimit të gazit të Shteteve Anëtare si dhe duhen ruajtur si opsion për sipërmarrjet e furnizimit të gazit, deri në atë masë sa që të mos rrënojnë synimin e kësaj Direktive dhe të jenë në përputhje me Traktatin, duke përfshirë rregullat e konkurrencës. Pra, është e domosdoshme që të merren parasysh kontratat afatgjate në planifikimin e kapacitetit të furnizimit dhe transportit të sipërmarrjeve të gazit natyror.
- (43) Për të siguruar ruajtjen e standardeve të larta të shërbimit publik në Komunitet, gjitha masat e ndërmarra nga Shtetet Anëtare për arritjen e synimeve të kësaj Direktive i duhen njoftuar rregullisht Komisionit. Komisioni duhet rregullisht të publikojë një raport që analizon masat e ndërmarra në nivel shtetëror për arritjen e synimeve të shërbimit publik dhe krahason efektshmërinë e tyre, me qëllim të ofrimit të rekomandimeve në lidhje me masat që duhen marrë në nivel shtetëror për të arritur standarde të larta të shërbimit publik. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që kur janë të lidhur me sisteme gazi, konsumatorët të jenë të informuar për të drejtat e tyre për t'u furnizuar me gaz natyror të një cilësie të specifikuar me çmime të arsyeshme. Masat e ndërmarra nga Shtetet Anëtare për të mbrojtur konsumatorët fundorë mund të dallojnë në atë nëse janë të orientuara kah konsumatorët amvisnorë apo ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- (44) Respektimi i kërkesave të shërbimit publik është kërkesë themelore e kësaj

---

<sup>8</sup> OJ L 25, 29.1.2009, f. 18

Direktive, si dhe është e rëndësishme që standardet e zakonshme minimale, që respektohen nga gjitha Shtetet Anëtare, të jenë të specifikuar me këtë Direktivë, të cilat marrin parasysh synimet e mbrojtjes së përgjithshme, sigurisë së furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe nivelet ekuivalente të konkurrencës në gjitha Shtetet Anëtare. Është me rëndësi që kërkesat e shërbimit publik të mund të interpretohen në baza shtetërore, duke marrë parasysh rrethanat shtetërore si dhe duke iu nënshtruar ligjit të Komunitetit.

- (45) Duhet të jetë e mundur që masat e ndërmarra nga Shtetet Anëtare të arrijnë synimet e kohezionit social dhe ekonomik të përfshirjes, në veçanti, të ofrimit të stimujve adekuatë ekonomikë, duke shfrytëzuar, aty ku është e përshtatshme, gjitha mjetet ekzistuese shtetërore dhe të Komunitetit. Duhet të jetë e mundur që ato mjete të përfshijnë mekanizmat e përgjegjësive për të garantuar investimet e domosdoshme.
- (46) Deri në masën në të cilën masat e ndërmarra nga Shtetet Anëtare për të përmbushur obligimet e shërbimit publik përbëjnë Ndhimë Shtetërore sipas nenit 87(1) të Traktatit, ekziston një obligim sipas nenit 88(3) të Traktatit për t'i njoftuar ato tek Komisioni.
- (47) Kërkesat e shërbimit publik dhe standardet e zakonshme minimale që dalin nga to duhen përforcuar më tutje për të siguruar që gjithë konsumatorët, sidomos ata të cenueshmit, të mund të përfitojnë nga konkurrenca dhe çmimet fer. Kërkesat e shërbimit publik duhen përcaktuar në nivel shtetëror, duke marrë parasysh rrethanat shtetërore; megjithatë, ligji i Komunitetit duhet respektuar nga Shtetet Anëtare. Qytetarët e Bashkimit, si dhe në rastet kur Shtetet Anëtare e konsiderojnë të përshtatshme, edhe ndërmarrjet e vogla, duhet të jenë në gjendje të gëzojnë obligimet e shërbimit publik, sidomos në kuptimin e sigurisë së furnizimit dhe tarifave të arsyeshme. Një aspekt kyç në furnizimin e konsumatorëve është qasja në të dhëna objektive dhe transparente të konsumit. Kështu, konsumatorët duhet të kenë qasje në të dhënat e tyre të konsumit dhe çmimet përcjellëse dhe koston e shërbimeve, ashtu që të mund të ftojnë konkurrentët të bëjnë oferta në bazë të atyre të dhënave. Konsumatorët gjithashtu duhet të kenë të drejtë të informohen plotësisht mbi konsumin e tyre të energjisë. Parapagimet duhet të reflektojnë konsumin e mundshëm të gazit natyror, si dhe sistemet e ndryshme të pagesës duhet të jenë jo-diskriminues. Informatat mbi koston e energjisë që i ofrohet konsumatorëve mjaft shpesh do të krijojnë stimuj për kursime të energjisë, sepse i japin konsumatorëve informata direkte për investimet në eficiency të energjisë dhe ndryshim të sjelljes së tyre.
- (48) Interesat e konsumatorëve duhet të jenë në zemër të kësaj Direktive, derisa cilësia e shërbimit duhet të jetë përgjegjësi qendrore e sipërmarrjeve të gazit natyror. Të drejtat ekzistuese të konsumatorëve duhen përforcuar dhe garantuar, si dhe duhet të përmbajnë më shumë transparencë. Mbrojtja e konsumatorëve duhet të sigurojë që gjithë konsumatorët në gamën e gjerë të Komunitetit të përfitojnë nga tregu konkurrent. Të drejtat e konsumatorëve duhen zbatuar nga Shtetet Anëtare, ose në rastet ku është përcaktuar ashtu nga Shteti Anëtar, nga autoriteti rregullator.
- (49) Informatat e qarta dhe gjithëpërfshirëse duhen vënë në dispozicion të konsumatorëve në lidhje me të drejtat e tyre në sektorin e energjisë. Komisioni

duhet të përcaktojë, pas konsultimit të palëve përkatëse, duke përfshirë Shtetet Anëtare, autoritetet rregullatore shtetërore, organizatat e konsumatorëve dhe sipërmarrjet e gazit natyror, një listë kontrolluese të qasshme, miqësore për shfrytëzuesit, për konsumatorët e energjisë, me informata praktike për të drejtat e tyre. Ajo listë e konsumatorit të energjisë duhet t'i ofrohet secilit konsumator si dhe duhet publikuar.

- (50) Varfëria energjetike është problem në rritje në Komunitet. Shtetet Anëtare të cilat janë prekur dhe që ende nuk kanë bërë këtë, duhet të hartojnë plane shtetërore veprimi apo korniza tjera të përshtatshme për t'u përballur me varfërinë energjetike, me qëllim të zvogëlimit të numrit të njerëzve që vuajnë nga ajo gjendje. Në çdo rast, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë furnizimin e domosdoshëm të energjisë për konsumatorët e cenueshëm. Në këtë drejtim, do të mund të përdorej një qasje e integruar, si korniza e politikës sociale, derisa masat do të mund të përfshinin politikat sociale apo përmirësimet e efijencës së energjisë në banim. Më së paku, kjo Direktivë duhet të mundësojë politika shtetërore në të mirë të konsumatorëve të cenueshëm.
- (51) Mbrojtja më e madhe e konsumatorëve garantohet me disponueshmëri të mjeteve efektive të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për gjithë konsumatorët. Shtetet Anëtare duhet të themelojnë procedura të shpejta dhe efektive të shqyrtimit të ankesave.
- (52) Duhet të jetë e mundur që të bazohet futja e sistemeve inteligjente të njehsimit në një vlerësim ekonomik. Nëse një vlerësim i tillë tregon që futja e sistemeve të tilla të njehsimit është ekonomikisht e arsyeshme dhe efektive në kosto vetëm për konsumatorë me një sasi të caktuar të konsumit të gazit, Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të marrin këtë parasysh kur implementojnë sisteme inteligjente të njehsimit.
- (53) Çmimet e tregut duhet të ofrojnë stimujt e duhur për zhvillimin e tregut.
- (54) Promovimi i konkurrencës së drejtë dhe qasjes së lehtë për furnizues të ndryshëm duhet të ketë rëndësinë më të madhe për Shtetet Anëtare në kuptimin e lehtësimit të shfrytëzimit të plotë të mundësive të një tregu të liberalizuar të gazit natyror nga konsumatorët.
- (55) Për të kontribuar në sigurinë e furnizimit, derisa ruhet fryma e solidaritetit mes Shteteve Anëtare, sidomos në rastin e krizave të furnizimit të energjisë, është me rëndësi të sigurohet një kornizë e bashkëpunimit rajonal në frymën e solidaritetit. Bashkëpunimi i tillë mund të mbështetet, nëse Shtetet Anëtare vendosin kështu, më së pari dhe më së shumti tek mekanizmat e bazuar në treg. Bashkëpunimi për promovimin e solidariteti rajonal dhe bilateral nuk duhet të ngarkojë në masë disproporcionale apo të diskriminojë mes pjesëmarrësve në treg.
- (56) Me qëllim të krijimit të tregut të brendshëm të gazit natyror, Shtetet Anëtare duhet të nxisin integrimin e tregjeve të tyre shtetërore dhe bashkëpunimin e operatorëve të sistemit në nivel të Komunitetit dhe rajonit, duke inkorporuar edhe sistemet e izoluara që formojnë ishuj gazi të cilat vazhdojnë të qëndrojnë në Komunitet.
- (57) Zhvillimi i tregut të vërtetë të brendshëm të gazit natyror, përmes një rrjeti të lidhur përgjatë gjithë Komunitetit, duhet të jetë një prej qëllimeve kryesore të kësaj Direktive dhe çështjet rregullatore për interkoneksionet ndërkufitare dhe tregjet rajonale duhet pra të jenë mes detyrave kryesore të autoriteteve rregullatore, në

bashkëpunim të afërt me Agjencinë, kudo që është e rëndësishme.

- (58) Sigurimi i rregullave të përbashkëta për një treg të vërtetë të brendshëm dhe një furnizim të gjerë të gazit gjithashtu duhet të jetë një prej qëllimeve kryesore të kësaj Direktive. Në këtë drejtim, çmimet e rregullta të tregut do të duhej të ofronin një stimul për interkoneksione ndërkufitare derisa çojnë, në afat të gjatë, në përputhje të çmimeve.
- (59) Autoritetet rregullative gjithashtu duhet të ofrojnë informata për tregun, për t'i mundësuar Komisionit të ushtrorë rolin e tij të vëzhgimit dhe monitorimit të tregut të brendshëm të gazit natyror, si dhe evoluimin e tij në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë, duke përfshirë aspektet si oferta dhe kërkesa, infrastruktura e bartjes dhe shpërndarjes, cilësia e shërbimit, tregtia ndërkufitare, menaxhimi i dyndjes, investimet, çmimet e shumicës dhe të konsumatorëve, likuiditeti i tregut dhe përmirësimet mjedisore dhe të efijencës. Autoritetet shtetërore rregullatore duhet t'i raportojnë autoriteteve të konkurrencës dhe Komisionit ato Shtete Anëtare në të cilat çmimet pengojnë konkurrencën dhe funksionimin e mirëfilltë të tregut.
- (60) Pasi synimi i kësaj Direktive, gjegjësisht krijimi i tregut të brendshëm plotësisht funksional të gazit natyror, nuk mund të arrihet plotësisht nga Shtetet Anëtare dhe si i tillë mund të arrihet më mirë në nivel Komuniteti, Komuniteti mund të miratojë masa, në pajtim me parimin e subsidiaritetit siç përcaktohet me atë nen, kjo Direktivë nuk shkon përtej të domosdoshmes në kuptimin e arritjes së atij synimi.
- (61) Me rregulloren (EC) Nr. 715/2009 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 13 korrikut 2009 mbi kushtet për qasje në rrjete të bartjes së gazit natyror <sup>(9)</sup>, Komisioni mund të miratojë Udhëzime për të arritur shkallën e domosdoshme të harmonizimit. Udhëzimet e tilla, të cilat përbëjnë masa obligative implementimi, edhe në lidhje me dispozita të caktuara të kësaj Direktive, vegël e dobishme që mund të përshtatet shpejt kudo që është e nevojshme.
- (62) Masat e domosdoshme për zbatimin e kësaj Direktive duhen miratuar në pajtim me Vendimin e Këshillit 1999/468/EC të 28 qershorit 1999 që shtron procedurat për ushtrimin e kompetencave të implementimit që i janë bartur Komisionit <sup>(10)</sup>.
- (63) Në veçanti, Komisioni duhet të fuqizohet për të miratuar Udhëzimet e domosdoshme për sigurimin e shkallës minimale të harmonizimit të nevojshëm për arritjen e qëllimit të kësaj Direktive. Pasi këto masa janë të fushëveprimit të përgjithshëm dhe janë të dizajnuara të ndryshojnë elementet jo-thelbësore të kësaj Direktive, duke e plotësuar atë me elemente të reja jo-thelbësore, ato duhen miratuar në pajtim me procedurën rregullatore, bashkë me mbikëqyrjen e përcaktuar me nenin 5a të Vendimit 1999/468/EC.
- (64) Në pajtim me pikën 34 të Marrëveshjes Ndërinstitucionale për ligjvënien më të mirë <sup>(11)</sup>, të pjekur për të hartuar, për vete dhe në interes të Komunitetit, të tabelave vetanake, të cilat ilustrojnë për aq sa është e mundur, korrelacionin mes kësaj Direktive dhe masave të transpozimit, si dhe t'i bëjnë ato publike.
- (65) Duke marrë parasysh ndryshimet e bëra në Direktivën 2003/55/EC me këtë

<sup>9</sup> Shih faqen 36 të kësaj Gazete Zyrtare.

<sup>10</sup> OJ L 184, 17.7.1999, p. 23

<sup>11</sup> OJ C 321, 31.12.2003, p. 1.

Direktivë, është e dëshirueshme, për arsye të qartësisë dhe racionalizimit, që dispozitat në fjalë të rishkruhen ashtu që të përbashkohen në një tekst të vetëm të një Direktive të re.

- (66) Kjo Direktivë respekton të drejtat themelore, si dhe respekton parimet, të njohura sidomos me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian,

MIRATOJNË KËTË DIREKTIVË:

## KAPITULLI I

### LËNDA E RREGULLIMIT, FUSHËVEPRIMI DHE DEFINICIONET

#### *Neni 1*

#### **Lënda e rregullimit dhe fushëveprimi**

1. Kjo Direktivë përcakton rregullat e përbashkëta për bartjen, shpërndarjen, furnizimin dhe depozitimin e gazit natyror. Ajo përcakton rregullat në lidhje me organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror, qasjen në treg, kriteret dhe procedurat që vlejné për dhënien e autorizimeve për bartje, shpërndarje, furnizim dhe depozitim të gazit natyror dhe operim të sistemeve.
2. Rregullat e përcaktuara me këtë Direktivë për gazin natyror, përfshirë GLN-në, vlejné gjithashtu në mënyrë jo-diskriminuese për biogazin dhe gazin nga biomasa apo llojet tjera të gazit deri në atë masë që ato gazra munden teknikisht dhe me siguri të injektohen dhe të transportohen në sistemin e gazit natyror.

#### *Neni 2*

#### **Definicionet**

Për qëllimet e kësaj Direktive, vlejné definicionet në vijim:

1. "sipërmarrje e gazit natyror" do të thotë person fizik apo juridik që kryen së paku një nga funksionet në vijim: prodhim, bartje, shpërndarje, furnizim, blerje apo depozitim të gazit natyror, duke përfshirë GLN-në, që është përgjegjës për detyrat komerciale, teknike dhe/ose të mirëmbajtjes në lidhje me ato funksione, por që nuk përfshin konsumatorët fundorë;
2. "rrjeti gazsjellës në rrjedhë të sipërme" do të thotë secili gazsjellës apo rrjet gazsjellës që operohet dhe/ose ndërtohet si pjesë e një projekti të prodhimit të naftës apo gazit, apo përdoret për të bartur gazin natyror nga një apo më shumë projekte të tilla tek një impiant përpunimi apo terminal fundor të shtrirjes tokësore;
3. "bartje" do të thotë transporti i gazit natyror përmes një rrjeti, i cili kryesisht përbëhet nga rrjete gypash me presion të lartë, ndryshe nga rrjetet gazsjellëse në rrjedhë të sipërme, si dhe ndryshe nga pjesa e gypave me presion të lartë që kryesisht përdoren në kontekstin e shpërndarjes lokale të gazit natyror, me qëllim të ofrimit të tij tek konsumatorët, por pa përfshirë furnizimin;
4. "operator i sistemit të bartjes" do të thotë person fizik apo juridik që kryen funksionin e bartjes dhe është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes, si dhe nëse është e

domosdoshme, zhvillimin e sistemit të bartjes në një zonë të caktuar, si dhe kudo që vlen, interkoneksionet e tij me sistemet tjera, si dhe për të siguruar aftësinë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për transportimin e gazit;

5. "shpërndarje" do të thotë transporti i gazit natyror përmes rrjeteve lokale apo rajonale të gypave me qëllim të ofrimit për konsumatorë, por pa përfshirë furnizimin;
6. "operator i sistemit të shpërndarjes" do të thotë person fizik apo juridik që kryen funksionin e shpërndarjes dhe është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes, si dhe nëse është e domosdoshme, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe kudo që vlen, interkoneksionet e tij me sistemet tjera, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e gazit;
7. "furnizim" do të thotë shitje, duke përfshirë rishitjen, e gazit natyror, përfshirë GLN-në, tek konsumatorët;
8. "sipërmarrje e furnizimit" do të thotë person fizik apo juridik që kryen funksionin e furnizimit;
9. "stabiliment depozitimi" do të thotë stabiliment që përdoret për depozitimin e gazit natyror dhe që është pronë dhe/ose operohet nga një sipërmarrje e gazit natyror, përfshirë pjesën e stabilimenteve të GLN-së që përdoren për depozitim, por duke përjashtuar pjesën që përdoret për operacionet e prodhimit, si dhe duke përjashtuar stabilimentet që rezervohen ekskluzivisht për operatorët e sistemit të bartjes në kryerjen e funksioneve të tyre;
10. "operator i sistemit të depozitimit" do të thotë person fizik apo juridik që kryen funksionin e depozitimit dhe është përgjegjës për operimin me stabiliment depozitimi;
11. "stabiliment i GLN-së" do të thotë terminal që përdoret për lëngëzimin e gazit natyror, ose importimin, shkarkimin, dhe ri-gazifikimin e GLN-së, si dhe përfshin shërbimet ndihmëse dhe depozitimin e përkohshëm të nevojshëm për procesin e ri-gazifikimit dhe liferimin pasues tek sistemi i bartjes, por nuk përfshin asnjë pjesë të terminaleve të GLN-së që përdoren për depozitim;
12. "operator i sistemit të GLN-së" do të thotë person fizik apo juridik që kryen funksionin e lëngëzimit të gazit natyror, ose importimin, shkarkimin, si dhe ri-gazifikimin e GLN-së dhe është përgjegjës për operimin me stabilimentin e GLN-së;
13. "sistem" do të thotë rrjet i bartjes, rrjet i shpërndarjes, stabiliment i GLN-së dhe/ose stabiliment i depozitimit që është pronë dhe/ose operohet nga një sipërmarrje e gazit natyror, duke përfshirë depozitimit në sistem dhe stabilimentet e tij që furnizojnë me shërbime ndihmëse dhe ato të sipërmarrjeve të ndërlidhura të nevojshme për ofrimin e qasjes në bartje, shpërndarje dhe GLN;
14. "shërbime ndihmëse" do të thotë gjitha shërbimet e nevojshme për qasje dhe operim të rrjeteve të bartjes, rrjeteve të shpërndarjes, stabilimenteve të GLN-së, si dhe/ose stabilimenteve të depozitimit, duke përfshirë balancimin e ngarkesës, përzierjen dhe injektimin e gazrave inerte, por duke mos përfshirë stabilimentet e rezervuara ekskluzivisht për operatorët e sistemit të bartjes që kryejnë funksionet e tyre;
15. «Depozitimi në sistem» do të thotë depozitimi i gazit me kompresion në sisteme të bartjes dhe shpërndarjes së gazit, por duke mos përfshirë stabilimentet e rezervuara për operatorët e sistemit të bartjes që kryejnë funksionet e tyre;
16. "sistemi i interkonektuar" do të thotë një numër i sistemeve që janë të lidhur me njëri-

tjetrin;

17. "interkonektor" do të thotë linjë e bartjes që kalon apo shkon përmes kufirit mes Shteteve Anëtare me qëllim të vetëm të lidhjes së sistemeve shtetërore të bartjes të atyre Shteteve Anëtare;
18. "linjë direkte" do të thotë rrjet gazsjellës i gazit natyror plotësues ndaj sistemit të interkonektuar;
19. "sipërmarrje e integruar e gazit natyror" do të thotë sipërmarrje vertikalisht apo horizontalisht e integruar;
20. "sipërmarrje e integruar vertikalisht do të thotë sipërmarrje e gazit natyror, ose një grup sipërmarrjesh të gazit natyror ku i njëjti person apo të njëjtit persona kanë të drejtë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, që të ushtrojnë kontroll, si dhe ku sipërmarrja apo grupi i sipërmarrjeve kryejnë së paku një nga funksionet e bartjes, shpërndarjes, GLN-së apo depozitimit, si dhe së paku njërin nga funksionet e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror;
21. "sipërmarrje e integruar horizontalisht" do të thotë sipërmarrje që kryen së paku njërin nga funksionet e prodhimit, bartjes, shpërndarjes, furnizimit apo depozitimit të gazit natyror, si dhe një aktivitet që nuk lidhet me gazin;
22. "sipërmarrje e ndërlidhur" do të thotë një sipërmarrje e asocuar, brenda kuptimit të nenit 41 të Direktivës së Shtatë të Këshillit 83/349/EEC të 13 qershorit 1983, në bazë të nenit 44(2)(g) (\*) të Traktatit mbi Llogaritë e Konsoliduara <sup>(12)</sup> dhe/ose një sipërmarrje e asocuar, brenda kuptimit të nenit 33 (1) të asaj Direktive, dhe/ose një sipërmarrje që i përket të njëjtëve aksionarë;
23. "shfrytëzues i sistemit" do të thotë person fizik apo juridik që furnizon, apo furnizohet nga sistemi;
24. "konsumator" do të thotë konsumator me shumicë apo konsumator fundor i gazit natyror, ose sipërmarrje e gazit natyror që blen gazin natyror;
25. "konsumator amvisnor" do të thotë konsumator që blen gazin natyror për konsumin vetanak në amvisni;
26. "konsumator jo-amvisnor" do të thotë konsumator që blen gazin natyror që nuk është për shfrytëzimin e tij vetanak në amvisni;
27. "konsumator fundor" do të thotë konsumator që blen gazin natyror për shfrytëzim vetanak;
28. "konsumator i privilegjuar" do të thotë konsumator që është i lirë të blejë gazin nga një furnizues që zgjedh vetë, brenda kuptimit të nenit 37;
29. "konsumator me shumicë" do të thotë person fizik apo juridik, ndryshe nga operatori i sistemit të bartjes apo operatori i sistemit të shpërndarjes që blen gazin natyror me qëllim të rishitjes brenda apo jashtë sistemit ku ai është themeluar;
30. "planifikim afatgjatë" do të thotë planifikim i kapacitetit të furnizimit dhe transportit të sipërmarrjeve të gazit natyror në baza afatgjate me qëllim të mbulimit të kërkesës për gaz natyror të sistemit, diversifikimit të burimeve dhe sigurimit të furnizimeve për

---

\* Titulli i Direktivës 83/349/EEC është përshtatur për të marrë parasysh rinumërimin e neneve të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian në pajtim me nenin 12 të Traktatit të Amsterdimit; referimi fillestar i është bërë nenit 54(3)(g).

<sup>12</sup> OJ L 193, 18.7.1983, p. 1.

konsumatorë;

31. "treg në lindje" do të thotë një Shtet Anëtar në të cilin furnizimi i parë komercial i kontratës së parë afatgjate për furnizim të gazit natyror është bërë jo më shumë se 10 vjet më parë;
32. "siguri" do të thotë edhe siguri e furnizimit të gazit natyror edhe siguri teknike;
33. "infrastrukturë e re" do të thotë infrastruktura që nuk është përfunduar deri më 4 gusht 2003;
34. "kontratë e furnizimit të gazit" do të thotë kontratë për furnizimin e gazit natyror, por nuk përfshin derivatet e gazit;
35. "derivatet e gazit" do të thotë instrument financiar i përcaktuar me pikat 5, 6 ose 7 të Nenit C të Shtojcës I ndaj Direktivës 2004/39/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 21 prillit 2004 mbi tregjet e instrumenteve financiare <sup>(13)</sup> në rastet kur ai instrument ka të bëjë me gazin natyror;
36. "kontroll" do të thotë të drejtat, kontratat apo mënyrat tjera në të cilat, ndaras ose në kombinim, si dhe duke pasur parasysh konsideratën e faktit apo ligjit në këtë kuptim, bartet mundësia e ushtrimit të ndikimit vendimtar mbi një sipërmarrje, sidomos me anë të:
  - (a) pronësisë apo të drejtës për shfrytëzimin e gjitha apo një pjese të aseteve të një sipërmarrjeje;
  - (b) të drejtat apo kontratat të cilat mundësojnë ndikim vendimtar mbi përbërjen, votimin apo vendimet e organeve të një sipërmarrjeje.

## KAPITULLI II

### RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR ORGANIZIMIN E SEKTORIT

#### *Neni 3*

#### **Obligimet e shërbimit publik dhe mbrojtjes së konsumatorëve**

1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që, në bazë të organizimit të tyre institucional, si dhe me konsideratën e duhur ndaj parimit të subsidiaritetit, pa paragjykim ndaj paragrafit 2, sipërmarrjet e gazit natyror të operohen në pajtim me parimet e kësaj Direktive me qëllim të arritjes së një tregu konkurrent, të sigurt dhe të qëndrueshëm në kuptimin mjedisor të gazit natyror, si dhe që të mos diskriminojnë mes atyre sipërmarrjeve në kuptimin e të drejtave apo obligimeve të tyre.
2. Duke pasur plotësisht parasysh dispozitat përkatëse në Traktat, sidomos nenin 86 të tij, Shtetet Anëtare mund të vendosin obligime të shërbimit publik mbi sipërmarrjet që veprojnë në sektorin e gazit, në interes të përgjithshëm ekonomik, të cilat mund të kenë të bëjnë me sigurinë, duke përfshirë sigurinë e furnizimit, rregullsinë, cilësinë dhe çmimet e furnizimit, si dhe mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë eficiencën e energjisë, energjinë nga burimet e ripërtërishme dhe mbrojtjen klimatike. Obligimet e tilla duhet të jenë të definuara qartë, të jenë transparente, jo-diskriminuese, të verifikueshme dhe duhet të garantojnë barazi të qasjes për sipërmarrjet e gazit natyror të Komunitetit tek

---

<sup>13</sup> OJ L 145, 30.4.2004, p. 1.



konsumatorët shtetërorë. Në lidhje me sigurinë e furnizimit, eficientia e energjisë/menaxhimi i anës së kërkesës dhe për përmbushjen e qëllimeve mjedisore dhe qëllimet e energjisë nga burimet e ripërtërishe, siç përcaktohet me këtë paragraf, Shtetet Anëtare mund të vendosin implementimin e planifikimit afatgjatë, duke marrë parasysh mundësinë e palëve të treta që kërkojnë qasje në sistem.

3. Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorëve fundorë, si dhe në veçanti, duhet të sigurojnë që të ketë masa adekuate mbrojtëse për konsumatorët e cenueshëm. Në këtë kontekst, secili Shtet Anëtar duhet të përkufizojë konceptin e konsumatorëve të cenueshëm i cili mund t'i referohet varfërisë energjetike, si dhe mes tjerash, edhe ndalimit të shkyçjes së gazit për ata konsumatorë në kohë kritike. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të drejtat dhe obligimet që kanë të bëjnë me konsumatorët e cenueshëm të zbatohen. Në veçanti, ato duhet të marrin masat e përshtatshme për mbrojtjen e konsumatorëve fundorë në zonat e largëta të cilat janë të lidhura në sistemin e gazit. Shtetet Anëtare mund të emërojnë një furnizues si zgjidhje e fundit për konsumatorët e lidhur në sistemin e gazit. Ato duhet të sigurojnë nivele të larta të mbrojtjes së konsumatorëve, sidomos në kuptimin e transparencës në lidhje me kushtet dhe afatet kontraktuale, informatat e përgjithshme dhe mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që konsumatori i privilegjuar të jetë në fakt plotësisht i aftë të kalojë tek një furnizues tjetër. Sa i përket së paku konsumatorëve amvisnorë, këto masa duhet të përfshijnë edhe ato të përcaktuara me Shtojcën I.
4. Shtetet Anëtare duhet të ndër marrin masa të përshtatshme, si formulimi i planeve shtetërore të veprimit për energji, sigurimi i përfitimeve të sigurimit social për të siguruar furnizimin e domosdoshëm të gazit për konsumatorë të cenueshëm, ose përcaktimin e mbështetjes për përmirësimet e eficientës së energjisë, për të adresuar varfërinë energjetike aty ku gjendet, duke përfshirë edhe kontekstin e gjerë të varfërisë. Masat e tilla nuk duhet të pengojnë hapjen efektive të tregut të përcaktuar me nenin 37 dhe funksionimin e tregut, si dhe i duhen njoftuar Komisionit, aty ku është e nevojshme, në pajtim me paragrafin 11 të këtij neni. Njoftimi i tillë nuk duhet të përfshijë masat e ndërmarra brenda sistemit të përgjithshëm të sigurimit social.
5. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që gjithë konsumatorët e kyçur në rrjetin e gazit të kenë të drejtë të furnizohen me gaz nga një furnizues, duke iu nënshtruar marrëveshjes së furnizuesit, pa marrë parasysh Shtetin Anëtar në të cilin është regjistruar furnizuesi, për aq sa furnizuesi respekton rregullat e tregtimit dhe balancimit në fuqi dhe i nënshtrohet kërkesave të sigurisë së furnizimit. Në këtë drejtim, Shtetet Anëtare duhet të marrin gjitha masat e nevojshme për të siguruar që procedurat administrative të mos përbëjnë pengesë për sipërmarrjet furnizuese tanimë të regjistruara në një Shtet tjetër Anëtar.
6. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që:
  - (a) në rastet kur konsumatori, derisa respekton kushtet e kontratës, dëshiron të ndërrojë furnizuesin, ndërrimi mundësohet nga operatori(ët) në fjalë brenda tri javësh; si dhe
  - (b) konsumatorët kanë të drejtë të marrin gjitha të dhënat relevante të konsumit.

Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të drejtat e përmendura në pikat (a) dhe (b) të nën-paragrafit të parë i ofrohen konsumatorëve në mënyrë jo-diskriminuese në

kuptimin e kostos, përpjekjeve apo kohës.

7. Shtetet Anëtare duhet të ndër marrin masa të përshtatshme për arritjen e synimeve të kohezionit social dhe ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit, të cilat mund të përfshijnë mënyra për luftimin e ndryshimeve klimatike, si dhe sigurinë e furnizimit. Masat e tilla mund të përfshijnë në veçanti ofrimin e stimuljve adekuatë ekonomikë, duke shfrytëzuar, aty ku është e mundur, gjitha mjetet ekzistuese shtetërore dhe të Komunitetit, për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e infrastrukturave të domosdoshme të rrjetit, duke përfshirë kapacitetin e interkonektorëve.
8. Për promovimin e efikasitetit të energjisë, Shtetet Anëtare, apo në rastet kur është parashikuar ashtu nga Shteti Anëtar, autoriteti rregullator duhet të rekomandojë fuqimisht që sipërmarrjet e gazit natyror të optimizojnë shfrytëzimin e gazit, për shembull duke ofruar shërbime të menaxhimit të energjisë, duke zhvilluar formula inovative të çmimeve apo duke instaluar sisteme të njehsimit inteligjent, apo rrjete të mençura kudo që është e mundur.
9. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë ofrimin e pikave unike të kontaktit për t'i dhënë konsumatorëve gjitha informatat e nevojshme në lidhje me të drejtat e tyre, legjislacionin aktual dhe mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që iu përkasin atyre në rast të një mosmarrëveshjeje. Pikat e tilla të kontaktit mund të jenë pjesë e pikave informuese për konsumatorë.  
Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që një mekanizëm i pavarur, si ombudsmani i energjisë, apo një organ për konsumatorë, të jetë në gjendje të sigurojë trajtim efikas të ankesave dhe zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve me marrëveshje jashtëgjyqësore.
10. Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos zbatojnë dispozitat e nenit 4 në lidhje me shpërndarjen, deri në masën që zbatimi i tyre do të pengonte, ligjërisht apo faktikisht, përmbushjen e obligimeve të sipërmarrjeve të gazit natyror në interesin e përgjithshëm ekonomik dhe deri në masën që zhvillimi i tregtisë nuk do të ndikohej deri në atë masë sa të ishte në kundërshtim me interesat e Komunitetit. Interesat e Komunitetit përfshijnë, mes tjerash, konkurrencën në lidhje me konsumatorët e privilegjuar në pajtim me këtë Direktivë dhe nenin 86 të Traktatit.
11. Shtetet Anëtare duhet, me zbatimin e kësaj Direktive, të informojnë Komisionin mbi të gjitha masat e miratuara për përmbushjen e obligimeve të shërbimit publik, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorëve dhe mjedisit, si dhe efektin e tyre të mundshëm mbi konkurrencën në shtet dhe ndërkombëtarisht, pa marrë parasysh nëse ato masa kërkojnë apo jo shmangie nga dispozitat e kësaj Direktive. Ato duhet ta njoftojnë Komisionin vijimisht çdo dy vite për ndryshimet e atyre masave, pa marrë parasysh nëse kërkojnë apo jo shmangie nga kjo Direktivë.
12. Komisioni duhet të themelojë, në konsultim me palët e përfshira përkatëse, duke përfshirë Shtetet Anëtare, autoritetet rregullatore shtetërore, organizatat e konsumatorëve, si dhe sipërmarrjet e gazit natyror, një listë kontrolluese të qartë dhe koncize të konsumatorëve të energjisë në lidhje me të drejtat e konsumatorëve të energjisë. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që furnizuesit e gazit apo operatorët e sistemit të shpërndarjes, në bashkëpunim me autoritetin rregullator, të marrin hapat e domosdoshëm për t'i ofruar konsumatorëve të tyre një kopje të listës kontrolluese për konsumatorë të energjisë, si dhe të sigurojnë që ajo të bëhet publikisht e qasshme.

#### *Neni 4*

##### **Procedura e autorizimit**

1. Në rrethanat kur kërkohet një autorizim (për shembull licencë, leje, koncesion, pëlqim apo miratim) për ndërtimin apo operimin e stabilimenteve të gazit natyror, Shtetet Anëtare apo autoritetet kompetente që ato caktojnë duhet të japin autorizimet për ndërtimin dhe/ose operimin e atyre stabilimenteve, gazsjellësve dhe pajisjeve tjera përcjellëse në territorin e tyre, në pajtim me paragrafët 2 deri në 4. Shtetet Anëtare apo autoriteti kompetent që ato caktojnë mundën gjithashtu të lëshojnë autorizime në të njëjtat baza për furnizimin e gazit natyror dhe për konsumatorët me shumicë.
2. Në rastet kur Shtetet Anëtare kanë një sistem autorizimi, ato duhet të përcaktojnë kriteret objektive dhe jo-diskriminuese të cilat duhen përmbushur nga një sipërmarrje që aplikon për autorizimin e ndërtimit dhe/ose operimin me stabilimente të gazit natyror apo aplikon për një autorizim për furnizimin e gazit natyror. Kriteret dhe procedurat jo-diskriminuese për dhënien e autorizimeve duhen publikuar. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që procedurat e autorizimit për stabilimente, gazsjellës dhe pajisje përcjellëse të marrin parasysh rëndësinë e projektit për tregun e brendshëm të gazit natyror aty ku është e mundur.
3. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që arsyet për refuzimin e dhënies së autorizimit të jenë objektive dhe jo-diskriminuese, si dhe që t'i transmetohen aplikantit. Arsyet për refuzimin e tillë i duhen njoftuar Komisionit për informim. Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë një procedurë që i mundëson aplikantit të ankohet ndaj refuzimeve të tilla.
4. Për zhvillimin e zonave të furnizuara rishtas, si dhe operimin efikas në përgjithësi, si dhe pa paragjykuar nenin 38, Shtetet Anëtare mund të refuzojnë dhënien e autorizimit të mëtutjeshëm për ndërtimin dhe operimin me sisteme të gazsjellësit në shpërndarje në ndonjë zonë ta caktuar, pasi ato sisteme të gazsjellësit të jenë ndërtuar apo janë propozuar të ndërtohen në atë zonë, si dhe nëse kapaciteti ekzistues apo i propozuar nuk është ngopur.

#### *Neni 5*

##### **Monitorimi i sigurisë së furnizimit**

Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë monitorimin e çështjeve të sigurisë së furnizimit. Në rastet kur Shtetet Anëtare e konsiderojnë të përshtatshme, ato mund ta delegojnë atë detyrë tek autoritetet rregullatore të përmendura në nenin 39(1). Monitorimi i tillë në veçanti duhet të mbulojnë balancimin e ofertës dhe kërkesës në tregun shtetëror, nivelin e kërkesës së pritur në të ardhmen dhe ofertën në dispozicion, kapacitetin e parashikuar shtesë që është planifikuar apo është në ndërtim, si dhe cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së rrjeteve, bashkë me masat që merren për të mbuluar kërkesën në pik dhe për t'u përballur me mungesat e një apo më shumë furnizuesve. Autoritetet kompetente duhet të publikojnë, deri më 31 korrik të secilit vit, një raport që pasqyron gjetjet që dalin nga monitorimi i atyre çështjeve, si dhe masat e ndërmarra apo të parashikuara për adresimin e tyre, si dhe duhet t'i dërgojnë atë raport Komisionit menjëherë.

#### *Neni 6*

##### **Solidariteti rajonal**

1. Për të ruajtur një furnizim të sigurt në tregun e brendshëm të gazit natyror, Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë për të promovuar solidaritetin rajonal dhe bilateral.
2. Bashkëpunimi i tillë duhet të mbulojnë situatat që çojnë apo ka mundësi të çojnë në afat të shkurtër në një çrregullim të rëndë të furnizimit duke ndikuar kështu një Shtet Anëtar. Ai duhet të përfshijë:
  - a. Bashkërendimin e masave shtetërore emergjente të përmendura në nenin 8 të Direktivës së Këshillit 2004/67/EC të 26 prillit 2004 në lidhje me masat e mbrojtjes së sigurisë së furnizimit të gazit natyror <sup>(14)</sup>
  - b. Identifikimin, si dhe kudo që është e domosdoshme, zhvillimin apo avancimin e interkoneksioneve elektrike dhe të gazit natyror; si dhe
  - c. Kushtet dhe modalitetet praktike për ndihmën e ndërsjellë.
3. Komisioni dhe Shtetet tjera Anëtare duhet të mbahen të informuara për bashkëpunimet e tilla.
4. Komisioni mund të miratojë Udhëzime për bashkëpunim rajonal në frymën e solidaritetit. Ato masa, të dizajnuara për ndryshimin e elementeve jo-thelbësore të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, duhen miratuar në pajtim me procedurën rregullatore, bashkë me mbikëqyrjen e afërt, të përmendur në nenin 51(3).

## *Neni 7*

### **Promovimi i bashkëpunimit rajonal**

1. Shtetet Anëtare, bashkë me autoritetet rregullatore, duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin me qëllimin e integritetit të tregjeve të tyre shtetërore në një dhe më shumë nivele rajonale, si hap i parë drejt krijimit të një tregu plotësisht të liberalizuar të brendshëm. Në veçanti, autoritetet rregullatore, aty ku është parashikuar kështu nga Shtetet Anëtare, apo vetë Shtetet Anëtare duhet të promovojnë dhe lehtësojnë bashkëpunimin e operatorëve të sistemit të bartjes në nivel rajonal, duke përfshirë atë në çështjet ndërkufitare, me qëllim të krijimit të një tregu konkurrent të brendshëm të gazit natyror, të nxisin përputhshmërinë e kornizave të tyre juridike, rregullatore dhe teknike, si dhe të lehtësojnë integritetin e sistemeve të izoluar që formojnë ishuj të gazit që vazhdojnë të ekzistojnë në Komunitet. Zonat gjeografike të mbuluara nga ky bashkëpunim rajonal duhet të përfshijnë bashkëpunimin në zonat gjeografike të përkufizuara në pajtim me nenin 12(3) të Rregullores (EC) Nr. 715/2009. Bashkëpunimi i tillë mund të mbulojë edhe zona tjera gjeografike.
2. Agjencia duhet të bashkëpunojë me autoritetet shtetërore rregullatore dhe operatorët e sistemit të bartjes për të siguruar përputhshmërinë e kornizave rregullatore mes rajoneve, me qëllim të krijimit të tregut konkurrent të brendshëm të gazit natyror. Në rastet kur Agjencia konsideron që janë të nevojshme rregulla obligative për atë lloj bashkëpunimi, ajo do të ofrojë rekomandimet e duhura.
3. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë, përmes zbatimit të kësaj Direktive, që operatorët e sistemit të bartjes të kenë një apo më shumë sisteme të integruara në nivel rajonal, që mbulojnë dy apo më shumë Shtete Anëtare për ndarje të kapacitetit dhe për të kontrolluar sigurinë e rrjetit.
4. Në rastet ku operatorët e integruar të sistemit të bartjes marrin pjesë në një sipërmarrje

---

<sup>14</sup> OJ L 127, 29.4.2004, p. 92.

të përbashkët për implementimin e një bashkëpunimi të tillë, sipërmarrja e përbashkët duhet të përcaktojë dhe zbatojë një program të përputhshmërisë, i cili përcakton masat që duhen ndërmarrë për të siguruar eliminimin e sjelljeve diskriminuese dhe anti-konkurrencë. Programi i tillë i përputhshmërisë duhet të përcaktojë obligimet specifike të punëtorëve për arritjen e synimit të eliminimit të sjelljeve diskriminuese dhe anti-konkurrencë. Ai i duhet nënshtruar miratimit nga Agjencia. Respektimi i programit do të monitorohet në mënyrë të pavarur nga zyrtarët e përputhshmërisë nga operatorët e sistemit të integruar të bartjes vertikalisht të integruar.

## *Neni 8*

### **Rregullat teknike**

Autoritetet rregullatore në rastet kur është parashikuar kështu, apo vetë Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që kriteret e sigurisë teknike të jenë përcaktuar, si dhe rregullat teknike që vendosin dizajnin minimal teknik dhe kërkesat operacionale për lidhjen me sistemin e stabilimenteve të GLN-së, depozitimit, sistemet tjera të bartjes apo shpërndarjes, si dhe linjat direkte, të hartohen dhe të bëhen publike. Këto rregulla teknike duhet të sigurojnë ndërveprueshmërinë e sistemeve dhe duhet të jenë objektive dhe jo-diskriminuese. Agjencia mund të ofrojë rekomandime të përshtatshme drejt arritjes së përputhshmërisë së këtyre rregullave, kudo që është e përshtatshme. Këto rregulla duhet t'i njoftohen Komisionit në pajtim me nenin 8 të Direktivës 98/34/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 22 qershorit 1998, e cila përcakton procedurën për ofrimin e informatave në fushën e standardeve dhe rregulloreve teknike si dhe për rregullat mbi shërbimet e Shoqërisë Informative <sup>(15)</sup>.

## **KAPITULLI III**

### **BARTJA, DEPOZITIMI DHE GLN**

## *Neni 9*

### **Shturja e sistemeve të bartjes dhe operatorëve të sistemeve të bartjes.**

1. Shtetet anëtare do të sigurojnë që prej 3 marsit 2012:
  - a. secila sipërmarrje që ka në pronë një sistem të bartjes të funksionojë si operator i sistemit bartjes;
  - b. i njëjti apo të njëjtit persona nuk kanë të drejtë:
    - i. që drejtpërdrejt apo tërthorazi të ushtrojnë kontroll mbi ndonjë sipërmarrje që ushtron cilindo prej funksioneve të prodhimit apo furnizimit, e as të ushtrojnë kontroll apo ndonjë të drejtë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, mbi ndonjë operator sistemi të bartjes apo një sistem të bartjes; e as
    - ii. që drejtpërdrejt apo tërthorazi të ushtrojnë kontroll mbi ndonjë operator të sistemit të bartjes apo sistem të bartjes, e as të ushtrojnë kontroll apo ndonjë të drejtë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, mbi ndonjë sipërmarrje që ushtron ndonjë nga funksionet e prodhimit apo furnizimit;

---

<sup>15</sup> OJ L 204, 21.7.1998, p. 37.

- c. i njëjti apo të njëjtit persona nuk kanë të drejtë të emërojnë anëtarë të bordit mbikëqyrës, bordit administrativ apo organeve që ligjërisht përfaqësojnë sipërmarrjen, e një operatori të sistemit të bartjes apo sistemit të bartjes, e as që drejtpërdrejt apo tërthorazi të ushtrojnë kontroll apo ndonjë të drejt mbi ndonjë sipërmarrje që kryen ndonjërin prej funksioneve të prodhimit apo furnizimit; si dhe
  - d. i njëjti person nuk ka të drejtë të jetë anëtar i bordit mbikëqyrës, bordit administrativ apo organeve që ligjërisht përfaqësojnë sipërmarrjen, edhe të sipërmarrjes kryen ndonjërin prej funksioneve të prodhimit apo furnizimit edhe të operatorit të sistemit të bartjes apo sistemit të bartjes.
2. Të drejtat e përcaktuara me pikat (b) dhe (c) të paragrafit 1 përfshijnë në veçanti:
  - a. kompetencën e ushtrimit të të drejtave të votimit;
  - b. kompetencën për emërimin e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, bordit administrativ apo organeve që ligjërisht përfaqësojnë sipërmarrjen; ose
  - c. mbajtjen e shumicës së aksioneve.
3. Për qëllimet e paragrafit 1(b), nocioni “sipërmarrje që kryen ndonjërin prej funksioneve të prodhimit apo furnizimit” do të përfshijë “sipërmarrjet që kryejnë cilindo nga funksionet e gjenerimit dhe furnizimit” brenda kuptimit të Direktivës 2009/72/EC së Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 13 korrikut 2009 në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike<sup>16</sup>, derisa termat “operator i sistemit të bartjes” dhe “sistem i bartjes” përfshijnë “operatorin e sistemit të bartjes” dhe “sistemin e bartjes” brenda kuptimit të asaj Direktive.
4. Shtetet Anëtare mund të lejojnë shmangiet nga pikat (b) dhe (c) të paragrafit 1 deri më 3 mars 2013, me kusht që operatorët e sistemit të bartjes të mos jenë pjesë e një sipërmarrjeje vertikalisht të integruar.
5. Obligimi i përcaktuar me paragrafin 1(a) të këtij Neni konsiderohet të jetë përmbushur në situatën ku dy apo më shumë sipërmarrje që kanë në pronë sisteme të bartjes të kenë krijuar një kompani të përbashkët e cila vepron si operator i sistemit të bartjes në dy apo më shumë Shtete Anëtare për sistemet e bartjes në fjalë. Asnjë sipërmarrje tjetër nuk mund të jetë pjesë e asaj kompanie të përbashkët, përveç nëse është miratuar sipas nenit 14 si operator i pavarur sistemi apo si operator i pavarur i bartjes për qëllimet e Kapitullit IV.
6. Për zbatimin e këtij neni, aty ku personi i përmendur në pikat (b), (c) dhe (d) të paragrafit 1 është organ publik i Shtetit Anëtar apo organ publik tjetër, dy organet e ndara publike që ushtrojnë kontroll mbi një operator të sistemit të bartjes apo mbi një sistem të bartjes në njërin anë, si dhe mbi një sipërmarrje që kryen ndonjërin nga funksionet e prodhimit apo furnizimit në anën tjetër, do të konsiderohen të mos jenë person apo persona të njëjtë.
7. Shtetet anëtare do të sigurojnë që informatat e ndjeshme në kuptimin komercial të përmendura në nenin 16, që mbahen nga operatori i sistemit të bartjes që ka qenë pjesë e një sipërmarrjeje të integruar vertikalisht, e as nga personeli i atij operatori të sistemit të bartjes, të mos i barten sipërmarrjeve që kryejnë cilindo nga funksionet e prodhimit dhe furnizimit.

---

<sup>16</sup> Shih faqen 55 të kësaj Gazete Zyrtare.

8. Aty ku më 3 shtator 2009, sistemi i bartjes i përket sipërmarrjes së integruar vertikalisht, Shteti Anëtar mund të vendosë të mos zbatojë paragrafin 1. Në atë rast, Shteti Anëtar në fjalë nuk mund të:
  - a. caktojë një operator të pavarur sistemi në pajtim me nenin 14, apo që
  - b. të jetë në përputhje me dispozitat e Kapitullit IV.
9. Aty ku më 3 shtator 2009, sistemi i bartjes i përket një sipërmarrjeje të integruar vertikalisht, si dhe ka rregullime të vendosura të cilat garantojnë pavarësi më efektive të operatorit të sistemit të bartjes sesa me dispozitat e Kapitullit IV, Shteti Anëtar mund të vendosë të mos zbatojë paragrafin 1.
10. Para se një sipërmarrje të miratohet dhe të caktohet si operator i sistemit të bartjes sipas paragrafit 9 të këtij neni, ajo do të certifikohet sipas procedurave të përcaktuara me nenin 10 (4), (5) dhe (6) të kësaj Direktive, si dhe me nenin 3 të Rregullores (EC) Nr. 715/2009, në bazë të të cilave Komisioni do të verifikojë që rregullimet e vendosura qartësisht garantojnë pavarësi më efektive të operatorit të sistemit të bartjes sesa atë të siguruar me dispozitat e Kapitullit IV.
11. Sipërmarrjet e integruara vertikalisht të cilat kanë në pronë sistemin e bartjes nuk mund të ndalohen në asnjë rast nga ndërmarrja e veprimeve për të arritur përputhjen me paragrafin 1.
12. Sipërmarrjet që kryejnë cilindo nga funksionet e prodhimit apo furnizimit në asnjë rast nuk mund të marrin kontrollin apo të ushtrojnë ndonjë të drejtë, as drejtpërdrejt e as tërthorazi, mbi operatorët e shthurur të sistemeve të bartjes në Shtetet Anëtare që zbatojnë paragrafin 1.

#### *Neni 10*

##### **Caktimi dhe certifikimi i operatorëve të sistemit të bartjes**

1. Para se një sipërmarrje të miratohet dhe të caktohet si operator sistemi të bartjes, ajo duhet certifikuar sipas procedurave të përcaktuara me paragrafët 4, 5 dhe 6 të këtij neni, si dhe në pajtim me nenin 3 të Rregullores (EC) Nr. 715/2009.
2. Sipërmarrjet që kanë në pronë sistem të bartjes, si dhe të cilat janë certifikuar nga autoriteti rregullator vendor si sipërmarrje që përmbush kërkesat e nenit 9, në bazë të procedurave të certifikimit, do të miratohen dhe caktohen si operator i sistemit të bartjes nga Shtetet Anëtare. Caktimi i operatorëve të sistemit të bartjes do t'i njoftohet Komisionit dhe të shpallet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.
3. Operatorët e sistemit të bartjes do ta njoftojnë autoritetin rregullativ për secilin transaksion të planifikuar që mund të kërkojë një ri-vlerësim të përputhshmërisë së tyre me kërkesat e nenit 9.
4. Autoritetet rregullative do të vëzhgojnë përputhshmërinë e vazhdueshme të operatorëve të sistemit të bartjes me kërkesat e nenit 9. Ata duhet të krijojnë një procedurë certifikimi për të siguruar një përputhshmëri të tillë:
  - a. me njoftimin nga operatori i sistemit të bartjes sipas paragrafit 3;
  - b. me vetë-iniciativë, ku kanë njohuri që një ndryshim i planifikuar në të drejta apo ndikim mbi pronarët apo operatorët e sistemit të bartjes mund të çojë në një shkelje të nenit 9, apo kur kanë arsye të besojnë që një shkelje e tillë mund të ketë ndodhur; ose

- c. me një kërkesë të arsyetuar nga vetë Komisioni.
5. Autoritetet rregullative duhet të miratojnë një vendim për certifikimin e operatorit të sistemit të bartjes brenda një periudhe prej katër muajsh nga data e njoftimit të dhëna nga operatori i sistemit të bartjes ose nga data e kërkesës së Komisionit. Pas skadimit të asaj periudhe, certifikata do të konsiderohet të jetë dhënë. Vendimi i thënë apo i nënkuptuar i autoritetit rregullative hyn në fuqi vetëm pas përfundimit të procedurës së përcaktuar sipas paragrafit 6.
  6. Vendimi i thënë apo i nënkuptuar për certifikimin e një operatori të sistemit të bartjes do t'i dërgohet pa vonesë Komisionit nga autoriteti rregullative, bashkë me gjitha informatat përkatëse në lidhje me atë vendim. Komisioni vepron në pajtim me procedurën e parashikuar me nenin 3 të Rregullores (EC) Nr. 715/2009.
  7. Autoritetet rregullative dhe Komisioni mund t'i kërkojnë operatorëve të sistemit të bartjes dhe sipërmarrjeve që kryejnë cilindo nga funksionet e prodhimit apo furnizimit, të ofrojnë gjitha informatat përkatëse për përmbushjen e detyrave të tyre sipas këtij neni.
  8. Autoritetet rregullative dhe Komisioni mbrojnë fshehtësinë e informatave me ndjeshmëri komerciale.

#### *Neni 11*

##### **Certifikimi në lidhje me vendet e treta**

1. Aty ku certifikimi kërkohet nga një pronar apo operator i sistemit të bartjes, i cili kontrollohet nga një apo më shumë persona nga një vend apo disa vende të treta, autoriteti rregullator do të njoftojë Komisionin.  
Autoriteti Rregullator gjithashtu do të njoftojë Komisionin pa vonesë, mbi rrethanat që do të mund të çonin në gjendjen që personi apo personat nga vendi apo vendet e treta të fitonin kontrollin mbi një sistem të bartjes apo një operator të sistemit të bartjes.
2. Operatori i sistemit të bartjes do ta njoftojë autoritetin rregullator mbi gjitha rrethanat që do të mund të çonin në gjendjen që personi apo personat nga vendi apo vendet e treta të fitonin kontrollin mbi një sistem të bartjes apo një operator të sistemit të bartjes.
3. Autoriteti rregullative miraton një projekt-vendim mbi certifikimin e një operatori të sistemit të bartjes brenda katër muajsh nga data e njoftimit të dhënë nga operatori i sistemit të bartjes. Autoriteti refuzon certifikimin e tillë nëse nuk është vërtetuar:
  - a. që subjekti në fjalë ka përmbushur kërkesat e nenit 9; si dhe
  - b. para autoritetit rregullative apo para ndonjë autoriteti tjetër kompetent të caktuar nga Shteti Anëtar që dhënia e asaj certifikate nuk do të rrezikonte sigurinë e furnizimit me energji të atij Shteti Anëtar dhe Komunitetit. Në trajtimin e asaj çështjeje, autoriteti rregullator apo ndonjë autoritet tjetër kompetent i caktuar duhet të marrë parasysh:
    - i. (i) të drejtat dhe obligimet e Komunitetit, në lidhje me atë vend të tretë, të cilat rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare, duke përfshirë marrëveshjet e nënshkruara me një apo më shumë vende të treta tek të cilat Komuniteti është palë, si dhe të cilat trajtojnë çështjet e sigurisë së furnizimit me energji;



- ii. të drejtat dhe obligimet e Shtetit Anëtar në lidhje me atë vend të tretë, të cilat dalin nga marrëveshjet e nënshkruara me të, deri në atë masë që ato janë në përputhje me ligjet e Komunitetit; si dhe
  - iii. faktet dhe rrethanat tjera specifike të rastit dhe vendit të tretë në fjalë.
4. Autoriteti rregullator do t'i njoftojë vendimin Komisionit pa vonesë, bashkë me gjitha informatat përkatëse në lidhje me atë vendim.
  5. Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë që autoriteti rregullator apo një autoritet të caktuar kompetent, siç përmendet në paragrafin 3(b), para se autoriteti rregullator të miratojë vendimin mbi certifikimin, që të kërkohet mendimi i Komisionit mbi atë nëse:
    - a. subjekti në fjalë përmbush kërkesat e nenit 9; si dhe
    - b. dhënia e certifikatës nuk do të rrezikojë sigurinë e furnizimit të energjisë për Komunitetin.
  6. Komisioni do të shqyrtojë kërkesën e përmendur në paragrafin 5 sapo ta pranojë atë. Brenda një periudhe dy-mujore pas pranimit të kërkesës, ai do të lëshojë mendimin e tij për autoritetin vendor rregullator ose, nëse kërkesa është bërë nga autoriteti i caktuar kompetent, për atë autoritet.

Në përgatitjen e mendimit, Komisioni mund të kërkojë qëndrimet e Agjencisë, Shtetit Anëtar në fjalë, si dhe palëve të interesuara. Në rast se Komisioni bën një kërkesë të tillë, periudha dy-mujore do të zgjatet për dy muaj.

Në mungesë të një mendimi nga Komisioni brenda periudhës së përmendur në nënparagrafin e parë dhe të dy, Komisioni do të konsiderohet të mos ketë bërë kundërshtim ndaj vendimit të autoritetit rregullator.
  7. Kur vlerësohet nëse kontrolli nga një apo disa persona nga vendi apo vendet e treta mund të rrezikojë sigurinë e furnizimit të energjisë për Komunitetin, Komisioni duhet të marrë parasysh:
    - a. faktet specifike të rastit dhe vendit apo vendeve të treta në fjalë; si dhe
    - b. të drejtat dhe obligimet e Komunitetit në lidhje me atë apo ato vende të treta që dalin sipas të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë marrëveshjet e nënshkruara me një apo më shumë vende të treta në të cilat Komuniteti është palë nënshkruese, si dhe që merret me çështjet e sigurisë së furnizimit.
  8. Autoriteti rregullator i shtetit, brenda një periudhe dy-mujore pas kalimit të periudhës së përmendur në paragrafin 6, miraton vendimin e tij përfundimtar për certifikimin. Në miratimin e vendimit të tij përfundimtar, autoriteti rregullator vendor duhet të marrë parasysh seriozisht mendimin e Komisionit. Në cilindo rast, Shtetet Anëtare kanë të drejtë të refuzojnë certifikimin aty ku miratimi i certifikimit rrezikon sigurinë e furnizimit me energji të Shtetit Anëtar, apo sigurinë e furnizimit me energji të ndonjë Shteti tjetër Anëtar. Në rastet kur Shteti Anëtar ka caktuar një autoritet tjetër kompetent për vlerësimin e paragrafit 3(b), mund t'i kërkojë autoritetit rregullative vendor të miratojë vendimin e tij përfundimtar në pajtim me vlerësimin e atij autoriteti kompetent. Vendimi përfundimtar i autoritetit rregullative dhe mendimi i Komisionit do të publikohen së bashku. Aty ku vendimi përfundimtar dallon nga mendimi i Komisionit, Shteti Anëtar në fjalë do të ofrojë dhe të publikojë, bashkë me atë vendim, edhe arsyetimin prapa atij vendimi.
  9. Asnjë pjesë e këtij neni nuk mund të ndikojë në të drejtën e Shtetit Anëtar që të

ushtrojë, në pajtim me ligjin e Komunitetit, kontrollet ligjore shtetërore për të mbrojturi interesat legjitimë të sigurisë publike.

10. Komisioni mund të miratojë Udhëzime për dhënien e hollësive të procedurës që duhet ndjekur për zbatimin e këtij neni. Ato masa, të dizajnuara për të ndryshuar elementet jo-thelbësore të kësaj Direktive duke e plotësuar, do të miratohen në pajtim me procedurën rregullative bashkë me vëzhgimin e afërt të përmendur në nenin 51(3).
11. Ky nen, me përjashtim të paragrafit 3(a), do të vlejë gjithashtu për Shtetet Anëtare që i nënshtrohen shmangies sipas nenit 49.

#### *Neni 12*

##### **Caktimi i operatorëve të depozitimit dhe sistemeve të GLN-së**

Shtetet Anëtare do të caktojnë, ose do t'i kërkojnë sipërmarrjeve të gazit natyror të cilat kanë në pronë stabilimente të depozitimit apo GLN-së që të caktojnë, për një periudhë që do të vendoset nga Shtetet Anëtare, duke marrë parasysh aspektet e efikasitetit dhe baraspeshimit ekonomik, një apo më shumë operatorë të depozitimit dhe sistemit të GLN-së.

#### *Neni 13*

##### **Detyrat e operatorëve të sistemit të bartjes, depozitimit dhe/ose GLN-së**

1. Secili operator i sistemit të bartjes, depozitimit apo/dhe GLN-së:
  - a. operon, mirëmban dhe zhvillon, me kushte ekonomike, stabilimente të sigurt, të besueshme dhe efikase të bartjes, depozitimit dhe/ose GLN-së për të siguruar treg të hapur, me konsideratën e duhur për mjedisin, si dhe siguron mënyrat adekuate për të përmbushur obligimet e shërbimit;
  - b. përmbahet nga diskriminimi mes shfrytëzuesve të sistemit apo klasave të shfrytëzuesve të sistemit, sidomos kur ai diskriminim është në të mirën e sipërmarrjeve të ndërlidhura me të;
  - c. i ofron secilit operator tjetër të sistemit të bartjes, operator të sistemit të depozitimit, operator të sistemit të GLN-së dhe/ose operator të sistemit të shpërndarjes, informata të mjaftueshme për të siguruar që transporti dhe depozitimi i gazit natyror të bëhet në përputhje me operimin e sigurt dhe efikas të një sistemi të ndërlidhur (interkonektuar); si dhe
  - d. i ofron shfrytëzuesve të sistemit informatat për të cilat kanë nevojë për qasje efikase në sistem.
2. Secili operator i sistemit të bartjes duhet të zhvillojë kapacitete të mjaftueshme ndërkufitare për të integruar infrastrukturën evropiane të bartjes, duke përmbushur gjitha kërkesat ekonomikisht të arsyeshme dhe teknikisht të arritshme, si dhe duke marrë parasysh sigurinë e furnizimit me gaz.
3. Rregullat e miratuara nga operatorët e sistemit të bartjes për baraspeshimin e sistemit të bartjes së gazit duhet të jenë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese, duke përfshirë rregullat për tarifimin e shfrytëzuesve të rrjeteve të tyre për mosbalancim. Kushtet dhe afatet, duke përfshirë edhe rregullat dhe tarifat, për ofrimin e atyre shërbimeve nga operatorët e sistemit të bartjes do të përcaktohen në bazë të një metodologjie në përputhje me nenin 41(6) në një mënyrë jo-diskriminuese dhe

reflektuese ndaj kostos, si dhe do të publikohen.

4. Autoritetet rregullative, në rastet ku Shtetet Anëtare kanë përcaktuar ashtu, apo Shtetet Anëtare, mund t'i kërkojnë operatorëve të sistemit të bartjes që të sigurojnë përputhjen me standardet minimale për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të bartjes, duke përfshirë edhe kapacitetet interkonektuese.
5. Operatorët e sistemit të bartjes do të prokurojnë energjinë që e shfrytëzojnë për kryerjen e funksioneve të tyre në bazë të procedurave transparente, jo-diskriminuese dhe të bazuara në treg.

#### *Neni 14*

#### **Operatorët e pavarur të sistemeve**

1. Në rastet kur sistemi i bartjes i përket një sipërmarrjeje të integruar vertikalisht më 3 shtator 2009, Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos zbatojnë nenin 9 (1) dhe të caktojnë një operator të pavarur të sistemit, me propozim nga pronari i sistemit të bartjes. Një caktim i tillë i duhet nënshtruar miratimit nga Komisioni.
2. Shteti Anëtar mund të miratojë dhe të caktojë operatorin e pavarur të sistemit vetëm nëse:
  - a. (a) operatori kandidat demonstroi që është në përputhje me kërkesat e nenit 9(1)(b), (c) dhe (d);
  - b. operatori kandidat demonstroi që ka në dispozicion gjitha resurset e nevojshme financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të kryer detyrat e veta sipas nenit 13;
  - c. operatori kandidat merr përsipër të zbatojë një plan dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit, të monitoruar nga autoriteti rregullator;
  - d. pronari i sistemit demonstroi aftësinë e tij që të përmbushë obligimet e veta sipas paragrafit 5. Në këtë drejtim, ai duhet të ofrojë gjitha projekt-kontratat me sipërmarrjen kandidatë dhe secilin subjekt tjetër relevant; si dhe
  - e. operatori kandidat demonstroi aftësinë e tij që të përmbushë obligimet e veta sipas Rregullores (EC) Nr. 715/2009, duke përfshirë bashkëpunimin e operatorëve të sistemit të bartjes në nivel evropian dhe rajonal.
3. Sipërmarrjet që janë certifikuar nga autoriteti rregullator si përmbushëse të kërkesave të nenit 11 dhe të paragrafit 2 të këtij neni do të miratohen dhe të caktohen si operatorë të pavarur të sistemit nga Shtetet Anëtare. Procedura e certifikimit do të zbatohet ose sipas nenit 10 të kësaj Direktive dhe nenit 3 të Rregullores (EC) Nr. 715/2009, ose sipas nenit 11 të kësaj Direktive.
4. Secili operator i pavarur i sistemit do të jetë përgjegjës për dhënien dhe menaxhimin e qasjes së palës së tretë, duke përfshirë grumbullimin e tarifave të qasjes dhe ato të ngjeshjes (kongjestion), për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të bartjes, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për mbulimin e kërkesës së arsyeshme përmes planifikimit të investimeve. Derisa zhvillon sistemin e bartjes, operatori i pavarur i sistemit është përgjegjës për planifikimin (përfshirë procedurën e autorizimit), ndërtimin dhe komisionimin e infrastrukturës së re. Për këtë qëllim, operatori i pavarur i sistemit vepron si operator i sistemit të bartjes në pajtim me këtë Kapitull. Pronari i sistemit të bartjes nuk do të jetë përgjegjës për dhënien dhe menaxhimin e qasjes së palës së tretë, e as për planifikimin e investimeve.

5. Në rastet kur është caktuar operatori i pavarur i sistemit, pronari i sistemit të bartjes duhet të:
  - a. ofrojë gjithë bashkëpunimin përkatës dhe mbështetjen për operatorin e pavarur të sistemit për përmbushjen e detyrave të veta, duke përfshirë në veçanti gjitha informatat përkatëse;
  - b. financojë investimet e vendosura nga operatori i pavarur i sistemit dhe të miratuara nga autoriteti rregullative, ose të japë pajtimin e tij për financim nga cilado palë e interesuar, duke përfshirë edhe operatorin e pavarur të sistemit. Rregullimi përkatës i financimit i nënshtrohet miratimit nga autoriteti rregullative. Para këtij miratimi, autoriteti rregullative duhet të konsultojë pronarin e sistemit të bartjes bashkë me palët tjera të interesuara;
  - c. sigurojë mbulimin e detyrimeve në lidhje me asetet e rrjetit, duke përfshirë përgjegjësinë në lidhje me detyrat e operatorit të pavarur të sistemit; si dhe
  - d. ofrojë garanci për mundësimin e financimit të zgjerimeve të reja të rrjetit, me përjashtim të atyre investimeve ku, sipas pikës (b), ka dhënë pajtimin e vet për financim nga ndonjë palë e interesuar, duke përfshirë edhe operatorin e pavarur të sistemit.
6. Në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin rregullative, autoriteti përkatës shtetëror i konkurrencës do të marrë gjitha kompetencat përkatëse për të monitoruar në mënyrë efektive respektimin e obligimeve të paragrafit 5 nga pronari i sistemit të bartjes.

#### *Neni 15*

#### **Shturja e pronarëve të sistemit të bartjes dhe operatorëve të sistemit të depozitimit**

1. Pronari i sistemit të bartjes, aty ku është emëruar operatori i pavarur i sistemit, si dhe operatori i sistemit të depozitimit, të cilët janë pjesë e sipërmarrjeve të integruara vertikalisht, do të jenë të pavarur së paku në aspektin e formës së tyre juridike, organizimit dhe vendim-marrjes nga aktivitetet tjera që nuk kanë të bëjnë me bartjen, shpërndarjen dhe depozitimin.

Ky nen vlen vetëm për stabilimentet e depozitimit që janë teknikisht dhe/ose ekonomikisht të domosdoshme për ofrimin e qasjes efikase për sistemin për furnizim të konsumatorëve sipas nenit 33.
2. Për të siguruar pavarësinë e pronarit të sistemit të bartjes dhe operatorit të sistemit të depozitimit të përmendur në paragrafin 1, duhen respektuar këto kriteret minimale:
  - a. personat përgjegjës për menaxhimin e pronarit të sistemit të bartjes dhe operatorit të sistemit të depozitimit nuk do të marrin pjesë në strukturat udhëheqëse të sipërmarrjes së integruar të gazit që është përgjegjëse, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për operimin e përditshëm të prodhimit dhe furnizimit të gazit natyror;
  - b. masat e përshtatshme duhen marrë për të siguruar që interesat profesionalë të personave përgjegjës për menaxhimin e pronarit të sistemit të bartjes dhe operatorit të sistemit të depozitimit të merren parasysh në atë mënyrë që të sigurohet që ata të jenë në gjendje të veprojnë në mënyrë të pavarur;
  - c. operatori i sistemit të depozitimit duhet të ketë të drejta efektive të vendim-marrjes, të pavarura nga sipërmarrja e integruar e gazit natyror, në kuptimin e aseteve të nevojshme për të operuar, mirëmbajtur apo zhvilluar stabilimentet e

depozitimit. Kjo nuk parandalon ekzistencën e mekanizmave të përshtatshëm të koordinimit për të siguruar që të drejtat e mbikëqyrjes ekonomike dhe menaxheriale të kompanisë amë, në kuptimin e kthimit mbi asetet, të rregulluar tërthorazi në pajtim me nenin 41(6) në një kompani vartëse, të mbrohen. Në veçanti, kjo i mundëson kompanisë amë që të miratojë planin vjetor financiar, apo ndonjë instrument ekuivalent me të, të operatorit të sistemit të depozitimit, si dhe për të vendosur kufijtë globalë mbi nivelet e borxhit të kompanisë vartëse. Kjo nuk i lejon kompanisë amë që të japë udhëzime në lidhje me operacionet e përditshme, e as në lidhje me vendimet individuale në lidhje me ndërtimin apo avancimin e stabilimenteve të depozitimit, të cilat nuk tejkalojnë kufijtë e planit të miratuar financiar, apo të instrumentit ekuivalent me të; si dhe

- d. pronari i sistemit të bartjes dhe operatori i sistemit të depozitimit do të hartojnë një program të përputhshmërisë, i cili përcakton masat që merren për të siguruar përjashtimin e sjelljeve diskriminuese, si dhe për të siguruar që respektimi i tij të monitorohet në mënyrën e duhur. Programi i përputhshmërisë përcakton obligimet specifike të punëtorëve për arritjen e atyre synimeve. Raporti vjetor, që përcakton masat e ndërmarra, do të dorëzohet nga personi apo organi përgjegjës për monitorimin e programit të përputhshmërisë tek autoriteti rregullativ, si dhe do të publikohet si i tillë.
3. Komisioni mund të miratojë Udhëzime për të siguruar respektimin e plotë dhe efektiv të paragrafit 2 të këtij neni nga pronari i sistemit të bartjes dhe operatori i sistemit të depozitimit. Ato masa, të dizajnuara për të ndryshuar elementet jo-thelbësore të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, do të miratohen në pajtim me procedurën rregullative, bashkë me vëzhgimin e afërt të përmendur në nenin 51(3).

#### *Neni 16*

#### **Konfidencialiteti për operatorë të sistemit të bartjes dhe pronarë të sistemit të bartjes**

1. Pa paragjykuar nenin 30 apo ndonjë detyrë tjetër ligjore për të zbuluar informatat, secili operator i sistemit të bartjes, depozitimit dhe/ose GLN-së, si dhe secili pronar i sistemit të bartjes, duhet të ruajë fshehtësinë e informatave me ndjeshmëri komerciale të siguruara gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre, si dhe duhet të pengojnë zbulimin në mënyrë diskriminuese të informatave për aktivitetet e veta të cilat mund të sigurojnë përparësi komerciale. Veçanërisht, ata nuk mund të zbulojnë informata të ndjeshme komerciale tek pjesët tjera të sipërmarrjes, përveç nëse kjo është e domosdoshme për të kryer një transaksion biznesi. Për të siguruar respektim të plotë të rregullave mbi shturjen e informatave, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që pronari i sistemit të bartjes, në rast të operatorit të kombinuar, operatori i sistemit të shpërndarjes, si dhe pjesa tjetër e sipërmarrjes të mos kenë shërbime të përbashkëta, si shërbime të përbashkëta juridike, përveç funksioneve thjesht administrative apo të teknologjisë informative.
2. Operatorët e sistemit të bartjes, depozitimit dhe/ose GLN-së nuk mundën, në kontekstin e shitjes apo blerjes së gazit natyror nga sipërmarrjet e ndërlidhura, të keqpërdorin informatat me ndjeshmëri komerciale të siguruara nga palët e treta në kontekstin e ofrimit apo negocimit të qasjes në sistem.
3. Informatat e domosdoshme për konkurrencë efektive dhe funksionim efikas të tregut duhen bërë publike. Ky obligim vlen pa paragjykuar mbrojtjen e informatave me

ndjeshmëri komerciale.

## KAPITULLI IV

### OPERATORI I PAVARUR I BARTJES

*Neni 17*

#### **Asetet, pajisjet, personeli dhe identiteti**

1. Operatorët e sistemit të bartjes duhen pajisur me gjitha resurset njerëzore, teknike, fizike dhe financiare të domosdoshme për përmbushjen e obligimeve të tyre sipas kësaj Direktive dhe kryerjen e aktivitetit të bartjes së gazit, e sidomos:
  - a. asetet që janë të domosdoshme për aktivitetin e bartjes së gazit, duke përfshirë sistemin e bartjes, duhet të jenë pronë e operatorit të sistemit të bartjes;
  - b. personeli i domosdoshëm për aktivitetin e bartjes së gazit, duke përfshirë kryerjen e gjitha detyrave të korporatës, duhen punësuar nga operatori i sistemit të bartjes;
  - c. delegimi i personelit dhe ofrimi i shërbimeve, nga dhe për pjesët tjera të sipërmarrjes së integruar vertikalisht, është i ndaluar. Megjithatë, operatori i sistemit të bartjes mund të ofrojë shërbime për sipërmarrjen e integruar vertikalisht nëse:
    - i. ofrimi i atyre shërbimeve nuk diskriminon mes shfrytëzuesve të sistemit, është i disponueshëm për gjithë shfrytëzuesit e sistemit me kushte dhe afate të njëjta, si dhe nuk kufizon, nuk çrregullon e as nuk parandalon konkurrencën në prodhim apo furnizim; si dhe
    - ii. kushtet dhe afatet e ofrimit të këtyre shërbimeve janë të miratuara nga autoriteti rregullator;
  - d. pa paragjykuar vendimet e Bordit Mbikëqyrës sipas nenit 20, resurset e duhura financiare për projektet e ardhshme investuese dhe/ose për ndërrimin e aseteve ekzistuese i duhen vënë në dispozicion operatorit të sistemit të bartjes në kohën e duhur nga sipërmarrja e integruar vertikalisht, në bazë të një kërkesë të duhur nga operatori i sistemit të bartjes.
2. Aktiviteti i bartjes së gazit duhet të përfshijë së paku këto detyra në vijim, përveç atyre që janë renditur me nenin 13:
  - a. përfaqësimi i operatorit të sistemit të bartjes dhe kontaktet me palët e treta dhe autoritetet rregullative;
  - b. përfaqësimi i operatorit të sistemit të bartjes në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Bartjes për gaz (ENTSO për gaz);
  - c. dhënia dhe menaxhimi i qasjes së palës së tretë në baza jo-diskriminuese mes shfrytëzuesve të sistemit apo klasave të atyre shfrytëzuesve të sistemit;
  - d. inkasimi i gjitha tarifave të ndërlidhura me sistemin e bartjes, duke përfshirë tarifat e qasjes, tarifat e baraspeshimit për shërbime ndihmëse, si trajtimi i gazit, blerja e shërbimeve (kostot e balancimit, energjia për humbje);
  - e. operimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i një sistemi të sigurt, efikas dhe ekonomik të bartjes;
  - f. planifikimi investiv, që siguron aftësinë afatgjate të sistemit për mbulimin e

- kërkesës së arsyeshme dhe garantimin e sigurisë së furnizimit;
- g. themelimi i kompanive të duhura të përbashkëta, duke përfshirë një apo më shumë operatorë të sistemit të bartjes, këmbimin e gazit, si dhe aktorët e tjerë relevantë, në ndjekje të synimit për krijimin e tregjeve rajonale apo lehtësimin e procesit të liberalizimit; si dhe
  - h. gjitha shërbimet e korporatës, duke përfshirë shërbimet juridike, kontabilitetit dhe shërbimet e TI-së.
3. Operatorët e sistemit të bartjes do të organizohen në formën e tyre juridike sipas referimit në nenin 1 të Direktivës së Këshillit 68/151/EEC <sup>(17)</sup>
  4. Operatori i sistemit të bartjes, në identitetin e tij korporativ, komunikim, reklamim dhe lokale, nuk duhet të krijojë konfuzion në lidhje me identitetin e ndarë të sipërmarrjes së integruar vertikalisht apo ndonjë pjesë saj.
  5. Operatori i sistemit të bartjes nuk mund të ndajë sistemet apo pajisjet e TI-së, lokalet fizike dhe sistemet e qasjes në siguri me asnjë pjesë të sipërmarrjes së integruar vertikalisht, e as të shfrytëzojë të njëjtit konsulentë apo kontraktorë të jashtëm për sisteme apo pajisje të TI-së, si dhe sistemet e qasjes së sigurt.
  6. Llogaritë e operatorëve të sistemit të bartjes do të auditohen nga një auditor tjetër nga ai që auditon sipërmarrjen e integruar vertikalisht, apo ndonjë pjesë të saj.

## *Neni 18*

### **Pavarësia e operatorit të sistemit të bartjes**

1. Pa paragjykuar vendimet e Bordit Mbikëqyrës sipas nenit 20, operatori i sistemit të bartjes duhet të ketë:
  - a. të drejta efektive të vendim-marrjes, të pavarura nga sipërmarrja e integruar vertikalisht, në lidhje me asetet e domosdoshme për të operuar, mirëmbajtur apo zhvilluar sistemin e bartjes; si dhe
  - b. kompetencën për të siguruar para në tregun kapital, sidomos përmes huamarrjes dhe rritjes së kapitalit.
2. Operatori i sistemit të bartjes, në çdo kohë, duhet të veprojë në atë mënyrë që të sigurojë që të ketë resurset e nevojshme për të kryer aktivitetin e bartjes në mënyrën e duhur dhe efikase, si dhe që të zhvillojë dhe mirëmbajë një sistem efikas, të sigurt dhe ekonomik të bartjes.
3. Kompanitë vartëse të sipërmarrjes së integruar vertikalisht që kryejnë funksionet e prodhimit apo furnizimit nuk mund të kenë aksione, drejtpërdrejt apo tërthorazi, tek operatori i sistemit të bartjes. Operatori i sistemit të bartjes nuk mund të ketë as aksione direkte e as indirekte në asnjë degë apo kompani vartëse të sipërmarrjes së integruar vertikalisht që kryejnë funksionet e prodhimit apo furnizimit, e as të marrin dividenda e as ndonjë përfitim tjetër financiar nga ajo kompani vartëse.

---

<sup>17</sup> Direktiva e Parë e Këshillit 68/151/EEC, 9 mars 1968, mbi bashkërendimin e masave mbrojtëse të cilat për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve kërkohen nga Shtetet Anëtare për kompanitë brenda kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, me qëllim që ato masa mbrojtëse të bëhen ekuivalente në gjithë komunitetin (OJ L 65, 14.3.1968, p. 8).

4. Struktura e përgjithshme menaxhuese dhe statutet e korporatës së operatorit të sistemit të bartjes duhet të sigurojnë pavarësinë efektive të operatorit të sistemit të bartjes në përputhje me këtë Kapitull. Sipërmarrja e integruar vertikalisht nuk mund të përcaktojë, as drejtpërdrejt e as tërthorazi, sjelljen konkurrentë të operatorit të sistemit të bartjes në lidhje me aktivitetet e përditshme të operatorit të sistemit të bartjes dhe menaxhimit të rrjetit, apo në lidhje me aktivitetet e domosdoshme për përgatitjen e planit dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit, të hartuar në bazë të nenit 22.
5. Në përmbushjen e detyrave të tyre në nenin 13 dhe nenin 17(2) të kësaj Direktive, si dhe në arritje të respektimit të neneve 13(1), 14(1)(a), 16(2), (3) dhe (5), 18(6), si dhe 21(1) të Rregullores (EC) Nr. 715/2009, operatorët e sistemit të bartjes nuk mund të diskriminojnë mes personave apo subjekteve të ndryshme, si dhe nuk do të kufizojnë, çrregullojnë apo parandalojnë konkurrencën në prodhim apo furnizim.
6. Gjitha marrëdhëniet komerciale dhe financiare mes sipërmarrjes së integruar vertikalisht dhe operatorit të sistemit të bartjes, duke përfshirë huatë nga operatori i sistemit të bartjes për sipërmarrjen e integruar vertikalisht, do t'i nënshtrohen kushteve të tregut. Operatori i sistemit të bartjes do të mbajë dosje të hollësishme të atyre marrëdhënieve komerciale dhe financiare dhe t'i vërë ato në dispozicion të autoritetit rregullative sipas kërkesës.
7. Operatori i sistemit të bartjes do të dorëzojë për miratim nga autoriteti rregullative gjitha marrëveshjet komerciale dhe financiare me sipërmarrjen e integruar vertikalisht.
8. Operatori i sistemit të bartjes duhet të informojë autoritetin rregullative për resurset financiare, të përmendura në nenin 17(1)(d), në dispozicion për projektet e ardhshme investive dhe/ose për ndërrimin e aseteve ekzistuese.
9. Sipërmarrja e integruar vertikalisht do të përmbahet nga veprimet që pengojnë apo paragjykojnë operatorin e sistemit të bartjes nga përmbushja e obligimeve të tij në këtë Kapitull, si dhe nuk mund të kërkojnë nga operatori i sistemit të bartjes të kërkojë leje nga sipërmarrja e integruar vertikalisht në përmbushje të atyre obligimeve.
10. Sipërmarrja që është certifikuar nga autoriteti rregullator si përmbushëse e kërkesave të këtij Kapitulli do të miratohet dhe caktohet si operator i sistemit të bartjes nga Shteti Anëtar në fjalë. Procedura e certifikimit që zbatohet është ajo në nenin 10 të kësaj Direktive dhe nenin 3 të Rregullores (EC) nr. 715/2009, ose në nenin 11 të kësaj Direktive.

#### *Neni 19*

#### **Pavarësia e personelit dhe menaxhmentit të operatorit të sistemit të bartjes**

1. Vendimet në lidhje me emërimin dhe zgjatjen e kontratave, kushteve të punës duke përfshirë kompensimin, si dhe ndërprerjen e mandatit, të personave që janë përgjegjës për menaxhimin dhe/ose anëtarët e organeve administrative të operatorit të sistemit të bartjes, do të merren nga Organi Mbikëqyrës i operatorit të sistemit të bartjes, i emëruar në pajtim me nenin 20.
2. Identiteti, kushtet që përcaktojnë mandatin, kohëzgjatjen dhe ndërprerjen e mandatit të personave të emëruar nga Organi Mbikëqyrës për emërim apo zgjatje të kontratës së personave përgjegjës për menaxhimin ekzekutiv dhe/ose si anëtarë të organeve administrative të operatorit të sistemit të bartjes, si dhe arsyet për cilindo vendim të propozuar për ndërprerjen e një mandati të tillë, duhen njoftuar tek autoriteti



rregullative. Ato kushte dhe vendime që përmenden në paragrafin 1 hyjnë në fuqi vetëm nëse autoriteti rregullative nuk ka parashtruar ndonjë kundërshtim brenda tri javësh nga njoftimi.

Autoriteti rregullative mund të kundërshtojë vendimet e përmendura në paragrafin 1, në rastet kur:

- a. dalin dyshime në kuptimin e pavarësisë profesionale të personit të emëruar si përgjegjës për menaxhimin dhe/ose si anëtar i organeve administrative; si dhe
  - b. në rastin e ndërprerjes së parakohshme të mandatit, ka dyshime në lidhje me arsyetimin e asaj ndërprerjeje të parakohshme.
3. Asnjë pozitë apo përgjegjësi profesionale, interes apo marrëdhënie afariste, drejtpërdrejt apo tërthorazi, me sipërmarrjen e integruar vertikalisht, apo ndonjë pjesë të saj, ose aksionarët dominues përveç operatorit të sistemit të bartjes, nuk mund të ushtrohet për një periudhë tre-vjeçare para emërimit të personave përgjegjës për menaxhimin dhe/ose anëtarëve të organeve administrative të operatorit të sistemit të bartjes, të cilët i nënshtrohen këtij paragrafi.
  4. Personat përgjegjës për menaxhimin dhe/ose anëtarët e organeve administrative, si dhe punëtorët e operatorit të sistemit të bartjes nuk mund të mbajnë pozita tjera profesionale apo përgjegjësi, marrëdhënie interesi apo biznesi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, me cilëndo pjesë tjetër të sipërmarrjes së integruar vertikalisht me aksionarët e saj kontrollues.
  5. Personat përgjegjës për menaxhimin dhe/ose anëtarët e organeve administrative, si dhe punëtorët e operatorit të sistemit të bartjes nuk mund të mbajnë interesa mbi apo të pranojnë përfitime financiare, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga asnjë pjesë e sipërmarrjes së integruar vertikalisht, përveç nga operatori i sistemit të bartjes. Kompensimi i tyre nuk mund të varet nga aktivitetet apo rezultatet e sipërmarrjes së integruar vertikalisht, përveç atyre të operatorit të sistemit të bartjes.
  6. Të drejtat efektive të apelit tek autoriteti rregullator duhen garantuar për çdo ankesë nga personat përgjegjës për menaxhimin dhe/ose anëtarët e organeve administrative të operatorit të sistemit të bartjes, kundër ndërprerjeve të parakohshme të mandateve të tyre.
  7. Pas ndërprerjes së mandatit të tyre tek operatori i sistemit të bartjes, personat përgjegjës për menaxhimin dhe/ose anëtarët e organeve administrative nuk mund të kenë pozitë apo përgjegjësi profesionale, interes apo marrëdhënie biznesi me asnjë pjesë të sipërmarrjes së integruar vertikalisht, përveç operatorit të sistemit të bartjes, apo me aksionarët kontrollues të tyre, për një periudhë jo më pak se katër vjet.
  8. Paragrafi 3 vlen për shumicën e personave përgjegjës për menaxhimin dhe/ose anëtarët e organeve administrative të operatorit të sistemit të bartjes.  
Personat përgjegjës për menaxhimin dhe/ose anëtarët e organeve administrative të operatorit të sistemit të bartjes që nuk i nënshtrohen paragrafit 3 duhet të mos kenë ushtruar aktivitete menaxhimi apo të tjera aktivitete relevante në sipërmarrjen e integruar vertikalisht për një periudhë prej së paku gjashtë muaj para emërimit të tyre.  
Nën-paragrafi i parë i këtij paragrafi dhe paragrafët 4 deri në 7 do të vlejnjë për gjithë personat që i përkasin menaxhmentit ekzekutiv dhe për ata që raportojnë drejtpërdrejt tek ata mbi çështjet në lidhje me operimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit.

## Neni 20

### Organi mbikëqyrës

1. Operatori i sistemit të bartjes duhet të ketë një Organ Mbikëqyrës, i cili duhet të ketë pushtetin e marrjes së vendimeve të cilat mund të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi vlerën e aseteve të aksionarëve brenda operatorit të sistemit të bartjes, sidomos vendimet në lidhje me miratimin e planeve vjetore dhe shumë-vjeçare financiare, nivelin e borxheve të operatorit të sistemit të bartjes dhe shumën e dividendëve që i shpërndahen aksionarëve. Vendimet që bien në fushëveprimin e Organit Mbikëqyrës nuk përfshijnë aktivitetet e përditshme të operatorit të sistemit të bartjes dhe menaxhimit të rrjetit, si dhe ato në lidhje me aktivitetet e domosdoshme për përgatitjen e planit dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit, i cili hartohet në bazë të nenit 22.
2. Organi Mbikëqyrës përbëhet nga anëtarët që përfaqësojnë sipërmarrjen e integruar vertikalisht, anëtarët që përfaqësojnë aksionarët e palëve të treta, si dhe në rastet kur legjislacioni përkatës i një Shteti Anëtar kërkon ashtu, anëtarët që përfaqësojnë palët tjera të interesuara, siç janë punëtorët e operatorit të sistemit të bartjes.
3. Nën-paragrafi i nenit 19(2) dhe neni 19(3) deri në (7) vlejné për së paku gjysmën e anëtarëve të Organit Mbikëqyrës, minus njërin.  
Pika (b) e nën-paragrafit të dytë të nenit 19(2) vlejné për gjithë anëtarët e Organit Mbikëqyrës.

## Neni 21

### Programi i përputhshmërisë dhe zyrtari i përputhshmërisë

1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që operatorët e sistemit të bartjes të përcaktojnë dhe zbatojné një program të përputhshmërisë, i cili përkufizon masat që merren për të siguruar përjashtimin e sjelljes diskriminuese, si dhe siguron që zbatimi i atij programi të monitorohet në mënyrën adekuate. Programi i përputhshmërisë duhet të përcaktojë obligimet specifike të punëtorëve për përmbushjen e atyre synimeve. Ai duhet t'i nënshtrohet miratimit nga autoriteti rregullator. Pa paragjykuar kompetencat e rregullatorit vendor, respektimi i programit do të monitorohet në mënyrë të pavarur nga një zyrtar i përputhshmërisë.
2. Zyrtari i përputhshmërisë emërohet nga Organi Mbikëqyrës, si dhe i nënshtrohet miratimit nga autoriteti rregullator. Autoriteti rregullator mund të refuzojë miratimin e zyrtarit të përputhshmërisë vetëm për arsyet e mungesës së pavarësisë apo kapacitetit profesional. Zyrtari i përputhshmërisë mund të jetë person fizik apo juridik. Për zyrtarin e përputhshmërisë, zbatohet neni 19 (2) deri në (8).
3. Zyrtari i përputhshmërisë është përgjegjës për:
  - a. monitorimin e zbatimit të programit të përputhshmërisë;
  - b. elaborimin e raportit vjetor, që përcakton masat që merren për zbatimin e programit të përputhshmërisë dhe dorëzimin e tij tek autoriteti rregullator;
  - c. raportimin para Organit Mbikëqyrës dhe lëshimin e rekomandimeve për programin e përputhshmërisë dhe zbatimin e tij;
  - d. njoftimin e autoritetit rregullator për shkeljet substanciale në lidhje me zbatimin e programit të përputhshmërisë; si dhe

- e. raportimin para autoritetit rregullator mbi marrëdhëniet komerciale dhe financiare mes sipërmarrjes së integruar vertikalisht dhe operatorit të sistemit të bartjes.
4. Zyrtari i përputhshmërisë dorëzon propozim-vendimet për planet investive apo për investimet individuale në rrjet tek autoriteti rregullator. Kjo duhet të ndodhë më së voni kur organi menaxhues dhe/ose kompetent administrativ i operatorit të sistemit të bartjes i dorëzon ato tek Organi Mbikëqyrës.
  5. Aty ku sipërmarrja e integruar vertikalisht, në Kuvendin e përgjithshëm, apo me votat e anëtarëve të Organit Mbikëqyrës ka emëruar vetë, ka penguar miratimin e vendimit me efekt parandalim apo vonesën e investimeve, të cilat brenda planit dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit, është dashur të ekzekutohet në tri vitet vijuese, zyrtari i përputhshmërisë duhet ta raportojë këtë tek autoriteti rregullator, i cili pastaj duhet të veprojë në pajtim me nenin 22.
  6. Kushtet që vlejné për mandatin apo për kushtet e punësimit të zyrtarit të përputhshmërisë, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e mandatit të tij/saj, i duhen nënshtruar miratimit nga autoriteti rregullator. Këto kushte duhet të sigurojnë pavarësinë e zyrtarit të përputhshmërisë, duke përfshirë edhe sigurimin e gjitha resurseve të domosdoshme për përmbushjen e detyrave të tij/saj. Gjatë mandatit, zyrtari i përputhshmërisë nuk mund të mbajë pozitë, përgjegjësi apo interes tjetër profesional, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në apo me asnjë pjesë tjetër të sipërmarrjes së integruar vertikalisht apo me aksionarët e saj dominues.
  7. Zyrtari i përputhshmërisë duhet të raportojë rregullisht, ose verbalisht ose me shkrim, tek autoriteti rregullator dhe duhet të ketë të drejtën e raportimit të rregullt, ose verbalisht ose me shkrim, tek Organi Mbikëqyrës i operatorit të sistemit të bartjes.
  8. Zyrtari i përputhshmërisë mund të ndjekë gjitha takimet e organeve menaxhuese apo administrative të operatorit të sistemit të bartjes, si dhe ato të Organit Mbikëqyrës dhe Kuvendit të Përgjithshëm. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ndjekë gjitha takimet që trajtojnë çështjet në vijim:
    - a. kushtet për qasje në rrjet, sipas përkufizimit të Rregullores (EC) Nr. 715/2009, sidomos në lidhje me tarifat, shërbimet e qasjes së palës së tretë, alokimit të kapacitetit dhe menaxhimin e ngjeshjeve, transparencën, balancimin dhe tregjet sekondare;
    - b. projektet që ndërmerren për të operuar, mirëmbajtur dhe zhvilluar sistemin e bartjes, duke përfshirë investimet në linjat e reja transportuese, në zgjerim të kapaciteteve dhe në optimizimin e kapaciteteve ekzistuese;
    - c. blerjet apo shitjet e energjisë, të domosdoshme për operimin e sistemit të bartjes.
  9. Zyrtari i përputhshmërisë monitoron përputhshmërinë e operatorit të sistemit të bartjes me nenin 16.
  10. Zyrtari i përputhshmërisë duhet të ketë qasje në të gjitha të dhënat relevante dhe zyrat e operatorit të sistemit të bartjes, si dhe ndaj gjitha informatave të domosdoshme për përmbushjen e detyrës së tij.
  11. Pas miratimit paraprak nga autoriteti rregullator, Organi Mbikëqyrës mund të shkarkojë zyrtarin e përputhshmërisë. Ai mund të shkarkojë zyrtarin e përputhshmërisë për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapacitetit profesional, në bazë të kërkesës së autoritetit rregullator.
  12. Zyrtari i përputhshmërisë duhet të ketë qasje në zyrat e operatorit të sistemit të bartjes

pa njoftim paraprak.

## Neni 22

### Zhvillimi i rrjetit dhe kompetencat për marrjen e vendimeve për investime

1. Çdo ditë, operatorët e sistemit të bartjes do t'i dorëzojnë autoritetit rregullator një plan dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit, në bazë të parashikimit të ofertës dhe kërkesës, pasi të kenë konsultuar gjitha palët e përfshira relevante. Ai plan i zhvillimit të rrjetit duhet të përmbajë masa efikase për të garantuar përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit.
2. Në veçanti, plani dhjetë-vjeçar i zhvillimit të rrjetit duhet që:
  - a. t'i njoftojë pjesëmarrësit e tregut me infrastrukturën kryesore të bartjes që duhet ndërtuar apo avancuar në dhjetë vitet e ardhshme;
  - b. të përmbajë gjitha investimet e vendosura tanimë dhe të identifikojë investimet e reja që do të duhet të ekzekutohen në tri vitet e ardhshme; si dhe
  - c. të ofrojë një kornizë kohore për gjitha projektet investive.
3. Kur elaborohet plani dhjetë-vjeçar i zhvillimit të rrjetit, operatori i sistemit të bartjes duhet të ofrojë supozime të arsyeshme për evoluimin e prodhimit, furnizimit, konsumit dhe këmbimeve me vendet tjera, duke marrë parasysh planet investive për rrjetet rajonale dhe ato të Komunitetit, si dhe planet investive për stabilimentet e depozitimit dhe rigazifikimit të GLN-së.
4. Autoriteti rregullator duhet të konsultojë gjithë shfrytëzuesit aktualë ose potencialë mbi planin dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit në mënyrë të hapur dhe transparente. Personat apo sipërmarrjet që pretendojnë të jenë shfrytëzues potencialë të rrjetit mund të obligohen të arsyetojnë ato pretendime. Autoriteti rregullator do të publikojë rezultatin e procesit të konsultimeve, e sidomos nevojat e mundshme për investime.
5. Autoriteti rregullator do të shqyrtojë nëse plani dhjetë-vjeçar i zhvillimit të rrjetit mbulon gjitha nevojat për investime, të identifikuara gjatë procesit të konsultimeve, si dhe nëse është në përputhje me planin dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të Komunitetit (plani zhvillimor I rrjetit në nivel Komuniteti) të përmendur në nenin 8(3)(b) të Rregullores (EC) Nr. 715/2009. Nëse ka dyshime në lidhje me përputhshmërinë me planin e zhvillimit të rrjetit të Komunitetit, autoriteti rregullator duhet të konsultojë Agjencinë. Autoriteti rregullator mund t'i kërkojë operatorit të sistemit të bartjes që të ndryshojë dhe plotësojë planin e tij dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit.
6. Autoriteti rregullator monitoron dhe vlerëson implementimin e planit dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit.
7. Në rrethanat ku operatori i sistemit të bartjes, përveç kur ka arsye të jashtëzakonshme jashtë kontrollit të tij, nuk ekzekuton një investim i cili, sipas planit dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit, është dashur ta ekzekutojë në tri vitet vijuese, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që autoriteti rregullator të jetë i obliguar të ndër marrë së paku një nga këto masa për të siguruar që investimi në fjalë është bërë, apo nëse investimi i tillë është ende relevant, në bazë të planit më të vonshëm të zhvillimit të rrjetit:
  - a. t'i kërkojë operatorit të sistemit të bartjes që të ekzekutojë investimet në fjalë;
  - b. të organizojë një procedurë të hapur tenderimi për investitorët për investimin në fjalë; ose

- c. të obligojë operatorin e sistemit të bartjes që të pranojë rritjen e kapitalit për të financuar investimet e nevojshme dhe të lejojë investitorët e pavarur që të marrin pjesë në kapital.

Aty ku autoriteti rregullator ka ushtruar kompetencat e veta sipas pikës (b) të këtij nën-paragrafi, ai mund të obligojë operatorin e sistemit të bartjes që të pajtohet me një apo më shumë nga këto pika në vijim:

- a. financimin nga cilado palë e tretë;
- b. ndërtimin nga cilado palë e tretë;
- c. ndërtimin e aseteve të reja vetë;
- d. operimin e aseteve të reja vetë.

Operatori i sistemit të bartjes duhet t'i ofrojë investitorëve gjitha informatat e nevojshme për të realizuar investimin, do të lidhë asetet e reja me rrjetin e bartjes, si dhe përgjithësisht bën përpjekjet më të mira për të mundësuar zbatimin e projektit investiv.

Rregullimet përkatëse financiare i duhen nënshtruar miratimit nga autoriteti rregullator.

8. Në rastin kur autoriteti rregullator ka ushtruar kompetencat e veta sipas nën-paragrafit të parë të paragrafit 7, rregulloret përkatëse të tarifave duhet të mbulojnë shpenzimet e investimeve në fjalë.

### *Neni 23*

#### **Kompetencat vendim-marrëse në lidhje me kyçjen e stabilimenteve të depozitimit, stabilimenteve të rigazifikimit të GLN-së, si dhe konsumatorëve industrialë në sistemin e bartjes**

1. Operatori i sistemit të bartjes duhet të përcaktojë dhe publikojë procedurat dhe tarifat transparente e efikase për kyçjen pa diskriminim të stabilimenteve të depozitimit, stabilimenteve të rigazifikimit të GLN-së, si dhe konsumatorëve industrialë në sistemin e bartjes. Ato procedura i duhen nënshtruar miratimit nga autoriteti rregullator.
2. Operatori i sistemit të bartjes nuk duhet të ketë të drejtë të refuzojë kyçjen e një stabilimenti të ri të depozitimit, stabilimenti të rigazifikimit të GLN-së, si dhe konsumatorëve industrialë në bazat e kufizimeve të mundshme të ardhshme në kapacitetet e disponueshme të rrjetit, apo shpenzimeve shtesë që ndërliken me rritjen e domosdoshme të kapacitetit. Operatori i sistemit të bartjes duhet të sigurojë kapacitete të mjaftueshme hyrëse dhe dalëse për kyçjet e reja.

## **KAPITULLI V**

### **SHPËRNDARJA DHE FURNIZIMI**

#### *Neni 24*

#### **Caktimi i operatorëve të sistemit të shpërndarjes**

Shtetet Anëtare duhet të caktojnë, ose t'i kërkojnë sipërmarrjeve që kanë në pronë apo janë përgjegjëse për sistemet e shpërndarjes që të caktojnë, për një periudhë kohore që do të përcaktohet nga Shtetet Anëtare, duke marrë parasysh efikasitetin dhe baraspeshën

ekonomike, një apo më shumë operatorë të sistemit të shpërndarjes, si dhe duhet të sigurojnë që ata operatorë të veprojnë në pajtim me nenet 25, 26 dhe 27.

#### *Neni 25*

##### **Detyrat e operatorëve të sistemit të shpërndarjes**

1. Secili operator i sistemit të shpërndarjes është përgjegjës për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarje të gazit, si dhe për operim, mirëmbajtje dhe zhvillim, në kushte ekonomike, të një sistemi të sigurt, të besueshëm dhe efikas në zonën e vet të përgjegjësisë, me konsideratën e duhur për mjedisin dhe eficiencën e energjisë.
2. Në çdo rast, operatori i sistemit të shpërndarjes nuk mund të diskriminojë mes shfrytëzuesve të sistemit apo klasave të shfrytëzuesve të sistemit, e aq më pak në favor të sipërmarrjeve të ndërlidhura me të.
3. Secili operator i sistemit të shpërndarjes duhet t'i ofrojë secilit operator tjetër të sistemit të shpërndarjes, bartjes, GLN-së, si dhe/ose depozitimit informata të mjaftueshme për të siguruar që transportimi dhe depozitimi i gazit natyror të bëhet në një mënyrë të përputhshme me operimin e sigurt dhe efikas të një sistemi të ndërlidhur (me interkoneksione).
4. Secili operator i sistemit të shpërndarjes duhet t'i ofrojë shfrytëzuesve të sistemit gjitha informatat që nevojiten për qasje efikase ndaj sistemit, duke përfshirë edhe shfrytëzimin e tij.
5. Aty ku operatori i sistemit të shpërndarjes është përgjegjës për balancimin e sistemit shpërndarës, rregullat e miratuara nga ai për atë qëllim duhet të jenë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese, duke përfshirë rregullat për tarifimin e shfrytëzuesve të sistemit për mosbalancim të energjisë. Kushtet dhe afatet, duke përfshirë rregullat dhe tarifatat, për ofrimin e atyre shërbimeve nga operatorët e sistemit të shpërndarjes, duhen caktuar në bazë të një metodologjie në respektim të nenit 41(6) në mënyrë jo-diskriminuese dhe reflektuese ndaj kostos, si dhe duhet publikuar.

#### *Neni 26*

##### **Shturja e operatorëve të sistemit të shpërndarjes**

1. Në rastet kur operatori i sistemit të shpërndarjes është pjesë e një sipërmarrjeje të integruar vertikalisht, ai duhet të jetë i pavarur së paku në kuptimin e formës së vet juridike, organizimit dhe vendim-marrjes nga aktivitetet tjera që nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen. Ato rregulla nuk duhet të krijojnë ndonjë obligim që të ndahet pronësia mbi asetet e sistemit të shpërndarjes nga sipërmarrja e integruar vertikalisht.
2. Përveç kërkesave sipas paragrafit 1, në rastet kur operatori i sistemit të shpërndarjes është pjesë e një sipërmarrjeje vertikalisht të integruar, ai duhet të jetë i pavarur në kuptimin e organizimit dhe vendim-marrjes nga aktivitetet e tjera që nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen. Për të arritur këtë, vlejné këto kriteret minimale:
  - a. personat përgjegjës për menaxhimin e operatorit të sistemit të shpërndarjes nuk marrin pjesë në strukturat udhëheqëse të sipërmarrjes së integruar të gazit që është përgjegjëse, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për operimin e përditshëm të prodhimit, bartjes dhe furnizimit të gazit natyror;

- b. masa të përshtatshme duhen marrë për të siguruar që interesat profesionalë të personave përgjegjës për menaxhimin e operatorit të sistemit të shpërndarjes të merren parasysh në atë mënyrë që të sigurohet që ata të jenë në gjendje të veprojnë në mënyrë të pavarur;
  - c. operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të ketë të drejta efektive të vendim-marrjes, të pavarura nga sipërmarrja e integruar e gazit natyror, në kuptimin e aseteve të nevojshme për të operuar, mirëmbajtur apo zhvilluar rrjetin. Për të përmbushur këto detyra, operatori i sistemit të bartjes duhet të ketë në dispozicion resurset e domosdoshme, si ato njerëzore, teknike, financiare dhe fizike. Kjo nuk parandalon ekzistencën e mekanizmave të përshtatshëm të koordinimit për të siguruar që të drejtat e mbikëqyrjes ekonomike dhe menaxheriale të kompanisë amë, në kuptimin e kthimit mbi asetet, të rregulluar tërthorazi në pajtim me nenin 41(6) në një kompani vartëse, të mbrohen. Në veçanti, kjo i mundëson kompanisë amë që të miratojë planin vjetor financiar, apo ndonjë instrument ekuivalent me të, të operatorit të sistemit të depozitimit, si dhe për të vendosur kufijtë globalë mbi nivelet e borxhit të kompanisë vartëse. Kjo nuk i lejon kompanisë amë që të japë udhëzime në lidhje me operacionet e përditshme, e as në lidhje me vendimet individuale në lidhje me ndërtimin apo avancimin e stabilimenteve të depozitimit, të cilat nuk tejkalojnë kufijtë e planit të miratuar financiar, apo të instrumentit ekuivalent me të; si dhe
  - d. operatori i sistemit të shpërndarjes do të hartojë një program të përputhshmërisë, i cili përcakton masat që merren për të siguruar përjashtimin e sjelljeve diskriminuese, si dhe për të siguruar që respektimi i tij të monitorohet në mënyrën e duhur. Programi i përputhshmërisë përcakton obligimet specifike të punëtorëve për arritjen e atyre synimeve. Raporti vjetor, që përcakton masat e ndërmarra, do të dorëzohet nga personi apo organi përgjegjës për monitorimin e programit të përputhshmërisë, zyrtari i përputhshmërisë i operatorit të sistemit të shpërndarjes, tek autoriteti rregullator I përmendur në nenin 39(1) si dhe do të publikohet si i tillë. Zyrtari i përputhshmërisë së operatorit të sistemit të shpërndarjes duhet të jetë plotësisht i pavarur dhe të ketë qasje në të gjitha informatat e domosdoshme të operatorit të sistemit të shpërndarjes si dhe sipërmarrjet e ndërlidhura me të që të përmbushë detyrat e veta.
3. Në rastet kur operatori i sistemit të shpërndarjes është pjesë e një sipërmarrjeje të integruar vertikalisht, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që aktivitetet e operatorit të sistemit të shpërndarjes të monitorohen nga autoritetet rregullative apo organet tjera kompetente ashtu që të mos mund të shfrytëzojnë integrimin e tyre vertikal për të çrregulluar konkurrencën. Në veçanti, operatorët e sistemit të shpërndarjes me integrim vertikal nuk lejohen, në komunikimin dhe paraqitjet e tyre, që të krijojnë huti në kuptimin e identitetit të veçantë të degës së furnizimit të sipërmarrjes së integruar vertikalisht.
4. Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos zbatojnë paragrafët 1, 2 dhe 3 mbi sipërmarrjet e integruara të gazit natyror që shërbejnë më pak se 100.000 konsumatorë të kyçur.

1. Pa paragjykuar nenin 30, apo ndonjë obligim tjetër ligjor për zbulimin e informatave, secili operator i sistemit të shpërndarjes duhet të ruajë fshehtësinë e informatave të ndjeshme komerciale të marra gjatë kryerjes së aktiviteteve të veta, si dhe do të pengojë informatat për aktivitetet e veta, të cilat mund të përbëjnë përparësi komerciale, që të zbulohen në mënyrë diskriminuuese.
2. Operatorët e sistemit të shpërndarjes nuk mundën, në kontekstin e shitjes apo blerjes së gazit natyror nga sipërmarrjet e ndërlidhura, të keqpërdorin informatat me ndjeshmëri komerciale të marra nga palët e treta në kontekstin e ofrimit apo negocimit të qasjes në sistem.

### *Neni 28*

#### **Sistemet e mbyllura të shpërndarjes**

1. Shtetet Anëtare mund të obligojnë autoritetet e tyre rregullative apo autoritetet tjera kompetente që të klasifikojnë një sistem që shpërndan gazin brenda një zone gjeografikisht të kufizuar industriale, komerciale apo të shërbimeve të përbashkëta, si dhe nuk furnizon, pa paragjykuar paragrafin 4, konsumatorët amvisnorë, si sistem i mbyllur i shpërndarjes, nëse:
  - a. për arsye specifike teknike apo të sigurisë, operacionet apo proceset e prodhimit të shfrytëzuesve të atij sistemi janë të integruara; ose
  - b. ai sistem shpërndan gazin kryesisht tek pronari apo operatori i sistemit apo tek sipërmarrjet e tyre të ndërlidhura me ta.
2. Shtetet Anëtare mund të obligojnë autoritetet e tyre rregullative që të lirojnë operatorin e një sistemi të mbyllur të shpërndarjes nga kërkesa e nenit 32(1) që tarifin, apo metodologjitë që mundësojnë kalkulimin e tyre, të miratohen para se të hyjnë në fuqi në pajtim me nenin 41.
3. Në rastet kur një lirim i tillë mundësohet sipas paragrafit 2, tarifin në fuqi, apo metodologjitë që mundësojnë kalkulimin e tyre, do të shqyrtohen dhe miratohen në pajtim me nenin 41, me kërkesë të shfrytëzuesit të sistemit të mbyllur të shpërndarjes.
4. Shfrytëzimi anësor nga një numër i vogël amvisërisht, me afërsi në kuptimin e punësimit apo tjetër me pronarin e sistemit të shpërndarjes, si dhe të vendosura brenda zonës së shërbyer nga sistemi i mbyllur i shpërndarjes, nuk parandalon lejimin e lirimit sipas paragrafit 2.

### *Neni 29*

#### **Operatori i kombinuar**

Neni 26(1) nuk ndalon operimin e një operatori të kombinuar të sistemit të bartjes, GLN-së, depozitimit dhe shpërndarjes, me kusht që ai operator të jetë në përputhje me nenet 9(1), apo 14 dhe 15, apo kapitullin IV, ose që bie në fushëveprimin e nenit 49(6).

## **KAPITULLI VI**



## **SHTHURJA DHE TRANSPARENCA E LLOGARIVE**

### *Neni 30*

#### **E drejta e qasjes në llogari**

1. Shtetet Anëtare apo autoriteti kompetent që ato kanë caktuar, duke përfshirë autoritetet rregullative të përmendura në nenin 39 (1) si dhe autoritetet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të përmendura në nenin 34(3), deri në masën e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të tyre, duhet të kenë të drejtë të qasjes në llogaritë e sipërmarrjeve të gazit natyror ashtu siç përcaktohet me nenin 31.
2. Shtetet Anëtare apo autoriteti kompetent që ato kanë caktuar, duke përfshirë autoritetet rregullative të përmendura në nenin 39 (1) si dhe autoritetet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, duhet të ruajnë fshehtësinë e informatave me ndjeshmëri komerciale. Shtetet Anëtare mund të obligojnë zbulimin e atyre informatave kur kjo është e domosdoshme ashtu që autoritetet kompetente të kryejnë funksionet e tyre.

### *Neni 31*

#### **Shturja e llogarive**

1. Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të siguruar që llogaritë e gazit natyror të jenë në pajtim me paragrafët 2 deri në 5 të këtij neni. Në rastet kur sipërmarrjet e gazit natyror përfitojnë nga shmangia e kësaj dispozite në bazë të nenit 49(2) dhe (4), ato së paku duhet të mbajnë llogaritë e tyre të brendshme në pajtim me këtë nen.
2. Sipërmarrjet e gazit natyror, çfarëdo sistemi të pronësisë apo forme juridike të kenë ato, duhet të hartojnë, të parashtrojnë për auditim dhe të publikojnë llogaritë e tyre vjetore në pajtim me rregullat e ligjit shtetëror mbi llogaritë vjetore të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, të miratuar në pajtim me Direktivën e Katërt të Këshillit 78/660/EEC të 25 korrikut 1978, në bazë të nenit 44(2)(g) (\*) të Traktatit mbi llogaritë vjetore të disa llojeve të kompanive <sup>(18)</sup> Sipërmarrjet që nuk janë ligjërisht të obliguara të publikojnë llogaritë e tyre vjetore do të mbajnë një kopje të tyre në dispozicion të publikut në zyrat e tyre qendrore.
3. Sipërmarrjet e gazit natyror, në kontabilitetin e tyre të brendshëm, duhet të mbajnë llogari të ndara për secilin aktivitet të bartjes, shpërndarjes, GLN-së dhe depozitimit, sikur të ishin të obliguara të bënin nëse aktivitetet në fjalë do të kryheshin nga sipërmarrje të veçanta, me qëllim të shmangies së diskriminimit, subvencionimit të tërthortë dhe çrregullimit të konkurrencës. Ato gjithashtu duhet të mbajnë llogari, të cilat mund të jenë të konsoliduara, për aktivitetet tjera të gazit që nuk kanë të bëjnë me bartjen, shpërndarjen,

---

\* Titulli i Direktivës 78/660/EEC është përshtatur për të marrë parasysh rinumërimin e neneve të Traktatit për Themelimin e Komunitetit Evropian, në pajtim me nenin 12 të Traktatit të Amsterdimit; referenca fillestare ishte e lidhur me nenin 54(3)(g).

<sup>18</sup> OJ L 222, 14.8.1978, p. 11.

GLN-në dhe depozitim. Deri më 1 korrik 2007, ato duhet të mbajnë llogari të ndara për aktivitetet e furnizimit për konsumatorë të privilegjuar dhe aktivitetet e furnizimit për konsumatorë të paprivilegjuar. Të ardhurat nga pronësia mbi rrjetin e bartjes apo shpërndarjes duhen specifikuar në llogari. Aty ku është e mundur, ato duhet të mbajnë llogari të konsoliduara për aktivitete tjera që nuk kanë të bëjnë me gazin. Llogaritë e brendshme do të përfshijnë edhe bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjes për secilin aktivitet.

4. Auditimi, i përmendur në paragrafin 2, në veçanti do të verifikojë që obligimi i shmangies së diskriminimit dhe subvencionimeve të tërthorta, të përmendura në paragrafin 3, të respektohet.
5. Sipërmarrjet duhet të specifikojnë në kontabilitetin e tyre të brendshëm edhe rregullat për alokimin e aseteve dhe detyrimeve, shpenzimeve dhe të ardhurave, si dhe për amortizimin, pa paragjykuar rregullat e kontabilitetit që vlejné brenda vendit, të cilat i respektojnë në hartimin e llogarive të ndara të përmendura në paragrafin 3. Ato rregulla të brendshme mund të ndryshohen vetëm në raste të jashtëzakonshme. Ato ndryshime duhen përmendur dhe duhen arsyetuar mirë.
6. Llogaritë vjetore do të paraqesin në shënimet e tyre secilin transaksion të një përmase të caktuar që është bërë me sipërmarrjet e ndërlidhura.

## KAPITULLI VII

### ORGANIZIMI I QASJES NË SISTEM

*Neni 32*

#### **Qasja e palëve të treta**

1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë implementimin e një sistemi për qasjen e palëve të treta në sistemin e bartjes dhe shpërndarjes, si dhe stabilimenteve të GLN-së në bazë të tarifave të publikuara, që vlejné për gjithë konsumatorët e privilegjuar, duke përfshirë sipërmarrjet e furnizimit, si dhe që vlejné në mënyrë objektive dhe pa diskriminim mes shfrytëzuesve të sistemit. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ato tarifa, apo metodologjitë që mundësojnë kalkulimin e tyre, të jenë të miratuara para hyrjes së tyre në fuqi në pajtim me nenin 41 nga autoriteti rregullator i përmendur në nenin 39(1) si dhe që ato tarifa – si dhe metodologjitë, në rastet ku miratohen vetëm metodologjitë – të jenë të publikuara para se të hyjnë në fuqi.
2. Operatorët e sistemit të bartjes, nëse është e domosdoshme për qëllimin e kryerjes së funksioneve të tyre në lidhje me bartjen ndërkufitare, duhet të kenë qasje në rrjetin e operatorëve të tjerë të sistemeve të bartjes.
3. Dispozitat e kësaj Direktive nuk parandalojnë nënshkrimin e kontratave afatgjate, deri në masën që ato janë në përputhje me rregullat e Komunitetit për konkurrencë.

### Qasja në depozitim

1. Për organizimin e qasjes në stabilimente të depozitimit dhe depozitimit në sistem, kurdo që teknikisht dhe/ose ekonomikisht të domosdoshme për sigurimin e qasjes efikase në sistem për furnizimin e konsumatorëve, si dhe për organizimin e qasjes në shërbime ndihmëse, Shtetet Anëtare mund të zgjedhin ose njërën ose të dy procedurat e përmendura në paragrafin 3 dhe 4. Ato procedura do të funksionojnë në pajtim me kriteret objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

Autoritetet rregullative, në rastet ku Shtetet Anëtare kanë parashikuar kështu, ose Shtetet Anëtare duhet të përkufizojnë dhe publikojnë kriteret në bazë të të cilave regjimi i qasjes që vlen për stabilimentet e depozitimit dhe depozitimit në sistem mund të përcaktohet. Ato duhet të publikojnë, apo të obligojnë operatorët e sistemit të depozitimit dhe bartjes që të bëjnë publike, se cilat stabilimente të depozitimit, apo cilat pjesë të atyre stabilimenteve të depozitimit, si dhe cili depozitim në sistem ofrohet sipas procedurave të tjera të përmendura në paragrafët 3 dhe 4.

Obligimi i përmendur në fjalinë e dytë të nën-paragrafit të dytë do të jetë pa paragjykim ndaj të drejtës së zgjedhjes që i jepet Shteteve Anëtare në nën-paragrafin e parë.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk vlejnë për shërbimet ndihmëse dhe depozitimin e përkohshëm që ka të bëjë me stabilimentet e GLN-së, si dhe që janë të domosdoshme për procesin e rigazifikimit dhe liferimit të mëpastajshëm tek sistemi i bartjes.
3. Në rastet e qasjes së negociuar, Shtetet Anëtare, apo kudo që është parashikuar ashtu, autoritetet rregullative, duhet të marrin masat e domosdoshme për sipërmarrjet e gazit natyror dhe konsumatorët e privilegjuar, ose brenda ose jashtë territorit të mbuluar nga sistemi i interkonektuar për të qenë në gjendje të negociojnë qasjen në stabilimentet e depozitimit dhe depozitimit në sistem, kurdo që është teknikisht apo/dhe ekonomikisht e domosdoshme për sigurimin e qasjes efikase ndaj sistemit, si dhe për organizimin e qasjes në shërbime tjera ndihmëse. Palët duhen obliguar që të negociojnë depozitimin, depozitimin në sistem dhe shërbimet tjera ndihmëse në vullnet të mirë.

Kontratat për qasje në depozitim, depozitimit në sistem dhe shërbimet tjera ndihmëse duhen negociuar me operatorin përkatës të sistemit të depozitimit apo sipërmarrjet e gazit natyror. Autoritetet rregullative, aty ku është parashikuar kështu nga Shtetet Anëtare, apo vetë Shtetet Anëtare do t'i obligojnë operatorët e sistemit të depozitimit dhe sipërmarrjet e gazit natyror që të publikojnë kushtet e tyre kryesore komerciale për shfrytëzimin e depozitimit, depozitimit në sistem dhe shërbimeve tjera ndihmëse deri më 1 janar 2005 si dhe në baza vjetore, për çdo vit vijues.

Kur hartohen kushtet e përmendura në nën-paragrafin e dytë, operatorët e depozitimit dhe sipërmarrjet e gazit natyror do të konsultojnë shfrytëzuesit e sistemit.

4. Në rastin e qasjes së rregulluar, autoritetet rregullative, aty ku Shtetet Anëtare kanë parashikuar kështu, ose vetë Shtetet Anëtare, duhet të marrin masat e domosdoshme për t'i dhënë sipërmarrjeve të gazit natyror dhe konsumatorëve të privilegjuar ose brenda ose jashtë territorit të mbuluar nga sistemi i interkonektuar të drejtën e qasjes ndaj depozitimit, depozitimit në sistem dhe shërbimeve tjera ndihmëse, në bazë të tarifave të publikuara dhe/ose kushteve dhe obligimeve tjera për shfrytëzimin e atij depozitimi dhe depozitimit në sistem, kurdo që teknikisht ose/dhe ekonomikisht e

domosdoshme për sigurimin e qasjes efikase në sistem, si dhe për organizimin e qasjes ndaj shërbimeve tjera ndihmëse. Autoritetet rregullative, aty ku Shtetet Anëtare kanë parashikuar kështu, apo vetë Shtetet Anëtare konsultojnë shfrytëzuesit e sistemit kur krijojnë tarifatat apo metodologjitë e tarifave. E drejta e qasjes për konsumatorë të privilegjuar mund të ofrohet duke iu mundësuar atyre të hyjnë në kontrata të furnizimit me sipërmarrjet e gazit natyror që janë konkurrense, që janë ndryshe nga pronari dhe/ose operatori i sistemit apo një sipërmarrjeje të ndërlidhur me të.

#### *Neni 34*

#### **Qasja në rrjetet gazsjellëse në rrjedhë të sipërme**

1. Shtetet Anëtare duhet të marrin gjitha masat e nevojshme për të siguruar që sipërmarrjet e gazit natyror dhe konsumatorët e privilegjuar, kudo që ata janë të vendosur, të jenë në gjendje të sigurojnë qasjen e tyre në rrjete gazsjellëse në rrjedhë të sipërme, duke përfshirë stabilimentet që ofrojnë shërbime teknike që janë anësore për atë qasje, në pajtim me këtë nen, përveç pjesëve të atyre rrjeteve dhe stabilimenteve të cilat përdoren për operacionet lokale të prodhimit në lokacionin e një zone ku prodhohet gazi. Masat duhen njoftuar tek Komisioni në pajtim me dispozitat e nenit 54.
2. Qasja e referuar në paragrafin 1 duhet siguruar në mënyrën e përcaktuar nga Shteti Anëtar në pajtim me instrumentet përkatëse ligjore. Shtetet Anëtare do të zbatojnë synimet e qasjes së drejtë dhe të hapur, duke arritur një treg konkurrues të gazit natyror, si dhe duke shmangur çdo keqpërdorim të pozitës dominuese, duke marrë parasysh sigurinë dhe rregullsinë e furnizimit, kapacitetin e cili është apo në masë të arsyeshme mund të vihet në dispozicion, si dhe mbrojtjen e mjedisit. Mund të merren parasysh edhe çështjet në vijim:
  - a. nevoja për refuzimin e qasjes ku ka mospërputhje të specifikimeve teknike, të cilat nuk mund të tejkalohen në mënyrë të arsyeshme;
  - b. nevoja e shmangies së vështirësive të cilat nuk mund të tejkalohen në mënyrë të arsyeshme dhe do të mund të paragjykonte prodhimin efikas, aktual dhe të planifikuar të karbohidrateve, duke përfshirë atë nga fushat e një qëndrueshmërie të skajshme ekonomike;
  - c. nevoja për respektimin e nevojave të arsyeshme e të arsyetuara të pronarit apo operatorit të rrjetit gazsjellës të rrjedhës së sipërme për transportim dhe përpunim të gazit si dhe interesat e gjithë shfrytëzuesve tjerë të rrjetit gazsjellës të rrjedhës së sipërme apo stabilimenteve gjegjëse të përpunimit apo trajtimit të cilët mund të ndikohen; si dhe
  - d. nevoja për zbatimin e ligjeve dhe procedurave të tyre administrative, në përputhje me legjislacionin e Komunitetit, për dhënien e autorizimit për prodhim apo zhvillim në rrjedhë të sipërme.
3. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë dhe të vendosin rregullimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke përfshirë autoritetin e pavarur nga palët që kanë qasje në gjitha informatat përkatëse, për të mundësuar që mosmarrëveshjet në lidhje me qasjen në rrjete gazsjellëse të rrjedhës së sipërme të zgjidhen në mënyrë të shpejtë, duke marrë parasysh kriteret e paragrafit 2 dhe numrin e palëve që mund të përfshihen në negociimin e qasjes në ato rrjete.

4. Në rastin e mosmarrëveshjeve ndërkufitare, do të vlejë rregullimet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për Shtetet Anëtare që kanë juridiksion mbi rrjetin gazsjellës të rrjedhës së sipërme i cili refuzon qasjen. Në rastet ku në mosmarrëveshjet ndërkufitare, më shumë se një Shtet Anëtar mbulon rrjetin në fjalë, Shtetet Anëtare përkatëse do të konsultohen mes vete me qëllim që të sigurojnë që dispozitat e kësaj Direktive të zbatohen me përpikëri.

#### *Neni 35*

##### **Refuzimi i qasjes**

1. Sipërmarrjet e gazit natyror mund të refuzojnë qasjen në sistem në bazë të mungesës së kapacitetit, apo në rastet kur qasja në sistem do të pengonte kryerjen e obligimeve të shërbimit publik të përshkruara me nenin 3(2) të cilat i janë veshur atyre apo në bazë të vështirësive serioze ekonomike dhe financiare me kontrata merr-ose-paguaj, duke marrë parasysh kriteret dhe procedurat e përshkruara me nenin 48 si dhe alternativën e zgjedhur nga Shteti Anëtar në pajtim me paragrafin 1 të atij neni. Për refuzimin e tillë, duhen dhënë arsye të bazuara.
2. Shtetet Anëtare mund të marrin masat e nevojshme për të siguruar që sipërmarrja e gazit natyror që refuzon qasjen në sistem, në bazë të mungesës së kapacitetit apo mungesës së kyçjes t'i bëjë avancimet e nevojshme, për aq sa është ekonomike të bëhen, apo kur konsumatori potencial është i gatshëm të paguajë për to. Në rrethanat kur Shtetet Anëtare zbatojnë nenin 4(4), Shtetet Anëtare duhet të marrin masa të tilla.

#### *Neni 36*

##### **Infrastruktura e re**

1. Infrastrukturat e reja madhore të gazit, si interkoneksionet, stabilimentet e GLN-së dhe depozitimit, në bazë të kërkesës, mund të lirohen, për një periudhë të caktuar kohore, nga dispozitat e neneve 9, 32, 33 dhe 34 si dhe nenit 41(6), (8) dhe (10) në kushtet si në vijim:
  - a. investimi duhet të avancojë konkurrencën në furnizimin e gazit dhe të avancojë sigurinë e furnizimit;
  - b. niveli i rrezikut që shkon bashkë me investimin duhet të jetë i tillë që investimi nuk do të bëhej nëse një lirim nga obligimet e tilla nuk do të jepej;
  - c. infrastruktura duhet të jetë pronë e një personi fizik apo juridik i cili është i ndarë, së paku në formën e tij juridike, nga operatorët e sistemeve në ato sisteme ku do të ndërtohet infrastruktura;
  - d. tarifat duhet të inkasohen nga shfrytëzuesit e asaj infrastrukture; si dhe
  - e. lirimi nuk mund të jetë dëmtues ndaj konkurrencës apo funksionimit efektiv të tregut të brendshëm të gazit natyror, apo funksionimit efikas të sistemit të rregulluar në të cilin do të kyçet infrastruktura.
2. Paragrafi 1 gjithashtu vlen për rritjet e konsiderueshme të kapacitetit në infrastrukturën ekzistuese dhe për modifikimet e asaj infrastrukture të cilat mundësojnë zhvillimin e burimeve të reja të furnizimit të gazit.
3. Autoriteti rregullator i përmendur në Kapitullin VIII mundet, në raste të caktuara, të vendosë për lirimin e përmendur në paragrafët 1 dhe 2.

4. Në rastet ku infrastruktura në fjalë është e vendosur në territorin e më shumë se një Shteti Anëtar, Agjencia mund të dorëzojë mendimin e vet këshillues tek autoritetet rregullative të Shteteve Anëtare në fjalë, i cili mund të përdoret si bazë për vendimin e tyre, brenda dy muajsh nga data në të cilën kërkesa për lirim është pranuar nga autoriteti rregullator i fundit.

Në rastin ku autoritetet rregullative në fjalë pajtohen për kërkesën për lirim brenda gjashtë muajsh nga data në të cilën është pranuar nga autoriteti i fundit rregullative, ata do të informojnë Agjencinë për vendimin e tyre.

Agjencia duhet të ushtrojë detyrat që janë bartur tek autoritetet rregullative të Shteteve Anëtare në fjalë sipas këtij neni:

- a. në rastet ku autoritetet rregullative në fjalë nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë një marrëveshje brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data në të cilën është pranuar kërkesa për lirim nga autoriteti i fundit rregullative; ose
- b. në bazë të një kërkesë të përbashkët nga autoritetet rregullative në fjalë.

Gjitha autoritetet rregullative munden, bashkërisht, të kërkojnë që periudha e përshkruar me pikën (a) të nën-paragrafit të tretë të zgjatet për tre muaj të tjerë.

5. Para se të marrë vendimin, Agjencia duhet të konsultojë autoritetet përkatëse rregullative si dhe aplikuesit.
6. Lirimi mund të mbulojë gjithë apo një pjesë të kapacitetit të infrastrukturës së re, apo të infrastrukturës ekzistuese me kapacitet të rritur në masë të konsiderueshme.

Në vendimin për dhënien e lirit, duhet marrë parasysh, në raste individuale, nevojën për vendosjen e kushteve në lidhje me kohëzgjatjen e lirit dhe qasjes mos-diskriminuese ndaj infrastrukturës. Kur vendoset mbi ato kushte, duhet marrë parasysh sidomos kapaciteti shtesë që duhet ndërtuar ose modifikimi i kapacitetit ekzistues, korniza kohore e projektit dhe rrethanat në shtet.

Para se të lejojnë lirim, autoriteti rregullative duhet të vendosë për rregullat dhe mekanizmat për menaxhimin dhe ndarjen e kapacitetit. Rregullat duhet të parashikojnë që gjithë shfrytëzuesit potencialë të infrastrukturës të ftohen që të shfaqin interesimin e tyre për kontraktimin e kapacitetit të infrastrukturës së re, duke përfshirë konsumin e brendshëm. Autoriteti rregullator do të kërkojë që rregullat e menaxhimit të dyndjeve të përfshijnë obligimin për të ofruar kapacitetin e pashfrytëzuar në treg, si dhe do t'i kërkojë shfrytëzuesve të infrastrukturës që të kenë të drejtë të tregtojnë kapacitetin e tyre të kontraktuar në tregje sekondare. Në vlerësimin e kriterëve të përshkruara me pikat (a), (b) dhe (e) të paragrafit 1, autoriteti rregullator duhet të marrë parasysh rezultatet e asaj procedure të ndarjes së kapacitetit.

Vendimi për lirim, duke përfshirë kushtet e përshkruara në nën-paragrafin e dytë të këtij paragrafi, duhet arsyetuar mirë dhe duhet publikuar.

7. Pa përjashtuar paragrafin 3, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që autoriteti i tyre rregullator, ose Agjencia, sido që të jetë e përcaktuar, duhet të dorëzojnë, për qëllimet e vendimit formal, tek organi përkatës i Shtetit Anëtar, mendimin e vet për kërkesën për lirim. Ati mendim duhet publikuar bashkë me vendimin.
8. Autoriteti Rregullator duhet t'i transmetojë Komisionit, pa vonesë, një kopje të secilës kërkesë për lirim menjëherë pas pranimin të saj. Vendimi duhet t'i komunikohet, pa vonesë, nga autoriteti kompetent Komisionit, bashkë me gjitha informatat përkatëse në lidhje me vendimin. Ajo informatë mund t'i parashtrohen Komisionit në formë agregate,

duke i mundësuar Komisionit të arrijë një vendim meritore. Në veçanti, informatat duhet të përmbajnë:

- a. arsyet e detajuara në bazë të të cilave autoriteti rregullativ, apo Shteti Anëtar, ka dhënë apo ka refuzuar lirimin, bashkë me referencën ndaj paragrafit 1, duke përfshirë pikën apo pikat përkatëse të atij paragrafi mbi të cilën bazohet ai vendim, duke përfshirë informatat financiare që arsyetojnë nevojën për një lirim të tillë;
  - b. analizat e bërë mbi ndikimin në konkurrencë dhe funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit natyror që krijohet nga dhënia e atij lirimi;
  - c. arsyet për periudhën kohore dhe hisen e kapacitetit të plotë të infrastrukturës së gazit në fjalë, për të cilën është dhënë lirim;
  - d. në rastin kur lirim ka të bëjë me një interkonektor, rezultati i konsultimeve me autoritetin rregullativ në fjalë; si dhe
  - e. kontributi i infrastrukturës në diversifikimin e furnizimit të gazit.
9. Brenda një periudhe prej dy muajsh nga dita pas pranimit të njoftimit, Komisioni mund të marrë vendim që obligon autoritetin rregullator të ndryshojë apo tërheqë vendimin për dhënie të lirim. Ajo periudhë dy-mujore mund të zgjatet për një periudhë shtesë prej dy muajsh, ku kërkohen informatat shtesë nga Komisioni. Ajo periudhë shtesë fillon në ditën pas pranimit të informatave të plota. Periudha fillestare dy-mujore gjithashtu mund të zgjatet me pëlqimin e Komisionit dhe autoritetit rregullator.

Në rastet ku informatat e kërkuara nuk sigurohen brenda periudhës së caktuar me kërkesë, njoftimi do të konsiderohet të jetë tërhequr, përveç nëse para skadimit të asaj periudhe, ose periudha është zgjatur me pëlqimin e Komisionit dhe autoritetit rregullator, ose autoriteti rregullator, në një deklaratë me arsyetimin e duhur, ka informuar Komisionin që e konsideron njoftimin të jetë i plotë.

Autoriteti rregullator duhet të zbatojë vendimin e Komisionit për ndryshimin apo tërheqjen e vendimit të lirim brenda një periudhe prej një muaji, si dhe do ta informojë Komisionin mbi këtë.

Komisioni duhet të ruajë fshehtësinë e informatave me ndjeshmëri komerciale.

Miratimi i Komisionit mbi një vendim lirim humb efektin e tij dy vjet nga miratimi i tij, në rast se ndërtimi i infrastrukturës nuk ka filluar ende, si dhe pesë vjet prej miratimit të tij në rast se infrastruktura nuk ka hyrë në funksion, përveç nëse Komisioni vendos që ajo vonesë është bërë për shkak të pengesave madhore jashtë kontrollit të personit për të cilin është dhënë lirim.

10. Komisioni mund të miratojë Udhëzime për zbatimin e kushteve të përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni, si dhe për të përcaktuar procedurën që duhet ndjekur për zbatimin e paragrafëve 3, 6, 8 dhe 9 të këtij neni. Ato masa, të hartuara për të ndryshuar elementet jo-thelbësore të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, duhen miratuar në pajtim me procedurën rregullative, bashkë me vëzhgimin e përmendur në nenin 51(3).

### *Neni 37*

#### **Hapja e tregut dhe reciprociteti**

1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që konsumatorët e privilegjuar të përfshijnë:
  - a. deri më 1 korrik 2004, konsumatorët e privilegjuar, sipas përcaktimit në nenin 18 të

Direktivës 98/30/EC së Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 22 qershorit 1998 në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror <sup>(19)</sup>. Shtetet Anëtare duhet të publikojnë, deri më 31 janar të çdo viti, kriteret e përkufizimit të atyre konsumatorëve të privilegjuar;

- b. nga 1 korriku 2004, gjithë konsumatorët jo-amvisnorë;
  - c. nga 1 korriku 2007, gjithë konsumatorët.
2. Për të shmangur prishjen e balancit në hapjen e tregjeve të gazit:
- a. kontratat për furnizim me një konsumator të privilegjuar në sistemin e një Shteti tjetër Anëtar nuk mund të ndalohen nëse konsumatori është i privilegjuar në të dyja sistemet e përfshira; si dhe
  - b. aty ku transaksionet e përshkruara me pikën (a) refuzohen për shkak se konsumatori është i privilegjuar në vetëm një prej dy sistemeve, Komisioni mundet, duke marrë parasysh gjendjen në treg dhe interesin e përbashkët, të obligojë palën refuzuese të ekzekutojë furnizimin e kërkuar, me kërkesë të një prej Shteteve Anëtare të dy sistemeve.

#### *Neni 38*

##### **Linjat direkte**

1. Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e domosdoshme për të mundësuar:
  - a. sipërmarrjet e gazit natyror të themeluara brenda territorit të tyre për të furnizuar konsumatorët e privilegjuar përmes një linje direkte; si dhe
  - b. që secili konsumator i privilegjuar brenda territorit të tyre të furnizohet përmes një linje direkte nga sipërmarrjet e gazit natyror.
2. Në rrethanat në të cilat një autorizim (për shembull licencë, lejim, koncesion, pëlqim apo miratim) është i nevojshëm për ndërtimin apo operativin e linjave direkte, Shtetet Anëtare apo një autoritet kompetent që caktohet nga ato, duhet të përcaktojnë kriteret për dhënien e autorizimeve për ndërtimin apo operimin e atyre linjave në territorin e tyre. Ato kriteret duhet të jenë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.
3. Shtetet Anëtare mund të lëshojnë një autorizim për të ndërtuar një linjë direkte, që është subjekt ose i refuzimit të qasjes në sistem në bazë të nenit 35 ose të hapjes së procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas nenit 41.

## **KAPITULLI VIII**

### **AUTORITETET SHTETËRORE RREGULLATORE**

#### *Neni 39*

##### **Caktimi dhe pavarësia e autoriteteve rregullatore**

1. Secili Shtet Anëtar duhet të caktojë një autoritet të vetëm shtetëror rregullator në nivel shteti.

---

<sup>19</sup> OJ L 204, 21.7.1998, p. 1.;



2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk paragjykon caktimin e autoriteteve tjera rregullatore në nivel rajonal brenda Shteteve Anëtare, me kusht që të ketë një përfaqësues të lartë për përfaqësim dhe kontaktim në nivel Komuniteti, brenda Bordit të Rregullatorëve të Agjencisë në pajtim me nenin 14(1) të Rregullores (EC) Nr. 713/2009.
3. Me anë të shmangies nga paragrafi 1 të këtij neni, Shteti Anëtar mund të caktojë autoritete rregullatore për sisteme të vogla në një rajon të ndarë gjeografikisht, konsumi i të cilit më 2008 përbën më pak se 3 % të konsumit total të Shtetit Anëtar pjesë e të cilit është. Kjo shmangie ofrohet pa paragjykuar emërimin e një përfaqësuesi të lartë për përfaqësim dhe kontaktim në nivel Komuniteti, brenda Bordit të Rregullatorëve të Agjencisë në përputhje me nenin 14(1) të Rregullores (EC) Nr. 713/2009.
4. Shtetet Anëtare duhet të garantojnë pavarësinë e rregullatorit, si dhe të sigurojnë që ai ushtron kompetencat e veta në mënyrë të paanshme dhe transparente. Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që, kur kryejnë detyrat e rregullatorit të deleguara tek ato me këtë Direktivë dhe legjislacionin përkatës, autoriteti rregullator:
  - a. të jetë ligjërish i ndarë dhe funksionalisht i pavarur nga secili subjekt tjetër publik apo privat;
  - b. të sigurojë që personeli i tij dhe personat përgjegjës për menaxhimin e tij:
    - i. vepron pavarësisht nga interesat e tregut; si dhe
    - ii. nuk kërkon e as merr udhëzime direkte nga qeveria apo ndonjë subjekt tjetër publik apo privat kur kryen detyrat e rregullatorit. Kjo kërkesë nuk paragjykon bashkëpunimin e afërt, sipas nevojës, me autoritetet përkatëse shtetërore apo me udhëzimet e politikave të përgjithshme të lëshuara nga qeveria, që nuk kanë të bëjnë me kompetencat e detyrat e rregullatorit sipas nenit 41.
5. Për të mbrojtur pavarësinë e autoritetit rregullator, Shteti Anëtar në veçanti duhet të sigurojë që:
  - a. Autoriteti rregullator të mund të marrë vendime autonome, të pavarura nga secili organ politik, si dhe të ketë ndarje të veçantë buxhetore vjetore, me autonomi në implementimin e buxhetit të ndarë, si dhe resurse adekuate njerëzore dhe financiare për të kryer detyrat e veta, si dhe
  - b. Anëtarët e bordit të autoritetit rregullator, ose në mungesë të bordit, menaxhmenti i lartë i autoritetit rregullator, zgjedhen për një mandat të fiksuar prej pesë deri në shtatë vjet, që mund të ripërtërihet një herë.

Në lidhje me pikën (b) të nën-paragrafit të parë, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë një skemë të përshtatshme rotacioni për bordin apo menaxhmentin e lartë. Anëtarët e bordit, ose në mungesë të bordit, menaxhmenti i lartë i autoritetit rregullator, mund të shkarkohen nga pozita e tyre gjatë mandatit vetëm nëse nuk përmbushin më kushtet e përcaktuara me këtë nen, ose janë shpallur fajtorë për veprat sipas të drejtës ndërkombëtare.

#### *Neni 40*

#### **Synimet e përgjithshme të autoritetit rregullator**

Në kryerjen e detyrave të rregullatorit të përcaktuara me këtë Direktivë, autoriteti rregullator duhet të marrë gjitha masat e arsyeshme për arritjen e synimeve vijuese në kuadër të detyrave dhe kompetencave të tyre, ashtu siç përcaktohet me nenin 41, në

konsultim të afërt me autoritetet tjera relevante shtetërore, duke përfshirë autoritetet e konkurrencës, sipas nevojës, si dhe pa paragjykuar kompetencat e tyre:

- (a) Promovimi, në bashkëpunim të afërt me Agjencinë, autoritetet rregullatore të Shteteve tjera Anëtare dhe Komisionin, i një tregu të brendshëm konkurrues, të sigurt dhe të qëndrueshëm në kuptimin mjedisor të gazit natyror brenda Komunitetit, si dhe i hapjes efektive të tregut për gjithë konsumatorët dhe furnizuesit në Komunitet, si dhe sigurimit të kushteve të përshtatshme për operim efektiv dhe të besueshëm të rrjeteve të gazit, duke marrë parasysh synimet afatgjate;
- (b) Zhvillimi i tregjeve konkurrencte dhe funksionale rajonale brenda Komunitetit, në kuptimin e arritjes së synimeve të përmendura në pikën (a);
- (c) Eliminimi i kufizimeve ndaj tregtisë me gaz natyror mes Shteteve Anëtare, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve të duhura ndërkufitare për të mbuluar kërkesën dhe për të avancuar integrimin e tregjeve shtetërore, gjëra që mund të lehtësojnë rrjedhën e gazit natyror përgjatë gjithë Komunitetit;
- (d) Ndhma në arritjen, në mënyrën më efektive për koston, e zhvillimit të sistemeve të sigurta, të besueshme dhe efikase e jo-diskriminuese që janë të orientuar kah konsumatori, si dhe promovimi i përshtatshmërisë së sistemeve, si dhe në përputhje me synimet e politikës së përgjithshme të energjisë, eficiencës së energjisë, bashkë me integrimin e prodhimit në masë të madhe dhe të vogël të gazit nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe prodhimit të shpërndarë në rrjetet e bartjes dhe shpërndarjes;
- (e) Lehtësimi i qasjes në rrjet për kapacitetet e reja të prodhimit, sidomos heqja e barrierave që do të mund të pengonin qasjen e aktorëve të rinj të treg dhe të gazit nga burimet e ripërtërishme të energjisë;
- (f) Të siguruarit që operatorët e sistemit dhe shfrytëzuesit e sistemit të përfitojnë stimuj të përshtatshëm, në afat të shkurtër dhe të gjatë, për të rritur eficiencën e tyre, në performancën e sistemit dhe nxitjen e integritit të tregut;
- (g) Të siguruarit që konsumatorët të përfitojnë përmes funksionimit efikas të tregut të tyre shtetëror, duke promovuar konkurrencë efektive dhe duke ndihmuar në të siguruarit e mbrojtjes së konsumatorit;
- (h) Ndhma në arritjen e standardeve të larta të shërbimit publik për gaz natyror, duke kontribuar në mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm dhe duke kontribuar në përputhshmërinë e proceseve të nevojshme të këmbimit të të dhënave për kalim të konsumatorëve tek furnizuesit tjerë.

#### *Neni 41*

#### **Detyrat dhe kompetencat e autoritetit rregullator**

1. Autoriteti rregullator duhet të ketë detyrat në vijim:
  - a. Caktimi apo miratimi, në pajtim me kriteret transparente, i tarifave të bartjes apo shpërndarjes apo metodologjitë e tyre;
  - b. Sigurimi i përputhshmërisë së operatorëve të sistemit të bartjes dhe shpërndarjes, si dhe kudo që vlen, pronarëve të sistemit, si dhe sipërmarrjeve tjera të gazit natyror,

me obligimet e tyre sipas kësaj Direktive dhe legjislacionit tjetër relevant të Komunitetit, duke përfshirë atë në lidhje me çështjet ndërkufitare;

- c. Bashkëpunimi në lidhje me çështjet ndërkufitare me autoritetin rregullator apo autoritetet e Shteteve Anëtare në fjalë dhe me Agjencinë;
- d. Respektimi, si dhe zbatimi, i vendimeve ligjërish obligative relevante të Agjencisë dhe të Komisionit;
- e. Raportimi vjetor mbi aktivitetet e veta dhe përmbushjen e detyrave të veta tek autoritetet përkatëse të Shteteve Anëtare, Agjencia dhe Komisioni. Raportet e tilla duhet të përmbajnë hapat e ndërmarrë dhe rezultatet e arritura në lidhje me secilën nga detyrat e rreshtuara në këtë nen;
- f. Sigurimi që të mos ketë subvencionime të tërthorta mes aktiviteteve të bartjes, shpërndarjes, depozitimit, GLN-së dhe furnizimit;
- g. Monitorimi i planeve investive të operatorëve të sistemit të bartjes, si dhe ofrimi në raportet e veta vjetore të një vlerësimi të planeve investive të operatorëve të sistemit të bartjes në lidhje me përputhjen e tyre me planin e zhvillimit të rrjetit të Komunitetit të përcaktuar me nenin 8(3)(b) të Rregullores (EC) Nr. 715/2009; vlerësimi i tillë mund të përfshijë rekomandimet për ndryshimin e atyre planeve investive;
- h. Monitorimi i përputhshmërisë me dhe shqyrtimi i performancës së kaluar të sigurisë së rrjetit dhe rregullave të qëndrueshmërisë, si dhe caktimi apo miratimi i standardeve dhe kërkesave për cilësinë e shërbimit dhe furnizimit, ose kontribuimi në to bashkë me autoritetet tjera kompetente;
- i. Monitorimi i nivelit të transparencës, duke përfshirë atë të çmimeve të shumicës, si dhe sigurimi i përputhshmërisë së sipërmarrjeve të gazit natyror me obligimet e transparencës;
- j. Monitorimi i nivelit dhe efektshmërisë së hapjes së tregut dhe konkurrencës në nivele të shumicës dhe pakicës, duke përfshirë këmbimet e gazit natyror, çmimet për konsumatorë amvisnorë, duke përfshirë sistemet e parapagimit, tarifat e kalimit tek furnizuesit tjerë, tarifat e shkyçjes, shpenzimet dhe ekzekutimi i shërbimeve të mirëmbajtjes dhe ankesat nga konsumatorët amvisnorë, si dhe çrregullimet apo kufizimet e konkurrencës, duke përfshirë ofrimin e informatave përkatëse, si dhe ngritja e rasteve relevante tek autoritetet përkatëse të konkurrencës;
- k. Monitorimi i pranisë së praktikave kufizuese kontraktuale, duke përfshirë klauzolat e ekskluzivitetit të cilat mund të pengojnë konsumatorët e mëdhenj jo-amvisnorë nga kontraktimi i njëkohshëm me më shumë se një furnizues, apo kufizojnë zgjedhjen e tyre për ta bërë këtë, si dhe kudo që është e përshtatshme, duke informuar autoritetet shtetërore të konkurrencës për ato praktika;
- l. Respektimi i lirisë së kontraktimit në kuptimin e kontratave të furnizimit të ndërprerëshëm, si dhe në kuptimin e kontratave afatgjate, me kusht që ato të jenë në përputhje me ligjin e Komunitetit dhe në përputhje me politikat e Komunitetit;
- m. Monitorimi i kohës që shpenzohet nga operatorët e sistemit të bartjes dhe shpërndarjes për të bërë kyçjet dhe riparimet;
- n. Monitorimi dhe shqyrtimi i kushteve të qasjes ndaj depozitimit, depozitimit në sistem si dhe shërbimeve tjera ndihmëse siç përcaktohet me nenin 33. Në rast se

regjimi i qasjes ndaj depozitimit është i definuar sipas nenit 33(3), ajo detyrë nuk përfshin shqyrtimin e tarifave;

- o. Ndihma në sigurimin, bashkë me autoritetet tjera përkatëse, që masat e mbrojtjes së konsumatorëve, duke përfshirë ato që përcaktohen me Shtojcën I, janë efektive dhe të zbatuara;
- p. Publikimi i rekomandimeve, së paku një herë në vit, në lidhje me përputhshmërinë e çmimeve të furnizimit me nenin 3, si dhe dorëzimi i tyre tek autoritetet e konkurrencës, kudo që është e përshtatshme;
- q. Sigurimi i qasjes në të dhënat e konsumit të konsumatorëve, ofrimi për shfrytëzim opsional, të një formati të harmonizuar lehtësisht të kuptueshëm në nivel shtetëror për të dhëna të konsumit dhe qasje të shpejtë për gjithë konsumatorët në ato të dhëna, sipas pikës (h) të Shtojcës I;
- r. Monitorimi i implementimit të rregullave në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e operatorëve të sistemit të bartjes, operatorëve të sistemit të shpërndarje, furnizuesve dhe konsumatorëve e palëve tjera në treg sipas Rregullores (EC) Nr. 715/2009;
- s. Monitorimi i zbatimit korrekt të kriterëve që përcaktojnë nëse stabilimenti i depozitimit është brenda dispozitave të nenit 33(3) ose (4); si dhe
- t. Monitorimi i implementimit të masave mbrojtëse siç përmenden në nenin 46;
- u. Kontribuimi në përputhshmërinë e proceseve të këmbimit të të dhënave për proceset më të rëndësishme të tregut në nivel rajonal.

2. Aty ku Shteti Anëtar ka përcaktuar ashtu, detyrat e monitorimit të përcaktuara me paragrafin 1 mund të kryhen nga autoritete tjera përveç autoritetit rregullator. Në rastin e tillë, informatat që dalin nga monitorimi i tillë duhen vënë në dispozicion të autoritetit rregullator sa më shpejt që është e mundur.

Derisa ruajnë pavarësinë e tyre, pa paragjykuar kompetencat vetanake specifike dhe në përputhje me parimet e rregullimit më të mirë, autoritetet rregullatore duhet, sipas nevojës, të konsultojnë operatorët e sistemit të bartjes, si dhe sipas nevojës, të bashkëpunojnë me autoritetet tjera përkatëse shtetërore kur kryejnë detyrat e përcaktuara me paragrafin 1.

Gjitha miratimet që jepen nga një autoritet rregullator apo Agjencia sipas kësaj Direktive janë pa paragjykim ndaj ndonjë shfrytëzimi të ardhshëm të arsyetuar mirë të kompetencave të veta nga autoriteti rregullator sipas këtij neni, apo ndaj sanksioneve që vendosen nga autoritetet tjera përkatëse apo Komisioni.

3. Përveç detyrave të deleguara tek ai sipas paragrafit 1 të këtij neni, kur një operator i pavarur i sistemit është caktuar sipas nenit 14, autoriteti rregullator duhet që të:
- a. Monitorojë respektimin e obligimeve të këtij neni nga pronari i sistemit të bartjes dhe operatori i pavarur i sistemit, si dhe vendosja e sanksioneve për mosrespektim në pajtim me paragrafin 4(d);
  - b. Monitorojë marrëdhëniet dhe komunikimet mes operatorit të pavarur të sistemit dhe pronarit të sistemit të bartjes, ashtu që të sigurojë respektimin e obligimeve nga operatori i pavarur i sistemit, si dhe në veçanti të miratojë kontratat dhe të veprojë si autoritet i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes operatorit të pavarur të

sistemit dhe pronarit të sistemit të bartjes në lidhje me ankesat që parashtrohet nga cilado palë në pajtim me paragrafin 11;

- c. Pa paragjykuar procedurën sipas nenit 14(2)(c), për planin e parë dhjetë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit, të miratojë planifikimin e investimeve dhe planin shumë-vjeçar të zhvillimit të rrjetit që dorëzohet çdo vit nga operatori i pavarur i sistemit;
  - d. Të sigurojë që tarifat e qasjes në rrjet që inkasohen nga operatori i pavarur i sistemit të përfshijnë kompensimin për pronarin e rrjetit apo pronarët e rrjetit, gjë që siguron kompensimin adekuat të aseteve të rrjetit si dhe të investimeve të reja që bëhen në të, me kusht që ato të jenë bërë në mënyrë ekonomike dhe efikase; si dhe
  - e. Të kenë kompetencat e kryerjes së inspektimeve, duke përfshirë inspektimet e paparalajmëruara, në lokalet e pronarit të sistemit të bartjes dhe operatorit të pavarur të sistemit.
4. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet rregullatore të kenë kompetencat që iu mundësojnë atyre të kryejnë detyrat e përcaktuara me paragrafët 1, 3 dhe 6 në mënyrë efikase dhe ekspeditive. Për këtë qëllim, autoriteti rregullator duhet të ketë së paku këto kompetenca në vijim:
- a. Të marrë vendime obligative për sipërmarrjet e gazit natyror;
  - b. Të kryejë hetime për funksionimin e tregjeve të gazit, si dhe të vendosin për si dhe të marrin masa të domosdoshme dhe proporcionale për promovimin e konkurrencës efektive dhe për sigurimin e funksionimit të mirëfilltë të tregut. Aty ku është e përshtatshme, autoriteti rregullator gjithashtu duhet të ketë kompetencën për të bashkëpunuar me autoritetin shtetëror të konkurrencës dhe rregullatorët e tregut financiar, ose Komisionin, në kryerjen e hetimeve në lidhje me ligjin e konkurrencës;
  - c. Të kërkojë informata nga sipërmarrjet e gazit natyror që janë të rëndësishme për përmbushjen e detyrave të tij, duke përfshirë arsyetimin për refuzimin e dhënies së qasjes së palës së tretë, si dhe informata mbi masat e domosdoshme për përforcimin e rrjetit;
  - d. Të vendosë sanksione efektive, proporcionale dhe zbindëse mbi sipërmarrjet e gazit natyror që nuk respektojnë obligimet e veta sipas kësaj Direktive, apo vendimet tjera relevante ligjërish obligative të autoritetit rregullator apo të Agjencisë, apo të propozojnë tek gjykata kompetente që të vendosë sanksione të tilla. Kjo do të përfshijë kompetencën për vendosjen apo propozimin e sanksioneve deri në 10% të qarkullimit vjetor të operatorit të sistemit të bartjes ose deri në 10 % të qarkullimit vjetor të sipërmarrjes së integruar vertikalisht tek operatori i sistemit të bartjes ose tek sipërmarrja e integruar vertikalisht, sido që të jetë, për mosrespektimin e obligimeve të tyre përkatëse sipas kësaj Direktive; si dhe
  - e. Të drejtat e duhura për hetime dhe kompetencat relevante të udhëzimeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas paragrafëve 11 dhe 12.
5. Përveç detyrave dhe kompetencave të deleguara tek ai sipas paragrafëve 1 dhe 4 të këtij neni, kur operatori i sistemit të bartjes caktohet në pajtim me Kapitullin IV, autoriteti rregullator duhet të ketë së paku këto detyra dhe kompetenca:
- a. Të vendosë sanksione në pajtim me paragrafin 4(d) për sjellje diskriminuese në të mirë të sipërmarrjes së integruar vertikalisht;

- b. Të monitorojë komunikimet mes operatorit të sistemit të bartjes dhe sipërmarrjes së integruar vertikalisht ashtu që të sigurohet respektimi i obligimeve nga operatori i sistemit të bartjes;
  - c. Të veprojë si autoritet i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes sipërmarrjes së integruar vertikalisht dhe operatorit të sistemit të bartjes në lidhje me ankesat që parashtrihen në bazë të paragrafit 11;
  - d. Të monitorojë marrëdhëniet komerciale dhe financiare, duke përfshirë huatë, mes sipërmarrjes së integruar vertikalisht dhe operatorit të sistemit të bartjes;
  - e. Të miratojë gjitha marrëveshjet komerciale dhe financiare mes sipërmarrjes së integruar vertikalisht dhe operatorit të sistemit të bartjes, me kusht që ato të përputhen me kushtet e tregut;
  - f. Të kërkojë arsytetime nga sipërmarrja e integruar vertikalisht kur njoftohet nga zyrtari i përputhshmërisë në pajtim me nenin 21(4). Arsyetimi i tillë në veçanti duhet të përfshijë dëshmi ashtu që të vërtetojë që nuk ka pasur sjellje diskriminuese në të mirë të sipërmarrjes së integruar vertikalisht;
  - g. Të kryejë inspektime, duke përfshirë inspektimet e paparalajmëruara, në lokalet e sipërmarrjes së integruar vertikalisht dhe operatorit të sistemit të bartjes; si dhe
  - h. T'ia delegojë gjitha apo detyrat specifike të operatorit të sistemit të bartjes tek një operator i pavarur i sistemit i emëruar në pajtim me nenin 14 në rast të shkeljeve të vazhdueshme nga operatori i sistemit të bartjes të obligimeve të veta sipas kësaj Direktive, sidomos në rastin e sjelljeve të përsëritura diskriminuese në të mirë të sipërmarrjes së integruar vertikalisht.
6. Autoritetet rregullatore duhet të jenë përgjegjëse për caktimin apo miratimin, mjaft përpara hyrjes në fuqi, të së paku metodologjive të përdorura për kalkulimin, apo vendosjen e kushteve dhe afateve për:
- a. Kyçjen dhe qasjen në rrjetet shtetërore, duke përfshirë tarifën e bartjes dhe shpërndarjes, si dhe kushtet, afatet dhe tarifën për qasjen në stabilimentet e GLN-së. Ato tarifa apo metodologji do të mundësojnë investimet e domosdoshme në rrjete dhe stabilimente GLN-së që të kryhen në mënyrë që i lejon atyre investimeve të sigurojnë qëndrueshmërinë e rrjeteve dhe stabilimenteve të GLN-së;
  - b. Ofrimi i shërbimeve të balancimit që duhet kryer në mënyrën më ekonomike dhe ofrimi i stimujve ashtu që shfrytëzuesit e rrjetit të baraspeshojnë hyrjet dhe daljet e tyre. Shërbimet e balancimit duhen ofruar në mënyrë të drejtë dhe jo-diskriminuese si dhe të bazohen në kritere objektive; si dhe
  - c. Qasja në infrastruktura ndërkufitare, duke përfshirë procedurat për ndarjen e kapacitetit dhe menaxhimin e dyndjeve.
7. Metodologjitë apo kushtet dhe afatet e përmendura në paragrafin 6 duhen publikuar.
8. Në caktimin apo miratimin e tarifave apo metodologjive dhe shërbimeve të balancimit, autoritetet rregullatore duhet të sigurojnë që operatorët e sistemit të bartjes dhe shpërndarjes të përfitojnë stimuj të përshtatshëm, në afat të shkurtër dhe të gjatë, për të rritur efikasitetin, për të nxitur integrimin e tregut, si dhe sigurinë e furnizimit dhe për të mbështetur aktivitetet përcjellëse hulumtuese.
9. Autoritetet rregullatore duhet të monitorojnë menaxhimin e dyndjeve nga rrjetet shtetërore të bartjes së gazit, duke përfshirë interkonektorët, si dhe implementimin e

rregullave të menaxhimit të dyndjes. Në atë drejtim, operatorët e sistemit të bartjes apo operatorët e tregut duhet të paraqesin rregullat e tyre për menaxhimin e dyndjes, duke përfshirë edhe ndarjen e kapacitetit, tek autoritetet rregullatore shtetërore. Autoritetet rregullatore shtetërore mund të kërkojnë ndryshime në ato rregulla.

10. Autoritetet rregullatore duhet të kenë autoritetin që t'i kërkojnë operatorëve të sistemit të bartjes, depozitimit, GLN-së dhe shpërndarjes, nëse është e domosdoshme, që të modifikojnë kushtet dhe afatet, duke përfshirë tarifat dhe metodologjitë e përmendura në këtë nen, për të siguruar që ato të jenë proporcionale dhe të zbatuara në mënyrë jo-diskriminuese. Në rast se regjimi i qasjes në depozitim definohet sipas nenit 33(3), ajo detyrë nuk përfshin modifikimin e tarifave. Në rast të vonesave në caktimin e tarifave të bartjes dhe shpërndarjes, autoritetet rregullatore duhet të kenë kompetencën që të caktojnë apo miratojnë tarifa kalimtare të bartjes dhe shpërndarjes, si dhe të vendosin mbi masat e duhura kompensuese nëse tarifat apo metodologjitë përfundimtare dallojnë nga tarifat apo metodologjitë kalimtare.
11. Secila palë që ka një ankesë ndaj një operatori të sistemit të bartjes, depozitimit, GLN-së apo shpërndarjes në lidhje me obligimet e atij operatori sipas kësaj Direktive mund ta parashtojë ankesën e vet tek autoriteti rregullator i cili, duke vepruar si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, nxjerr vendim brenda një periudhe prej dy muajsh. Ajo periudhë mund të zgjatet me dy muaj tjerë, në rastet kur kërkohen informata shtesë nga autoritetet rregullatore. Vendimi i autoritetit rregullator ka efekt obligativ, përveç nëse rrezohet në bazë të ankesës.
12. Secila palë që është e prekur dhe që ka të drejtë të ankohet në lidhje me një vendim mbi metodologjitë e vendosura në bazë të këtij neni, apo në rastet kur autoriteti rregullator ka për detyrë të konsultojë, në lidhje me tarifat apo metodologjitë e propozuara, mundet, më së voni brenda dy muajsh, apo edhe më shkurt nëse parashkohet ashtu nga Shtetet Anëtare, pas publikimit të vendimit apo propozimit për vendim, të parashtojë ankesën për shqyrtim. Ajo ankesë nuk ka efekt pezullues.
13. Shtetet Anëtare duhet të krijojnë mekanizmat e përshtatshëm dhe efikasë për rregullimin, kontrollin dhe transparencën, për të shmangur keqpërdorimet e pozitës dominuese, sidomos në dëm të konsumatorëve, si dhe të ndonjë sjelljeje grabitqare. Ata mekanizma duhet të marrin parasysh dispozitat e Traktatit, sidomos nenit 82 të tij.
14. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të merren masat e përshtatshme, duke përfshirë veprimet administrative apo procedimet penale në përputhje me legjislacionin vendor, kundër personave fizikë apo juridikë përgjegjës, aty ku nuk respektohen rregullat e konfidencialitetit të përcaktuara me këtë Direktivë.
15. Ankesat e përmendura në paragrafët 11 dhe 12 do të jenë pa paragykim ndaj ushtrimit të të drejtave të ankesës sipas ligjit të Komunitetit apo atij shtetëror.
16. Vendimet që merren nga autoritetet rregullatore duhet të jenë plotësisht të arsyetuara dhe të shkruara ashtu që të mundësojnë shqyrtimin gjyqësor. Vendimet duhet të vihen në dispozicion të publikut, derisa ruhet fshehtësia e informatave me ndjeshmëri komerciale.
17. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë ekzistencën e mekanizmave të përshtatshëm në nivel shtetëror, me të cilat pala e prekur nga një vendim i autoritetit rregullator ka të drejtë të apelojë tek një organ i pavarur nga palët e përfshira dhe nga qeveria.

## *Neni 42*

### **Regjimi rregullator për çështjet ndërkufitare**

1. Autoritetet rregullatore duhet të konsultohen afërsisht dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, si dhe do t'i ofrojnë njëri-tjetrit dhe Agjencisë informatat e domosdoshme për kryerjen e detyrave të tyre sipas kësaj Direktive. Në lidhje me informatat e këmbyera, autoriteti pranues do të sigurojë të njëjtin nivel të konfidencialitetit që i kërkohet autoritetit dërgues.
2. Autoritetet rregullatore duhet të bashkëpunojnë së paku në nivel rajonal për të:
  - a. Nxitur krijimin e aranzhimeve operationale për të mundësuar menaxhim optimal të rrjetit, për të promovuar këmbimet e gazit dhe ndarjen e kapacitetit ndërkufitar, si dhe për të mundësuar nivel adekuat të kapacitetit interkonektues, duke përfshirë atë përmes interkoneksioneve të reja, brenda rajonit dhe mes rajoneve, për të mundësuar zhvillimin e konkurrencës efektive dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit pa diskriminuar mes sipërmarrjeve furnizuese në Shtete të ndryshme Anëtare;
  - b. Bashkërenduar zhvillimin e gjitha kodeve të rrjetit për operatorët përkatës të sistemit të bartjes dhe aktorëve tjerë në treg; si dhe
  - c. Bashkërenduar hartimin e rregullave për menaxhimin e dyndjeve.
3. Autoritetet rregullatore shtetërore duhet të kenë të drejtë të hyjnë në marrëveshje bashkëpunimi me njëri-tjetrin për të nxitur bashkëpunimin rregullator.
4. Veprimet e përmendura në paragrafin 2 duhet të kryhen, sido të jetë e përshtatshme, në konsultim të afërt me autoritetet tjera përkatëse shtetërore dhe pa paragjykuar kompetencat e tyre specifike.
5. Komisioni mund të miratojë Udhëzime në lidhje me detyrat e autoriteteve rregullatore në bashkëpunimin mes tyre dhe me Agjencinë. Ato masa, të hartuara për ndryshimin e elementeve jo-thelbësore të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, duhen miratuar në pajtim me procedurën rregullative bashkë me mbikëqyrjen e afërt, të përmendur në nenin 51(3).

## *Neni 43*

### **Respektimi i Udhëzimeve**

1. Secili autoritet rregullator dhe Komisioni mund të kërkojnë mendimin e Agjencisë mbi respektimin e një vendimi që është marrë nga një autoritet rregullator të Udhëzimeve të përmendura në këtë Direktivë apo me Rregulloren (EC) Nr. 715/2009.
2. Agjencia do të ofrojë mendimin e vet për autoritetin rregullator që e ka kërkuar atë apo për Komisionin, si dhe për autoritetin rregullator që ka marrë vendimin në fjalë brenda tre muajsh nga pranimi i kërkesës.



3. Në rastet kur autoriteti rregullator që ka marrë vendimin nuk respekton mendimin e Agjencisë brenda katër muajsh nga data e pranimit të atij mendimi, Agjencia do ta informojë Komisionin për të.
4. Secili autoritet rregullator mund të informojë Komisionin në rastet kur konsideron që vendimi relevant për tregtinë ndërkufitare i marrë nga ndonjë autoritet tjetër rregullator nuk respekton Udhëzimet e përmendura në këtë Direktivë apo në Rregulloren (EC) Nr. 715/2009 brenda dy muajsh nga data e atij vendimi.
5. Në rastet kur Komisioni, brenda dy muajsh nga informimi nga Agjencia në pajtim me paragrafin 3, apo nga autoriteti rregullator në pajtim me paragrafin 4, ose me vetë-iniciativë, brenda tre muajsh nga data e vendimit, gjen që vendimi i autoritetit rregullator ngre dyshime serioze në lidhje me përputhshmërinë e tij me Udhëzimet e përmendura në këtë Direktivë apo në Rregulloren (EC) Nr. 715/2009, Komisioni mund të vendosë që të hulumtojë rastin më tutje. Në atë rast, ai fton autoritetin rregullator dhe palët tek proceduara para autoritetit rregullator për të dorëzuar gjetjet e veta.
6. Në rastet kur Komisioni merr vendim për ta hulumtuar rastin më tutje, ai duhet që brenda katër muajsh nga data e atij vendimi, të nxjerrë vendimin përfundimtar:
  - a. Që të mos ngre kundërshtime ndaj vendimit të autoritetit rregullator; ose
  - b. T'i kërkojë autoritetit rregullator në fjalë që të tërheqë vendimin e tij në bazën e asaj që Udhëzimet nuk janë respektuar.
7. Në rastet kur Komisioni nuk ka marrë vendim që të hulumtojë rastin më tutje, ose vendimin përfundimtar brenda afateve të përcaktuara me paragrafin 5, respektivisht 6, do të konsiderohet që ai nuk ka ngritur kundërshtime ndaj vendimit të autoritetit rregullator.
8. Autoriteti rregullator duhet të respektojë vendimin e Komisionit për të tërhequr vendimin e tij brenda një periudhe prej dy muajsh, si dhe ta informojë Komisionin për këtë.
9. Komisioni mund të miratojë Udhëzime që përcaktojnë detajet e procedurës që duhet ndjekur nga autoritetet rregullatore, Agjencia dhe Komisioni në lidhje me respektimin e vendimeve të marra nga autoritetet rregullatore të Udhëzimeve të përmendura në këtë nen. Ato masa, të hartuara për ndryshimin e elementeve jo-thelbësore të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, duhen miratuar në pajtim me procedurën rregullative bashkë me mbikëqyrjen e afërt, të përmendur në nenin 51(3).

*Neni 44*

### **Mbajtja e shënimeve**

1. Shtetet Anëtare duhet t'i kërkojnë sipërmarrjeve të furnizimit që të mbajnë në dispozicion të autoriteteve shtetërore, duke përfshirë autoritetin rregullator, autoritetet shtetërore të konkurrencës dhe Komisionin, për përmbushjen e detyrave të veta, për së paku pesë vjet, të dhënat relevante në lidhje me gjitha transaksionet në kontrata të furnizimit me gaz si dhe derivate të gazit me konsumatorë të shumicës dhe operatorë të sistemit të bartjes, si dhe operatorë të depozitimit dhe GLN-së.

2. Të dhënat duhet të përfshijnë hollësitë mbi karakteristikat e transaksioneve përkatëse, si kohëzgjatja, liferimi dhe rregullat e vendosjes, sasinë, datat dhe kohën e ekzekutimit, si dhe çmimet e transaksionit dhe mënyrat e identifikimit të konsumatorit me shumicë, bashkë me detajet e specifikuar të gjitha kontratave të pashërbyera të furnizimit të gazit dhe derivateve të tij.
3. Autoriteti rregullator mund të vendosë të vërë në dispozicion për gjithë aktorët e tregut elementet e këtyre informatave, me kusht që informatat me ndjeshmëri komerciale mbi aktorët individualë të tregut të mos zbulohen. Ky paragraf nuk vlen për informatat për instrumentet financiare, të cilat janë fushëveprim i Direktivës 2004/39/EC.
4. Për të siguruar zbatimin uniform të këtij neni, Komisioni mund të miratojë Udhëzime të cilat përkufizojnë metodat dhe rregullimet për mbajtjen e shënimeve, si dhe formën e përmbajtjen e të dhënave që duhen mbajtur. Ato masa, të hartuara për ndryshimin e elementeve jo-thelbësore të kësaj Direktive duke e plotësuar atë, duhen miratuar në pajtim me procedurën rregullative bashkë me mbikëqyrjen e afërt, të përmendur në nenin 51(3).
5. Në lidhje me transaksionet me derivate të gazit nga sipërmarrjet e furnizimit me konsumatorë të shumicës dhe operatorë të sistemit të bartjes, si dhe operatorë të depozitimit dhe GLN-së, ky nen zbatohet vetëm pasi Komisioni të ketë miratuar Udhëzimet e përmendura në paragrafin 4.
6. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të krijojnë obligime shtesë mbi autoritetet e përmendura në paragrafin 1, për subjektet që janë në fushëveprimin e Direktivës 2004/39/EC.

## **KAPITULLI IX**

### **TREGJET ME PAKICË**

#### *Neni 45*

#### **Tregjet me pakicë**

Për të lehtësuar zhvillimin e tregjeve funksionale dhe transparente të pakicës në Komunitet, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që rolet dhe përgjegjësitë e operatorëve të sistemit të bartjes, operatorëve të sistemit të shpërndarjes, sipërmarrjeve të furnizimit dhe konsumatorëve, si dhe sipas nevojës edhe palëve të tjera në treg të përkufizohen në lidhje me aranzhimet kontraktuale, përkushtimin ndaj konsumatorëve, këmbimin e të dhënave dhe rregullat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, pronësinë e të dhënave dhe përgjegjësitë e njehsimit.

Ato rregulla duhen bërë publike, duhen hartuar me qëllim të lehtësimit të qasjes së konsumatorëve dhe furnizuesve në rrjet dhe i duhen nënshtruar shqyrtimit nga autoritetet rregullatore apo autoriteteve tjera relevante shtetërore.

## **KAPITULLI X**

## **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### *Neni 46*

#### **Masat mbrojtëse**

1. Në rast të ndonjë krize të papritur në tregun e energjisë, apo ku kërcënohet siguria fizike apo siguria e personave, aparaturës apo instalimeve apo edhe integriteti i sistemit, Shteti Anëtar mundet që përkohësisht të marrë masat e domosdoshme mbrojtëse.
2. Masat e tilla duhet që të shkaktojnë pengesat më të vogla të mundshme ndaj funksionimit të tregut të brendshëm, si dhe nuk mund të jenë më të gjera në fushëveprim sesa që është ngushtësisht e domosdoshme për të sanuar vështirësitë e papritura që kanë lindur.
3. Shteti Anëtar në fjalë duhet që pa vonesë t'i njoftojë ato masa Shteteve tjera Anëtare, si dhe Komisionit, i cili mund të vendosë që Shteti Anëtar në fjalë duhet të ndryshojë apo shfuqizojë ato masa, deri në masën që ato çrregullojnë konkurrencën dhe negativisht ndikojnë në tregti në një mënyrë që është në mospërputhje me interesin e përbashkët.

### *Neni 47*

#### **Mjedisi i barabartë**

1. Masat që Shtetet Anëtare mund të ndërmarrin në bazë të kësaj Direktive për të siguruar një mjedis të barabartë duhet të jenë në përputhje me Traktatin, sidomos nenin 30 të tij, si dhe me legjislacionin e Komunitetit.
2. Masat e përmendura në paragrafin 1 duhet të jenë proporcionale, jo-diskriminuese dhe transparente. Ato masa mund të hyjnë në fuqi vetëm pas njoftimit dhe miratimit të tyre nga Komisioni.
3. Komisioni duhet të veprojë në bazë të njoftimit të përmendur në paragrafin 2 brenda dy muajsh nga pranimi i njoftimit. Ajo periudhë duhet të fillojë që nga dita e pranimit të informatave të plota. Në rastet kur Komisioni nuk vepron brenda asaj periudhe dy-mujore, do të konsiderohet që ai nuk ka pasur kundërshtime ndaj masave të njoftuara.

### *Neni 48*

#### **Shmangiet në lidhje me zotimet e klauzolës merr-ose-paguaj**

1. Nëse një sipërmarrje e gazit natyror përballet, ose konsideron që do të përballet me vështirësi të mëdha ekonomike e financiare për shkak të zotimeve të saj merr-ose-paguaj të pranuar në një apo më shumë kontrata të blerjes së gazit, ajo mund të parashtrijë një aplikim për shmangie të përkohshme nga neni 32 tek Shteti Anëtar në fjalë, ose tek autoriteti kompetent i caktuar për këtë. Aplikacionet duhet që në pajtim me zgjedhjen e Shteteve Anëtare të parashtrihen në baza të rasteve të veçanta, ose para ose pas refuzimit të qasjes në sistem. Shtetet Anëtare munden gjithashtu t'i japin sipërmarrjes së gazit natyror zgjedhjen që të paraqesë një aplikacion ose para ose pas refuzimit të qasjes në sistem. Aty ku sipërmarrja e gazit natyror ka refuzuar qasjen, aplikacioni duhet të dorëzohet pa vonesë. Aplikacionet duhen përcjellë me gjitha informatat përkatëse mbi natyrën dhe nivelin e problemit si dhe mbi përpjekjet e ndërmarra nga sipërmarrja e gazit natyror për të zgjidhur problemin.

Nëse zgjidhjet alternative nuk janë të arsyeshme, si dhe duke marrë parasysh paragrafin 3, Shteti Anëtar ose autoriteti i caktuar kompetent mund të vendosë të lejojë shmangien.

2. Shteti Anëtar, ose autoriteti kompetent i caktuar, duhet ta njoftojë Komisionin pa vonesë për vendimin e tij për lejimin e shmangies, bashkë me gjitha informatat përkatëse në lidhje me shmangien. Ato informatat mund t'i parashtrihen Komisionit në formë agregate, duke i mundësuar Komisionit që të arrijë një vendim meritore. Brenda tetë javësh nga pranimi i atij njoftimi, Komisioni mund të kërkojë që Shteti Anëtar apo autoriteti i caktuar kompetent në fjalë të ndryshojë apo tërheqë vendimin për lejimin e shmangies.

Nëse Shteti Anëtar ose autoriteti i caktuar kompetent nuk respektojnë atë kërkesë brenda periudhës prej katër javësh, vendimi përfundimtar duhet të merret në mënyrë ekspeditive në pajtim me procedurën këshillimore të përmendur në nenin 51(2).

Komisioni duhet të ruajë fshehtësinë e informatave të ndjeshme komerciale.

3. Kur vendoset mbi shmangiet e përmendura në paragrafin 1, Shteti Anëtar, apo autoriteti i caktuar kompetent, si dhe Komisioni, duhet të marrin parasysh, në veçanti, kriteret në vijim:

- a. Synimin e arritjes së tregut konkurrent të gazit;
- b. Nevojën e përmbushjes së obligimeve të shërbimit publik dhe për të ofruar sigurinë e furnizimit;
- c. Pozitën e sipërmarrjes së gazit natyror në tregun e gazit dhe gjendjen aktuale të konkurrencës në atë treg;
- d. Seriozitetin e vështirësive ekonomike dhe financiare me të cilat përballen sipërmarrjet e gazit natyror dhe sipërmarrjet e bartjes apo konsumatorët e privilegjuar;
- e. Datat e nënshkrimit dhe kushtet e kontratës apo kontratave në fjalë, duke përfshirë masën në të cilën lejojnë ndryshimet e tregut;
- f. Përpjekjet e bëra për të gjetur zgjidhjen e problemit;
- g. Masën në të cilën, kur pranohen zotimet merr-ose-paguaj në fjalë, sipërmarrja do të mund të kishte parashikuar në masë të arsyeshme, duke marrë parasysh dispozitat e kësaj Direktive, që vështirësitë serioze ishin të mundura;
- h. Nivelin e ndërlidhjes së sistemit me sistemet tjera dhe shkallën e ndërveprueshmërisë së atyre sistemeve; si dhe
- i. Efektet që lejimi i shmangies do të kishte mbi zbatimin korrekt të Direktivës, në kuptimin e funksionimit të duhur të tregut të brendshëm të gazit natyror.

Vendimi për kërkesën për shmangie në lidhje me kontratat merr-ose-paguaj të nënshkruara para 4 gushtit 2003 nuk duhet të çojnë tek situata në të cilën do të ishte e pamundur të gjenden zgjidhje alternative ekonomikisht të arritshme. Vështirësitë serioze në çdo rast do të konsiderohen si të mos ekzistonin kur shitjet e gazit natyror nuk bien nën nivelin e garancive minimale të blerjes që gjenden në kontratat e blerjes së gazit merr-ose-paguaj, ose deri në masën që kontrata përkatëse e blerjes së gazit merr-ose-paguaj mund të përshtatet, ose që sipërmarrja e gazit natyror është në gjendje të gjejë zgjidhje alternative.

4. Sipërmarrjet e gazit natyror të cilave nuk i është lejuar shmangia e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk do të refuzojnë, apo nuk do të refuzojnë më, qasjen në sistem për shkak të zotimeve merr-ose-paguaj të pranuar në kontratat e blerjes së gazit. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që dispozitat përkatëse të neneve 32 deri 44 të respektohen.
5. Secila shmangie e lejuar sipas dispozitave të lartshënuara duhet të jetë mirë e arsyetuar. Komisioni do të publikojë vendimin në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.
6. Komisioni, para 4 gushtit 2008, duhet të parashtrijë një raport shqyrtues mbi përvojën e fituar nga zbatimi i këtij neni, ashtu që t'i mundësohet Parlamentit dhe Këshillit Evropian që ta konsiderojnë, në kohën e duhur, nevojën për ndryshimin e tij.

#### *Neni 49*

#### **Tregjet në lindje dhe të izoluara**

1. Shtetet Anëtare që nuk janë drejtpërdrejt të lidhur në sistemin e interkonektuar të një Shteti Anëtar tjetër dhe që kanë vetëm një furnizues kryesor të jashtëm mund të shmangen nga nenet 4, 9, 37 dhe/ose 38. Sipërmarrja e furnizimit që ka hise të tregut prej më shumë se 75 % do të konsiderohet të jetë furnizues kryesor. Secila shmangie e tillë skadon automatikisht kur së paku një nga kushtet e përmendura në këtë nën-paragraf nuk vlen më. Secila shmangie e tillë i duhet njoftuar Komisionit.  
Qiproja mund të shmanget nga nenet 4, 9, 37 dhe/ose 38. Shmangia e tillë skadon nga momenti kur Qiproja nuk kualifikohet më si treg i izoluar.  
Nenet 4, 9, 37 dhe/ose 38 nuk vlejnë për Estoninë, Latvinë dhe/ose Finlandën, si dhe derisa cilido nga këto Shtete Anëtare të jetë i lidhur drejtpërdrejt me sistemin e interkonektuar të cilitdo Shteti Anëtar, ndryshe nga Estonia, Latvia, Lituania dhe Finlanda. Ky nënparagraf nuk paragjykon shmangiet sipas nën-paragrafit të parë të këtij paragrafi.
2. Një Shtet Anëtar që kualifikohet si treg në lindje, i cili, për shkak të zbatimit të kësaj Direktive do të përballej me probleme qenësore, mund të shmanget nga nenet 4 dhe 9, neni 13(1) dhe (3), nenet 14 dhe 24, neni 25(5), nenet 26, 31 dhe 32, neni 37(1) dhe/ose neni 38. Shmangiet e tilla skadojnë automatikisht nga momenti kur Shteti Anëtar nuk kualifikohet më si treg në lindje. Secila shmangie e tillë i duhet njoftuar Komisionit.  
Qiproja mund të shmanget nga nenet 4 dhe 9, neni 13(1) dhe (3), nenet 14 dhe 24, neni 25(5), nenet 26, 31 dhe 32, neni 37(1) si dhe/ose neni 38. Shmangia e tillë skadon nga momenti kur Qiproja nuk kualifikohet më si treg në lindje.
3. Në datën në të cilën shmangia e përmendur në nën-paragrafin e parë të paragrafit 2 skadon, definicioni i konsumatorëve të privilegjuar do të rezultojë në hapjen e tregut ekuivalente me 33% të konsumit total vjetor të gazit të tregut shtetëror të gazit. Dy vjet pas kësaj, neni 37(1)(b) fillon të zbatohet, derisa tre vjet më vonë, neni 37(1)(c) fillon të vlejë. Derisa neni 37(1)(b) vlen, Shteti Anëtar i përmendur në paragrafin 2 të këtij Neni mund të vendosë të mos zbatojë nenin 32 në kuptimin e shërbimeve ndihmëse dhe depozitimit të përkohshëm për procesin e ri-gazifikimit dhe liferimit të tij të mëpastajshëm tek sistemi i bartjes.
4. Kur implementimi i kësaj Direktive do të shkaktonte probleme thelbësore në një zonë gjeografikisht të kufizuar të një Shteti Anëtar, sidomos në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës së bartjes dhe asaj madhore të shpërndarjes, si dhe me qëllimin e

inkurajimit të investimeve, Shteti Anëtar mund të kërkojë nga Komisioni një shmangie të përkohshme nga nenet 4 dhe 9, neni 13(1) dhe (3), nenet 14 dhe 24, neni 25(5), nenet 26, 31 dhe 32, neni 37(1) dhe/ose neni 38 për zhvillimet brenda asaj zone.

5. Komisioni mund të lejojë shmangien e përmendur në paragrafin 4, duke marrë parasysh sidomos kriteret në vijim:

- Nevoja për investime në infrastrukturë, të cilat nuk do të ishin ekonomike për t'u operuar në një mjedis të një tregu konkurrent,
- Niveli dhe perspektiva kthimit të investimeve të nevojshme,
- Madhësia dhe matura e sistemit të gazit në zonën në fjalë,
- Perspektivat e tregut të gazit në fjalë,
- Madhësia gjeografike dhe karakteristikat e zonës apo rajonit në fjalë, si dhe faktorët socio-ekonomikë dhe demografikë,

Për infrastrukturë gazi që nuk është infrastrukturë shpërndarjeje, shmangia mund të lejohet vetëm nëse nuk është ndërtuar infrastrukturë gazi në zonë për më pak se 10 vjet. Shmangia e përkohshme nuk duhet të tejkalojë 10 vjet nga koha kur gazi është furnizuar së pari në zonë.

Për infrastrukturën e shpërndarjes, shmangia mund të lejohet për një periudhë që nuk tejkalon 20 vjet prej kohës kur gazi është furnizuar së pari përmes infrastrukturës së përmendur në zonë.

6. Neni 9 nuk vlen për Qipron, Luksemburgun dhe/ose Maltën.

7. Komisioni duhet t'i informojë Shtetet Anëtare për aplikimet e bëra sipas paragrafit 4 para se të marrë vendim në bazë të paragrafit 5, duke marrë parasysh respektimin e konfidencialitetit. Ai vendim, bashkë me shmangiet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2, duhet publikuar në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

8. Greqia mund të shmanget nga nenet 4, 24, 25, 26, 32, 37 dhe/ose 38 të kësaj Direktive për zonat gjeografike dhe periudhat kohore të specifikuara në licencat e lëshuara nga ajo, para 15 marsit 2002 dhe në pajtim me Direktivën 98/30/EC, për zhvillimin dhe shfrytëzimin ekskluziv të rrjeteve shpërndarëse në disa zona gjeografike.

## *Neni 50*

### **Procedura e shqyrtimit**

Në rastin që në raportin e përmendur në nenin 52(6), Komisioni arrin tek përfundimi që, duke marrë parasysh mënyrën efektive në të cilën qasja në rrjet është mundësuar në një Shtet Anëtar – gjë që mundëson qasjen plotësisht efektive, jo-diskriminuese dhe të papenguar në rrjet – disa obligime të vendosura nga kjo Direktivë mbi sipërmarrjet (duke përfshirë ato në lidhje me shturjen juridike për operatorët e sistemit të shpërndarjes) nuk janë proporcionale me synimin e dëshiruar, Shteti Anëtar mund të parashtojë një kërkesë tek Komisioni për shmangie nga kërkesa në fjalë.

Kërkesa e tillë duhet njoftuar, pa vonesë, nga Shteti Anëtar tek Komisioni, bashkë me gjitha informatat përkatëse të domosdoshme për të demonstruar që konkludimi i arritur në raport mbi qasjen efektive në rrjet që ofrohet do të ruhet.

Brenda tre muajsh nga pranimi i njoftimit, Komisioni do të miratojë një mendim në lidhje me kërkesën nga Shteti Anëtar në fjalë, si dhe kudo që është e përshtatshme, t'i dorëzojë propozimet tek Parlamenti Evropian dhe Këshilli për ndryshimin e dispozitave përkatëse të

kësaj Direktive. Komisioni mund të propozojë, në propozimet për ndryshim të kësaj Direktive, për të liruar Shtetin Anëtar në fjalë nga kërkesat specifike nga kërkesat specifike që i nënshtrohen atij Shteti Anëtar që implementon masat po aq efektive sipas nevojës.

#### *Neni 51*

##### **Komiteti**

1. Komisioni do të ndihmohet nga një komitet.
2. Aty ku referohet ky paragraf, do të vlejnjë nenet 3 dhe 7 të vendimit 1999/468/EC, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.
3. Aty ku referohet ky paragraf, do të vlejnjë neni 5a(1) deri në (4), si dhe neni 7 i Vendimit 1999/468/EC, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

#### *Neni 52*

##### **Raportimi**

1. Komisioni do të miratojë dhe shqyrtojnjë zbatimin e kësaj Direktive dhe të paraqesë një raport të përparimit të përgjithshëm tek Parlamenti dhe Këshilli Evropian për herë të parë deri më 31 dhjetor 2004, si dhe në baza vjetore pas kësaj. Raporti i progresit duhet të mbulojë së paku:
  - a. Përvoja e fituar dhe përparimi i bërë në krijimin e një tregu të plotë dhe plotësisht funksional të brendshëm të gazit natyror si dhe pengesat që mbesin në këtë drejtim, duke përfshirë aspektet e dominimit të tregut, koncentrimin në treg, sjelljet grabitqare apo anti-konkurrençe;
  - b. Shmangiet e lejuara sipas kësaj Direktive, duke përfshirë implementimin e shmangies së përcaktuar me nenin 26(4) me qëllim të shqyrtimit të mundshëm të atij pragu;
  - c. Masën në të cilën kërkesat për shthurje dhe tarifim të përcaktuara me këtë Direktivë kanë qenë të suksesshme në sigurimin e qasjes së drejtë dhe jo-diskriminuese në sistemin e gazit të Komunitetit dhe niveleve ekuivalente të konkurrencës, si dhe pasojave ekonomike, mjedisore dhe sociale të hapjes së tregut të gazit për konsumatorë;
  - d. Një hulumtim të çështjeve të ndërlidhura me nivelet e kapacitetit të sistemit dhe sigurisë së furnizimit të gazit natyror në Komunitet, e sidomos edhe balancën ekzistues dhe të projektuar mes ofertës dhe kërkesës, duke marrë parasysh kapacitetin fizik për këmbimet mes zonave dhe zhvillimin e depozitimeve (duke përfshirë edhe çështjen e proporcionalitetit të rregullimit të tregut në atë fushë);
  - e. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar masave të marra në Shtetet Anëtare për të mbuluar kërkesën e pikut dhe për t'u përballur me mungesat e një apo më shumë furnizuesve;
  - f. Një vlerësim i përgjithshëm i progresit të arritur në lidhje me marrëdhëniet bilaterale me vendet e treta të cilat prodhojnë dhe eksportojnjë apo transportojnjë gaz natyror, duke përfshirë progresin në integrimin e tregut, tregti dhe qasje në rrjetet e atyre vendeve të treta;
  - g. Nevoja për kërkesa të mundshme të harmonizimit të cilat nuk janë të lidhura me dispozitat e kësaj Direktive.

Aty ku është e përshtatshme, raporti i progresit mund të përfshijë rekomandime dhe masa për t'u përballur me efektet negative të dominimit të tregut dhe koncentrimin në treg.

Në raport, Komisioni, në konsultim me ENTSO për Gaz, mundet gjithashtu të shqyrtojë arritshmërinë e krijimit, nga operatorët e sistemit të bartjes, të një operatori unik Evropian të sistemit të bartjes.

2. Çdo dy vjet, raporti i progresit i përmendur në paragrafin 1 gjithashtu duhet të përfshijë edhe analizën e masave të ndryshme të ndërmarra në Shtetet Anëtare për përmbushjen e obligimeve të shërbimit publik, bashkë me një hulumtim të efektshmërisë së atyre masave, si dhe në veçanti, efektet e tyre mbi konkurrencën në tregun e gazit. Aty ku është e përshtatshme, raporti mund të përfshijë rekomandime në lidhje me masat që duhen marrë në nivel shtetëror për të arritur standarde të larta të shërbimit publik apo masat e synuara për parandalimin e përmbarimit të tregut.
3. Komisioni, deri më 3 mars 2013, duhet të dorëzojë, si pjesë e shqyrtimit të përgjithshëm, tek Parlamenti dhe Këshilli Evropian, një raport të detajuar specifik që pasqyron masën në të cilën kërkesat për shthurje sipas Kapitullit IV kanë qenë të suksesshme në të siguruarit e pavarësisë së plotë dhe efektive të operatorëve të sistemit të bartjes, duke pasur shthurjen efektive dhe efikase si prag vlerësimi.
4. Për qëllimet e vlerësimit sipas paragrafit 3, Komisioni duhet të marrë parasysh, në veçanti, kriteret vijuese: qasja e drejtë dhe jo-diskriminuese në rrjet, rregullimi efektiv, zhvillimi i rrjetit për të shërbyer nevojat e tregut, stimujt e rregullt për investime, zhvillimi i infrastrukturës interkonektuese, konkurrenca efektive në tregjet e energjisë së Komunitetit dhe gjendja e sigurisë së furnizimit në Komunitet.
5. Aty ku është e përshtatshme, si dhe veçanërisht në rastin kur raporti i hollësishëm specifik i përmendur në paragrafin 3 përcakton që kushtet e përmendura në paragrafin 4 nuk janë garantuar në praktikë, Komisioni do të dorëzojë propozimet tek Parlamenti dhe Këshilli Evropian për të siguruar pavarësi plotësisht efektive të operatorëve të sistemit të bartjes deri më 3 mars 2014.
6. Komisioni, jo më vonë se 1 janari 2006, duhet t'i parashtrojë Parlamentit dhe Këshillit Evropian një raport të hollësishëm duke pasqyruar përparimin në krijimin e tregut të brendshëm të gazit natyror. Ai raport duhet veçanërisht të trajtojë:
  - Ekzistencën e qasjes jo-diskriminuese në rrjet,
  - Rregullimin efektiv,
  - Zhvillimin e infrastrukturës së interkoneksioneve, kushtet e transitit, si dhe gjendjen e sigurisë së furnizimit në Komunitet,
  - Masën në të cilën përfitimet e plota të hapjes së tregut janë duke u gëzuar nga ndërmarrjet e vogla dhe konsumatorët amvisnorë, sidomos në kuptimin e standardeve të shërbimit publik,
  - Masën në të cilën tregjet në praktikë janë të hapur për konkurrencë efektive, duke përfshirë aspektet e dominimit të tregut, koncentrimin të tregut dhe sjelljes grabitqare apo anti-konkurrencë,
  - Masën në të cilën konsumatorët janë në fakt duke kaluar tek furnizuesit tjerë dhe duke ri-negociuar tarifat,



- Zhvillimet e çmimeve, duke përfshirë çmimet e furnizimit, në raport me shkallën e hapjes së tregjeve,
- Nëse ekziston qasja efektive dhe jo-diskriminuese e palës së tretë në depozitimet e gazit kurdo që është teknikisht apo/dhe ekonomikisht e domosdoshme për sigurimin e qasjes efikase në sistem,
- Përvoja e fituar në zbatimin e kësaj Direktive në kuptimin e pavarësisë efektive të operatorëve të sistemit në sipërmarrje të integruara vertikalisht, si dhe nëse janë zhvilluar masat tjera përveç pavarësisë funksionale dhe ndarjes së llogarive, të cilat kanë efekte ekuivalente me shthurjen juridike.

Aty ku është e përshtatshme, Komisioni duhet t'i parashtrojë propozimet tek Parlamenti dhe Këshilli Evropian, sidomos në garantimin e standardeve të larta të shërbimit publik.

Aty ku është e përshtatshme, Komisioni duhet t'i parashtrojë propozimet tek Parlamenti dhe Këshilli Evropian, sidomos në sigurimin e pavarësisë së plotë dhe efektive të operatorëve të sistemit të shpërndarjes para 1 korrikut 2007. Aty ku është e nevojshme, ato propozime duhet që, në përputhje me ligjin e konkurrencës, të kenë të bëjnë edhe me masat për adresimin e çështjeve të dominimit të tregut, koncentrimit të tregut dhe sjelljeve grabitqare apo anti-konkurrencë.

#### *Neni 53*

##### **Shfuqizimi**

Direktiva 2003/55/EC shfuqizohet nga 3 marsi 2011, pa paragjykuar obligimet e Shteteve Anëtare në lidhje me afatet për transpozim dhe aplikim të Direktivës në fjalë. Referencat ndaj Direktivës së shfuqizuar do të kuptohen si referenca ndaj kësaj Direktive si dhe do të lexohen në pajtim me tabelën e korrelacionit të dhënë në Shtojcën II.

#### *Neni 54*

##### **Transpozimi**

1. Shtetet Anëtare duhet të fusin në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për respektimin e kësaj Direktive deri më 3 mars 2011. Ato duhet ta njoftojnë menjëherë Komisionin për to.

Ato duhet të zbatojnë ato masa nga 3 marsi 2011, me përjashtim të nenit 11, të cilin do ta zbatojnë nga 3 marsi 2013.

Aty ku Shtetet Anëtare miratojnë këto masa, ato duhet të përmbajnë referenca ndaj kësaj Direktive apo të përcillen me referenca të tilla me rastin e shpalljes së tyre publike. Metodot e atyre referencave duhen përcaktuar nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare duhet t'i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të ligjit shtetëror të cilin e kanë miratuar në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë.

#### *Neni 55*

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi ditën e 20-të pas publikimit të saj në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

*Neni 56*

**Të adresuarit**

Kjo Direktivë i adresohet Shteteve Anëtare.

Kryer në Bruksel, 13 korrik 2009.

*Për Parlamentin Evropian*

*Kryetari*

H.-G. PÖTTERING

*Për Këshillin*

*Kryetari*

E. ERLANDSSON

## SHTOJCA I

### MASAT PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

1. Pa paragjykuar rregullat e Komunitetit mbi mbrojtjen e konsumatorit, në veçanti Direktivën 97/7/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 20 majit 1997 për mbrojtjen e konsumatorëve në lidhje me kontratat në distancë <sup>(20)</sup> dhe Direktivës së Këshillit 93/13/EEC e 5 prillit 1993 mbi kushtet e padrejta në kontratat e konsumatorëve <sup>(21)</sup>, masat e përmendura në nenin 3 janë për të siguruar që konsumatorët:

- (a) Të kenë të drejtë për kontratë me ofruesin e shërbimeve të gazit që specifikon:
- Identitetin dhe adresën e furnizuesit,
  - Shërbimet e ofruara, nivelet e cilësisë së shërbimit të ofruar, si dhe kohën për kyçjen fillestare,
  - Llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes që ofrohen,
  - Mënyrat në të cilat informatat e azhurnuara mbi gjitha tarifatat dhe shpenzimet e mirëmbajtjes në fuqi mund të merren,
  - Kohëzgjatjen e kontratës, kushtet për zgjatjen dhe ndërprerjen e shërbimeve dhe të kontratës, si dhe nëse lejohet tërheqja nga kontrata pa shpenzime,
  - Kompensimet dhe mundësia e rimbursimit të cilat vlejné nëse nivelet e shërbimit të kontraktuar nuk arrihen, duke përfshirë faturimin e pasaktë dhe të vonuar,
  - Metoda e inicimit të procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në pajtim me pikën (f); si dhe,
  - Informatat në lidhje me të drejtat e konsumatorëve, duke përfshirë ato mbi shqyrtimin e ankesave dhe për gjitha informatat e përmendura në këtë pikë, qartësisht të komunikuara përmes faturimit ose përmes faqes së internetit të sipërmarrjes së gazit natyror

Kushtet duhet të jenë të drejta dhe të njohura shumë përpara. Në çdo rast, ato informata duhen ofruar para nënshkrimit apo konfirmimit të kontratës. Në rastet kur kontratat nënshkruhen përmes ndërmjetësve, informatat mbi çështjet e caktuara në këtë pikë gjithashtu duhen ofruar para nënshkrimit të kontratës;

- (b) Të kenë njoftim adekuat për qëllimet e mundshme të modifikimit të kushteve të kontratës si dhe të jenë të informuar për të drejtën e tyre të tërheqjes kur jepet njoftimi. Ofruesit e shërbimeve duhet t'i njoftojnë abonuesit e tyre drejtpërdrejt për rritjen e shpenzimeve, në kohë të përshtatshme jo më vonë se një periudhë normale faturimi pas hyrjes në fuqi të rritjes, në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që konsumatorët të jenë të lirë të tërhiqen nga kontratat nëse nuk pranojnë kushtet e reja që njoftohen nga ofruesi i shërbimit të gazit;
- (c) Të marrin informata transparente mbi çmimet dhe tarifatat në fuqi si dhe mbi kushtet dhe afatet standarde, në lidhje me qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve të

---

<sup>20</sup> OJ L 144, 4.6.1997, p. 19.

<sup>21</sup> OJ L 95, 21.4.1993, p. 29.

gazit;

- (d) Të kenë një zgjedhje të gjerë të metodave të pagesës, të cilat nuk diskriminojnë pa nevojë mes konsumatorëve. Sistemet e parapagimit duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë në mënyrë adekuate konsumin e mundshëm. Secili dallim në kushte dhe afate duhet të reflektojë shpenzimet e furnizuesit në sisteme të ndryshme të pagesës. Kushtet dhe afatet e përgjithshme duhet të jenë të drejta dhe transparente. Ato duhen ofruar në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, si dhe nuk duhet të përfshijnë barriera jo-kontraktuale ndaj ushtrimit të të drejtave të konsumatorëve, për shembull dokumentacioni i tepërt kontraktual. Konsumatorët duhen mbrojtur nga metodat e padrejta apo çorientuese të shitjes;
- (e) Të mos ngarkohen për ndërrim të furnizuesit;
- (f) Të përfitojnë nga procedurat transparente, të thjeshta dhe jo të shtrenjta për trajtimin e ankesave të tyre. Në veçanti, gjithë konsumatorët duhet të kenë të drejtë për një standard të mirë të shërbimit dhe shqyrtim të ankesave nga ofruesi i shërbimeve të gazit. Procedurat e tilla të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës duhet të mundësojnë zgjidhjen e drejtë dhe të shpejtë të mosmarrëveshjeve, preferohet brenda tre muajsh, me ofrimin, kudo që kërkohet, e një sistemi të rimbursimit dhe/ose kompensimit. Ato duhet të jenë në përputhje, kudo që është e mundur, me parimet e përcaktuara me Rekomandimin e Komisionit 98/257/EC të 30 marsit 1998 mbi parimet që vlejné për organet përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me konsumatorë jashtë gjykatës <sup>(22)</sup>
- (g) Të kyçurit në sistemin e gazit të jenë të informuar për të drejtat e tyre për t'u furnizuar, sipas legjislacionit shtetëror në fuqi, me gaz natyror të një cilësie të caktuar me çmime të arsyeshme;
- (h) Të kenë në dispozicion të dhënat e konsumit, si dhe të jenë në gjendje që, me marrëveshje eksplicite dhe pa shpenzime, të sigurojnë qasje në të dhënat e njehsimit për të gjitha sipërmarrjet e regjistruara të furnizimit. Pala përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave duhet të jetë e obliguar t'i ofrojë ato të dhëna për sipërmarrjen. Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë një format për të dhënat dhe një procedurë për furnizuesit dhe konsumatorët që të kenë qasje në të dhëna. Nuk do të ngarkohen shpenzime shtesë për konsumatorin për atë shërbim;
- (i) Të jenë mirë të informuar për konsumin aktual të gazit dhe shpenzimet mjaft shpesh për t'i mundësuar atyre të rregullojnë konsumin vetanak të gazit. Ato informata duhet të ofrohen duke shfrytëzuar një kuadër të mjaftueshëm kohor, i cili merr parasysh qëndrueshmërinë e pajisjeve njehsuese të konsumatorit. Duhet marrë parasysh edhe efikasiteti i kostos së atyre masave. Nuk duhet të ketë shpenzime shtesë për konsumatorin për atë shërbim;
- (j) Të marrin një llogari përfundimtare të mbyllur pas secilit ndërrim të furnizuesit të gazit natyror jo më vonë se gjashtë muaj pas ndërrimit të furnizuesit.

2. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë implementimin e sistemeve të njehsimit inteligjent, të cilët ndihmojnë pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve në tregun e furnizimit të gazit. Implementimi i atyre sistemeve të njehsimit mund t'i nënshtrohen një vlerësimi ekonomik të gjitha shpenzimeve dhe përfitimeve afatgjate për tregun dhe konsumatorin individual ose cila formë e njehsimit inteligjent është ekonomikisht e

---

<sup>22</sup> OJ L 115, 17.4.1998, p. 31.

arsyeshme si dhe efektive për koston, si dhe cila periudhë kohore është e arritshme për shpërndarjen e tyre.

Vlerësimi i tillë duhet bërë deri më 3 shtator 2012.

Sipas atij vlerësimi, Shtetet Anëtare ose autoritetet kompetente që ato caktojnë, duhet të përgatisin një tabelë afatesh për implementimin e sistemeve të njehsimit inteligjent.

Shtetet Anëtare ose autoritetet kompetente që ato caktojnë, duhet të sigurojnë ndërveprueshmërinë e atyre sistemeve të njehsimit që duhen implementuar në territoret e tyre si dhe duhet të kenë parasysh shfrytëzimin e standardeve të përshtatshme dhe praktikatat më të mira, si dhe rëndësinë e zhvillimit të tregut të brendshëm të gazit natyror.

## SHTOJCA II

### TABELA E KORRELACIONIT

Direktiva 2003/55/EC	kjo Direktivë
Neni 1	Neni 1
Neni 2	Neni 2
Neni 3	Neni 3
Neni 4	Neni 4
Neni 5	Neni 5
-	Neni 6
-	Neni 7
Neni 6	Neni 8
Neni 9	Neni 9
Neni 7	Neni 10
—	Neni 11
Neni 7	Neni 12
Neni 8	Neni 13
—	Neni 14
—	Neni 15
Neni 10	Neni 16
—	Neni 17
—	Neni 18
—	Neni 19
—	Neni 20
—	Neni 21
—	Neni 22
—	Neni 23
Neni 11	Neni 24
Neni 12	Neni 25
Neni 13	Neni 26
Neni 14	Neni 27
Neni 15	Neni 29
Neni 16	Neni 30

Neni 17		Neni 31
Neni 18		Neni 32
Neni 19		Neni 33
Neni 20		Neni 34
Neni 21		Neni 35
Neni 22		Neni 36
Neni 23		Neni 37
Neni 24		Neni 38
Neni 25(1) (fjalja e parë dhe e dytë)		Neni 39
—		Neni 40
Neni 25 (pjesa e mbetur)		Neni 41
—		Neni 42
—		Neni 43
—		Neni 44
—		Neni 45
Neni 26	Neni 46	
—		Neni 47
Neni 27		Neni 48
Neni 28		Neni 49
Neni 29		Neni 50
Neni 30		Neni 51
Neni 31		Neni 52
Neni 32		Neni 53
Neni 33		Neni 54
Neni 34		Neni 55
Neni 35		Neni 56
Shtojca A		Shtojca I